

Ana tjetër e medaljes

TRI SHTYRJET, E KATËRTA NË HORIZONT?

Mbajtja e Albin Kurtit në burg në këtë periudhë, nuk ka si të shpjegohet ndryshe vetëm si kontribut i dhënë për “ta ruajtur qetësinë” nga e cila është duke përfitur komploti serbo-rus kundër pavarësisë së Kosovës. Në rrethanat kur vrasësit e protestuesve të 10 shkurti 2007 janë larg dorës së drejtësisë, është edhe e turpshme për të gjithë që të mbahet në burg Albin Kurti.



Milazim KRASNIQI

Tri shtyrjet e deritashme që i janë bërë vendimit ndërkombëtar për statusin final të Kosovës, tashmë kanë krijuar pasoja serioze për të ardhmen e këtij vendi. Shtyrja e parë është bërë duke e shkelur dokumentin e Rambuje-Parisit dhe rezolutën 1244, sipas të cilave periudha kalimtare e administrimit ndërkombëtar mbi Kosovën, do të zgjaste tre vjet. Pas asaj periudhe parashihej të mbahej një konferencë ndërkombëtare dhe madje të mirrej edhe një deklaram i popullit të Kosovës për të ardhmen e vendit të tyre. Por, gjatë përpjekjeve për gjetjen e justifikimeve për shtyrje, ndodhën trazirat e dhunshme të marsit 2004, të cilat u përdorën si pretekst për një shtyrje të paafatizuar.

Shtyrja e dytë u bë për hatër të Serbisë, përkatësisht për t'i krijuar hapësirën e favorizimit të ashtuquajturit “bllok demokratik” në Serbi. Zgjedhjet parlamentare serbe të janarit 2007, prodhuan probleme të reja, deri në atë pikë sa radikali Tomislav Nikoliq arriti të

ulej në karrigen e kryetarit të Kuvendit të Serbisë. Edhe pse atij iu hoq karrigia me presion ndërkombëtar dhe po instalohet me zor i ashtuquajturit “bllok demokratik”, kjo vonesë për Kosovën prodhoi vetëm keqësim të situatës.

Shtyrja e tretë u bë për hatër të Rusisë, e cila i solli ambasadorët e Këshillit të Sigurimit në një ekskursion qesharak në Kosovë, vetëm për ta komplikuar edhe më shumë vendimin për statusin e Kosovës. Kjo vonesë tash po shoqërohet edhe me rritjen e kërcënimeve ruse për të vu veto në Këshillin e Sigurimit ndaj një rezolute që do t'i hapte rrugë pavarësisë së Kosovës, sado që ajo do të ishte një pavarësi e mbikëqyrur.

Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, ndaj këtyre zhvillimeve negative më të fundit, kanë reaguar me disa veprime të çuditshme. E para, ato kanë inkurajuar mbajtjen në burg të Albin Kurtit. Mbajtja e Albin Kurtit në burg në këtë periudhë, nuk ka si të shpjegohet ndryshe vetëm si kontribut i dhënë për “ta ruajtur qetësinë”, nga e cila është duke përfitur komploti serbo-rus kundër pavarësisë së Kosovës. Në rrethanat kur vrasësit e protestuesve të 10 shkurti 2007 janë larg dorës së drejtësisë, është edhe e turpshme për të gjithë që të mbahet në burg Albin Kurti. Është edhe e dëmshme, gjë që do të shihet kur të mbyllet kapitulli i statusit dhe kur

Kosova të fitojë një status të gjymtuar. Atëherë nuk do të bëjnë punë reagimet qytetare.

E dyta, është duke u harxhuar energji e edhe para në punë të kota, gjoja të lobimit për pavarësinë në shtete që askush nuk i pyet për asgjë. Në vend se tashmë të ishin të gatshme Kushtetuta, simbolet shtetërore, himni i Kosovës dhe projekti i buxhetit për vitin e ardhshëm kalendarik, kur Kosova pritet të jetë një shtet më vete, opinioni bombardohet me deklarata qesharake të zyrtarëve të Kosovës, të cilët flasin si me qenë zedhënës të administratës amerikane.

E treta, Kuvendi i Kosovës në këtë kohë do të duhej të ishte në seanca të pandërprera, për të ushtruar një presion të vendosur mbi nevojën që pavarësia të njihet pa vonesa të tjera. Por, Kuvendi i Kosovës po e vazhdon gjumin dimëror, si të mos kish çelë pranvera fare në këtë vend dhe si të mos kishte asgjë të bënte me vendin tonë gjithë kjo hallakamë ndërkombëtare.

Për shkak të kërcënimeve ruse me veto, tash kanë filluar të dëgjoen zëra se vendimi për statusin e Kosovës mund të shtyhet për në vjeshtë. Kjo është në pajtim me kërkesën e Beogradit, i cili po kërkon “vazhdimin e bisedimeve”. Por, nëse kjo ndodh, atëherë kjo do të ishte shtyrja më e rrezikshme, sepse durimi i qytetarëve të këtij vendi do të vihej në sprovë serioze.



Salla ku do të caktohet fati i ardhshëm i Kosovës

Intervistë ekskluzive me Murat Jasharin

TANI KEMI NEVOJË PËR NJË PATRIOTIZËM KOLEKTIV

Redaksia e revistës Paqja, në këtë kohë kur pritet vendimi për statusin final të Kosovës, vlerëson se duhet të merret një mendim i familjes më domethënëse në historinë e re të këtij vendi, familjes Jashari. Prandaj, iu drejtuam Murat Jasharit me lutje që të na japë një intervistë për lexuesit tanë, së cilës ai iu përgjigj pa ngurrim, për çka i jemi shumë mirënjohës.

Paqja: Ju si familje e shndërruar në simbol të sakrificës kombëtare, si po e prisni vendimin për pavarësinë e Kosovës?

Murat Jashari: Në radhë të parë e falënderoj Zotin që i ka dhënë mundësinë gjithë popullit tonë për të përballuar çdo sakrificë e çdo betejë. Falë Zotit dhe falë këmbënguljes dhe patriotizmit të shumë nënave dhe ballarëve tanë që edukuan breza të tërë, popullit shqiptar nuk i shkoi kot sakrificë shekullore.

Tashmë, pas luftës, Kosova është futur në një fazë më të vështirë. Çështja e Kosovës është futur në politikat globale. Megjithatë unë jam i bindur thellë se Kosova do të jetë e pavarur. Jo ndoshta aq shpejt sa presin liderët tanë, por mund të them se rruga drejtë pavarësisë nuk ka kthim mbrapa, veçse është vështirë të caktohet një datë. Arsyja është se kjo tani nuk varet vetëm nga ne, por varet nga politikat globale. Tani momentalisht në politikat globale faktorë janë: SHBA-ja, Rusia dhe BE-ja, por këto dy të fundit i kanë disa probleme. Ruisë i dhemb se nuk e ka ndikimin e mëparshëm, ndërsa BE-ja kërkon të jetë një fuqi botërore, por ajo nuk është e formuar ende sa duhet, dhe nuk e ka as kushtetutën e vet. Ndërsa për momentin SHBA-ja luan rolin e fuqisë botërore. Problemi është se Kosova është futur në një trekëndësh: SHBA, Rusi, UE. Kjo

tani sjell një të keqe, sepse nuk mund të lobosh apo të informosh për gjendjen reale që është krijuar në Kosovë, për vetë faktin se burrështetasit që janë marrë me çështjen e Kosovës nuk janë më në pozitë të tyre.

Paqja: A mendoni se statusi i ofruar i plotëson kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të Kosovës, apo edhe tash do të jetë një proces tjetër kalimtar drejt statusit final?

Murat Jashari: Për faktin se Kosova do të jetë e mbikëqyruar nga UE-ja, kjo do të thotë se Kosova nuk do të jetë shtet i plotë sovran. Me këtë rast të cekim se në gjithë botën nuk ka më sovranitet të plotë, siç ka qenë me herët. Sepse me kalimin e kohës bëhen edhe ndryshime. Prandaj problemi më i madh i BE-së ndoshta është se si ta shuajë nacionalizmin e shteteve të tyre.

Ndërsa popujt e vegjël siç jemi ne, mundohen të bëjnë hapa gjigantë për shkak se nuk janë të fortë ekonomikisht, siç janë popujt e mëdhenj. Megjithatë mendoj se Kosova është duke ecur me hapa të duhur, edhe pse ndoshta jo ashtu siç kemi menduar, por megjithatë jemi duke ecur në rrugë të mbarë. Ndoshta jemi zhgënjyer sepse kemi menduar se Kosova do të shkojë drejt e në rrugën e pavarësisë. Por rruga drejt saj është rrugë gjarpërore dhe në këtë rrugë duhet të jemi të kujdesshëm.

Paqja: Si e vlerësoni

rolin e institucioneve të Kosovës në këtë proces të pavarësisë?

Murat Jashari: Pas luftës ka qenë një mosmarrëveshje e madhe dhe kjo solli një politikë që nuk i duhet Kosovës. Por pak me presionin e bashkësisë ndërkombëtare dhe pak me presionin e shqiptarëve të Kosovës, ato mosmarrëveshje dhe ato keqkuptime kanë rënë në një nivel më të ulët. Pra në këtë periudhë kohore neve më së paku na duhen mosmarrëveshjet. Duhet thënë se është punuar shumë pak për ta informuar faktorin ndërkombëtar për të favorizuar më shumë Kosovën. Ne dimë se faktori ndërkombëtar në Kosovë ka punëtorët e vet që marrin rrogën për këto punë, por ka gjithësi ndërkombëtarë që janë për të zbatuar ligjin dhe për ta çuar më tutje procesin e Kosovës.

Politikat tona, edhe pse me vështirësi dhe jo kohën e duhur, por më mirë tani se kurrë, arritën që ta informonin faktorin ndërkombëtar për Kosovën. UE-ja, ndoshta, nuk duhet të informohet në atë mënyrë siç duhet të informohen shtetet e tjera, për vet faktin se UE-ja gjendet këtu, dhe e di përafërsisht gjendjen reale të Kosovës.

Institucionet dhe politikanët tanë duhet të bëjnë më shumë për t'ua ndryshuar mendimin atyre të cilët, jo me fakte, kanë plasuar këto vite një ide për Kosovën. Por me rëndësi është që liderët tanë të mësojnë nga e kaluara dhe të mos përsëriten gabimet e njëjta.

Paqja: A është ekipi i Unitetit në pajtim me qëndrimin e familjes suaj, apo unitetin e partive dhe liderëve të Kosovës?

Murat Jashari: Normalisht familja jonë është munduar të mbajë një qëndrim që t'i shërbejë së ardhmes dhe motoja jonë gjithmonë ka qenë: "që të gjithë janë tanët dhe ne u takojmë të gjithëve". Se sa ia kemi arritur kësaj çështjeje, vendosin vetë qytetarët e Kosovës. Edhe ne jemi pjesë e shoqërisë dhe nuk kemi dallime si familje, profesion etj. Pra mendimi ynë është i paluhatshtëm si i gjithë qytetarëve të tjerë të Kosovës, e ajo është që Kosova të jetë shtet. Jam thellësisht i bindur se 99% e qytetarëve të Kosovës nuk pajtohen me një zgjidhje tjetër, e në qoftë se ata i përfaqësojnë denjësisht mendimet



► Murat Jashari

e qytetarëve të tyre, atëherë normalisht që i mbështesim. Nëse ata mendojnë ndryshe, dhe se Kosova nuk duhet të zgjidhet në atë mënyrë, atëherë ata nuk i përfaqësojnë mendimet tona e lëre më të qytetarëve të Kosovës. Rruga jonë deri të qëllimi mund të jetë ndryshe dhe ajo rrugë mund të jetë me vështirësi. Ne kemi menduar se rruga drejt shtetit të Kosovës do të jetë e lehtë, por në vend të autostradës na doli një rrugë gjarpërore. Prandaj rrugët janë të ndryshme dhe qëndrimi i Kosovës duhet të jetë i një zëri, sepse ne bartim një amanet të rëndë mbi supet tona, jo vetëm të luftës së fundit, por të luftës shekullore që është bërë që Kosova të jetë shtet.

Në këtë drejtim ata duhen të jenë të matur sepse është një moment historik për shqiptarët e Kosovës.

Paqja: Çka mendoni për Kosovën pas pavarësisë dhe a mendoni se pavarësia do t'i zgjidhë të gjitha problemet?

Murat Jashari: Sinqerisht mendoj se Kosova do të ketë probleme më të mëdha pas pavarësisë së saj, sepse në Kosovë, para luftës që nga viti 1997-99 popullit i është grumbulluar një millef i madh. Edhe pse kanë ekzistuar më herët, por në rrethana të tjera, neve na janë grumbulluar shumë probleme dhe asnjëra nuk është zgjidhur.

Natyrisht që pavarësia e Kosovës nuk do t'i zgjidhë të gjitha problemet, por nëse ne si shoqëri, dhe institucionet tona, jemi të përgatitur dhe punojmë për të mirën e vendit, dhe i lemë anash mosmarrëveshjet, atëherë do ta kemi me lehtë për t'i përballuar problemet.

Në këtë kohë, para statusit final, para pavarësisë së vendit, të gjithë njerëzit e kategorive të ndryshme po durojnë, edhe pse e kanë të vështirë për të mbijetuar. Por nuk besoj që këta qytetarë do të jenë kaq të durueshëm nëse pas pavarësisë. Ky është mendimi dhe ndjenja ime, por nuk them se do të bëhet gjithësesi.

Paqja: Cilat çështje sipas jush janë me problematike për t'i zgjidhur institucionet e Kosovës dhe qytetarët e saj?

Murat Jashari: Për momentin, institucionet tona e kanë të lehtë pasi shumica e qytetarëve të Kosovës presin zgjidhjen finale të shtetit të tyre, por atëherë ndoshta do të mundemi më lehtë t'i diskutojmë të gjitha problemet. Në këtë moment institucionet tona kanë një armë të fortë në glob, pasi 99% e qytetarëve të Kosovës janë pro shtetit. Pas statusit mendoj që institucionet tona nuk kanë plane dhe projekte të gatshme, që do të ishin dashur t'ia ofronin shtetit tonë. Ne nuk duhet të presim për plane ose projekte deri pas pavarësisë, por duhet të vihemi dhe t'i hartojmë tani, në mënyrë që të jemi të gatshëm për pavarësinë dhe çka vjen pas saj, qofshin ato projekte ekonomike, politike, arsimore, investuese, etj. Pra që mos të dështojmë në hapin e parë, sepse është rrezik të vazhdohet me dështime. Duhet të jemi shumë të kujdesshëm në hapat e parë të pavarësisë së Kosovës. Mendoj se është

shumë e rëndësishme të bëjmë plane më parë për shtetin tonë.

Paqja: Sa mendoni se është bërë për kategoritë e ndryshme që kanë dalë nga lufta, siç janë: invalidët, familjet e dëshmorëve, jetimët, etj.?

Murat Jashari: Mendoj se këto kategori dhe të tjera që nuk janë përmendur janë një plagë e rëndë. Ka familje të dëshmorëve që i kanë kushtet të vështira, por edhe ata që i kanë kushtet më të mira, ju duhet përkrahja morale. Ka prej këtyre kategorive që e kanë të vështirë të gjejnë kafshatën e gojës. Paramendoni fëmijën që ka humbur prindërit e tij për Kosovën, paramendoni se sa i zhgënjyer mund të jetë ai kur prindërit e tij kanë dhënë jetën për Kosovën, ndërsa udhëheqja e Kosovës nuk i ofron kushte për mbijetesë. Kjo sjellje mund të mbjellë probleme shumë të mëdha në të ardhmen.

Kategoria e invalidëve besoj se e ka edhe më të vështirë, sepse ata dhanë gjymtyrët e tyre për ta mbrojtur atdheun dhe lirinë e popullit shqiptar. Atyre, po që se nuk ndihmohen, menjëherë u shkojnë sytë tek gjymtyrët e tyre të dhëna për Kosovën. Në një udhëtim për në Shqipëri, kur e pashë një invalid, e pyeta se po të të kisha dhënë një shumë të madhe parash për gjymtyrët e tua, a do të m'i kishe dhënë? Natyrisht që përgjigja ishte jo.

Nëse nuk e studiojmë të kaluarën me drejtësi, atëherë nuk do të kemi të ardhme të shëndoshë. Tani kemi ende problemin e të pagjeturve. Kjo me siguri është barrë e madhe për familjet që nuk e dinë se ku janë me të dashurit e tyre. Ndryshe është kur e dinë se i dashuri i tyre ka vdekur dhe është varrosur, e ndryshe është kur gjithëherë në mendjen e tyre thonë se a është gjallë apo ka vdekur.

Kemi edhe rastin e përdhunimeve gjatë luftës. Barrë e rëndë, por edhe më rëndë është kur të tjerët nuk dinë dhe nuk i mbështesin se paku moralisht.

Kam frikë se ardhmja do të na gjykojë se ne nuk jemi duke bërë shumë për t'i ndihmuar këto kategori të cilat i ceka, por edhe ato të cilat nuk i kam cekur.

Paqja: Cili është mesazhi juaj për të rinjtë?

Murat Jashari: Rinia është ardhmëria e çdo vendi, por rinia ka vështirësitë dhe problemet e veta, veçanërisht në ato

shoqëri që janë në tranzicion. Të rinjtë nuk duhet të ndihen të parëndësishëm. Ata duhet të jenë të kujdesshëm sepse pas 15 viteve do të jenë ata që do ta udhëheqin Kosovën.

Mesazhi dhe urimi më i mirë është që të kenë kujdes nga viruset, siç janë droga, humbja e kohës, etj. I kisha lutur sinqerisht të mos infektohen me viruse. Puna më e mirë tani është arsimi i duhur për t'i dalë ballë të pavërtetës dhe që të mos shkojnë në rrugë të shfrenuara, pasi rinia e arsimuar është lajmëtare e një shoqërie demokratike.

I lus nga thellësia e shpirtit tim që të kenë kujdes, se unë e kuptoj ndjenjën e të rinjve për të shijuar gjithçka të re, por jo që t'i hyjnë një rrugë të gabuar që edhe po të dëshirojnë të mos kenë mundësi për t'u kthyer mbrapa. Është mirë që të kalohet pa probleme të mëdha, se pa të vogla ndoshta nuk është e mundur.

Paqja: Cili është mesazhi juaj për qytetarët e Kosovës në përgjithësi?

Murat Jashari: Duhet t'i jemi mirënjohjes kulturës tonë që ka pasur cilësi të mira siç janë mikpritja, besa, trimëria, bujaria, etj. E ndiejmë veten jashtëzakonisht mirë që i takojmë këtij kombi. Por për këtë duhet të falënderojmë Zotin. Mesazhi im është se çfarëdo që të ndodh në këto kohë të jemi të kujdesshëm dhe të matur, të jemi për një shoqëri që do të jetë më e mirë për Kosovën. Mendoj që koha e patriotizmit individual ka përfunduar, tani kemi nevojë për një patriotizëm kolektiv. Ne duhet të gjejmë rrugën për të shkuar në shoqërinë demokratike, dhe të themi se ky është tepihu i kuq në të cilin duhet të shkojnë edhe gjeneratat e tjera. Unë e di se e kemi pasur të vështirë dhe kemi hequr shumë, por nuk i zgjedhim problemet duke u keqkuptuar ndërmjet vete, e duke u kacafytur. Tani duhet të jemi edhe më tolerantë se kurrë dhe t'i ndihmojmë njëri-tjetrit. Shoqëria e Kosovës duhet të jetë e vetëdijshme dhe të punojë për një të ardhme më të mirë për familjet, nipat dhe mbesat tona. Dhe mos të presim që problemet tona t'i zgjidhin vetëm institucionet e vendit, por të jemi të zotë që problemet t'i zgjidhim vetë në mënyrë sa më të drejtë.

Intervistoi

Mergim Lushtaku



Kompleksi përkujtimor "Adem Jashari"

Krimet e Luftës në Kosovë sipas Human Rights Watch

ZBULOHET ZINXHIRI SHTETËROR I KOMANDIMIT TË KRIMEVE

Periudha e pasluftës shënoi qindra ngritje në detyrë dhe shpërblime për personelin e policisë dhe ushtrisë që kishin marrë pjesë në luftë në Kosovë, duke përfshirë dhe disa prej udhëheqësve të lartë të tillë si Dragoljub Ojdanic, Nebojsa Pavkovic, Vladimir Lazarevic, Obrad Stevanovic, Sreten Lukic, Vlastimir Djordjevic, dhe Zivko Trajkovic, si dhe shumë komandantë brigade në Korpusin e Prishtinës.

Shkelzen NUZA

E gjithë lufta u përcoll me tortura, vrasje, përdhunime, dëbime me forcë dhe krime të tjera lufte, të kryera nga forcat e qeverisë serbe dhe asaj jugosllave kundër shqiptarëve të Kosovës nga 24 marsi deri më 12 qershor 1999, periudha e sulmeve ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë. Kjo dëshmon për një fushatë sistematike të koordinuar dhe të organizuar nga nivelet më të larta të qeverive serbe dhe jugosllave të asaj periudhe për të terrorizuar, vrarë dhe shpërngulur shqiptarët etnikë të Kosovës.

Natyrisht këto krime nuk ishin të izoluara nga njëri tjetri. Megjithatë fokusi kryesor i kësaj teme është dhuna shtetërore e ushtruar nga qeveritë serbe dhe jugosllave në vitin 1999 kundër qytetarëve shqiptarë etnikë.

Ofensiva e Vitit 1999

Në fillim të vitit 1999 vihet re një rritje e dukshme e prezencës

ushtarake dhe armatosja e civilëve serbë etnikë. Aksionet e policisë dhe ushtrisë në fund të shkurtit dhe në fillim të marsit përreth Vushtrisë dhe Podujevës, të emërtuara nga qeveria si "ushtrimet e dimrit" siguruan lidhje hekurudhore dhe rrugore në veri me Serbinë.

Shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare kanë karakterizuar të gjitha ofensivat e mëparshme të qeverisë, por periudha e bombardimeve të NATO-s shënoi sulme të papara mbi civilët dhe shpërnguljen me forcë të më shumë se 850,000 shqiptarëve etnikë nga Kosova. Për herë të parë në konflikt, luftimet u zhvendosën nga zonat fshatare në ato qytetare.

Askush nuk mundi të parashikonte shpejtësinë dhe shkallën e shpërnguljes. Sipas Komisionierit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), gjatë tre javëve të para të bombardimeve të NATO-s, 525.787 refugjatë nga Kosova vërshuan në vendet fqinje. Thuhet se forcat e qeverisë shpërngulën 862,979 shqiptarë etnikë nga Kosova dhe disa qindra mijëra të tjerë u zhvendosën brenda për brenda Kosovës, përveç atyre që ishin zhvendosur

para Marsit 1999. Më shumë se 80 për qind e gjithë popullsisë

së Kosovës – 90për qind e së cilës përbëhej nga shqiptarë – u zhvendosën nga shtëpitë e tyre.

Zonat e njohura për lidhjet e tyre me UÇK-në u goditën me rend. Komunitet e Gllogovcit dhe Skenderajt në krahinën e Drenicës, djepi i UÇK-së, ishin skena të masakrave të shumta ndaj civilëve, si dhe të ndalimeve arbitrare, torturave, shkatërrimeve sistematike të shtëpive dhe pasurisë së civilëve. Vrasjet masive, shpërnguljet me forcë, dhe shkatërrimi i pasurisë civile ishin të zakonshme gjithashtu në komunitet jugperëndimorë të Gjakovës, Rahovecit dhe Suharekës, ku shume fshatra e kishin mbështetur prej kohësh UÇK-në. Gjashtëdhjetë e pesë për qind e shkeljeve të dokumentuara nga Human Rights Watch kanë ndodhur në pesë komunat e lartpërmendura.

Shpjegimet mbi abuzimet në komunat e tjera janë me komplekse dhe më pak bindëse. Komunitet e Pejës dhe Lipjanit, të cilat kishin një numër të konsiderueshëm popullsie serbe, ishin piketuar për shpërngulje masive të shqiptarëve etnike, ndërsa vrasjet ishin më të lokalizuara në fshatra të tillë si në Slllovi, Ribar, Lubeniq, Qyshk dhe në qytetin e Pejës. Megjithëse gjatë 1998 dhe fillimit të 1999 UÇK-ja ishte aktive në komunën e Pejës dhe prezent në pjesën më të madhe të komunës perëndimore të Lipjanit, ka pak apo aspak fakte për të bërë lidhjen e UÇK-së me disa nga fshatrat ku

ndodhën masakrat. Vrasjet ishin pasojë e një plani më të gjerë operacionesh për të terrorizuar popullsinë që të largohej nga Kosova, duke përdorur ushtrinë, policinë dhe forcat paramilitare.

Istogu ishte skena e një nga incidentet më të përgjakshme të luftës, ku forcat serbe vranë në maj 1999 më shumë se 90 shqiptarë etnikë të burgosur në burgun e Dubravës. Shpërngulja me forcë ishte e organizuar mirë, gjë që tregon se ajo ishte planifikuar paraprakisht. Fshatrat në zonat strategjike u "spastruan" për të siguruar linjat e komunikimit dhe kontrollin e zonave më të gjëra. Zonat ku UÇK-ja kishte mbështetje dhe ato ku ajo nuk ishte prezent, u sulmuan në aksione të përbashkëta nga policia, ushtria dhe paraushtarakët serbë. Qytete të mëdha u "spastruan" duke përdorur autobusë, trenat dhe karvanë të gjatë traktorësh që drejtoheshin drejt kufijve. Refugjatët u shtrënguan të largohen ose u transportuan në mënyrë të organizuar nga shteti në drejtim të kufijve, sipas një programi të përgatitur për shpërngulje me forcë dhe deportimi të karakterizuar nga një shkallë shumë e lartë koordinimi dhe kontrolli.

Human Rights Watch dokumentoi gjithashtu praktikën e njohur të "spastrimit të identitetit": refugjatëve shpesh iu merreshin dokumentet e identitetit dhe detyroheshin të hiqnin targat nga makinat dhe traktorët e tyre para se të lejoheshin që të kalonin kufirin.

Para se të arrinin kufirin, shumë shqiptarëve iu shkatërruan dokumentet personale, gjë që tregon se qeveria po përpiqej të bënte të pamundur kthimin e tyre.

Shpërngulja masive e shqiptarëve të Kosovës mund t'i ketë shërbyer një sërë qëllimesh. Së pari, ajo mund të ketë pasur si qëllim të ndryshonte përbërjen demografike të Kosovës – një politike e përmendur shpeshherë gjatë gjithë historisë nga politikanët nacionalistë ekstremë serbë. Këto ndryshime demografike mund të kishin çuar në ndarjen eventuale të krahinës në dy pjesë, një për serbët dhe një për shqiptarët. Së dyti, shpërnguljet mund të kenë pasur si qëllim të destabilizonin vendet fqinje: Shqipërinë dhe



Shoqatë për të drejtat e njeriut.

Maqedoninë. Së fundi, synimi i shpërnguljes masive të shqiptarëve mund të ketë qenë t'i mbante forcat e NATO-s në vendet fqinje në mënyrë që të pengohej një sulm nga toka ose, së paku, të dobësohej vendosmëria e aleancës së NATO-s. Në rast se qëllimi ishte dobësimi i vendosmërisë së komunitetit ndërkombëtar, kjo natyrisht që dështoi, pasi imazhet e refugjatëve të përvuajtur vetëm sa provokuan zemërimin publik dhe shtuan thirrjet për veprim.

Vrasjet e qëllimshme dhe të paligjshme të civilëve – ekzekutimet pa gjyq – ishin një pjesë e rëndësishme e fushatës “së spastrimeve”. Në të gjithë krahinën, civilë të cilët dihej mirë që nuk ishin luftëtarë dhe ndër të cilët kishte shumë gra dhe fëmijë, u vranë nga policia serbe, ushtarët e ushtrisë jugosllave, dhe forcat paraushtarake të implikuara në vrasjet e stilit “ekzekutim në vend”.

Në përgjithësi vrasjet kishin tre motive të qarta. E para ishte përsheptimi i procesit “të spastrimit” nëpërmjet kërcënimit dhe ngjalljes së frikës. E dyta ishte eliminimi i individëve që dyshoheshin se luftonin në radhët e UÇK-së apo e ndihmonin atë, dy gjëra që shpeshherë ishte vështirë të dalloheshin nga njëra-tjetra. Ndër individët e vënë në shënjestër kishte udhëheqës të shquar politikë, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe biznesmenë të pasur. E treta ishte kryerja e vrasjeve për hakmarrje: disa masakra u kryen pasi forcat serbe dhe jugosllave pësuan humbje nga ana e UÇK-së.

Megjithëse kanë filluar të dalin shifra të besueshme, numri i saktë i viktimave të luftës në Kosovë mbetet i panjohur dhe është shndërruar në një çështje debati mjaft të madh. Human Rights Watch, përmes hulumtimeve të saj, ka dokumentuar 3.453 vrasje të kryera nga forcat qeveritare serbe dhe jugosllave, por gjithsesi ky numër është më i vogël sesa numri përfundimtar, pasi ai bazohet vetëm në 577 intervista (intervistat e bëra qenë të menduara mirë që të lejonin vlerësimin e të dhënave për të gjithë Kosovën).

Deri në korrik 2001, Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë (International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia (ICTY)) kishte zhvarrosur përafërsisht 4.300 njerëz që besohen të kenë qenë viktimë të vrasjeve të paligjshme të kryera nga forcat serbe dhe jugosllave në Kosovë. Ky numër është sigurisht më i vogël se sa numri i përgjithshëm i të vrarëve nga trupat qeveritare. Më e rëndësishmja është se ka fakte të pakundërshtueshme lidhur me vënien dorë në varre dhe zhvendosjen e trupave të vdekur nga trupat serbe dhe jugosllave, siç filloi të konfirmonte në verën e vitit 2001 qeveria serbe e ardhur

në pushtet pas Milloshevicit. Human Rights Watch dokumentoi përpjekjet për të fshehur apo eliminuar trupa në Terrnje, Gjakovë, Izbicë, Rezallë, Krushë e Madhe dhe Krushë e Vogël, Suharekë, Sllovi, Poklek, Kotlinë dhe Pastasel. Veç kësaj, sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (International Committee of the Red Cross (ICRC)) 3.525 persona, duke përfshirë edhe serbë etnikë, figurojnë të zhdukur nga ky konflikt.

Analiza statistikore e bërë nga Human Rights Watch dhe Shoqata Amerikane për Përparimin e Shkencës (American Association for the Advancement of Science (AAAS)) zbulon një metodikë vrasjesh që nxjerr më tej në pah natyrën sistematike të fushatës qeveritare. E gjithë kjo tregon bindshëm se vrasjet nuk ishin rezultat i rastësishëm i dhunës së forcave qeveritare. Përkundrazi, ato ishin planifikuar me kujdes dhe vinin në jetë operacione që i shërbenin qëllimit strategjik të qeverisë. Fushatat historike të vrasjeve ndodhën nëpër komuna në periudha të qarta kohore, duke sugjeruar kështu ekzistencën e një urdhri strategjik për kryerjen e këtyre vrasjeve në zona të caktuara.

Përdhunimet dhe dhuna seksuale ishin gjithashtu komponentë të kësaj fushate. Përdhunimet ndaj shqiptarëve nuk ishin akte të rralla e të izoluar kryer nga individë të forcave serbe dhe jugosllave, por instrumente për të terrorizuar popullsinë civile, për të zhvatur para nga familjet e këtyre vajzave dhe për t'i shtrënguar njerëzit të braktisin vatrat e tyre. Human Rights Watch ka gjetur të dhëna të besueshme për nëntëdhjetë e gjashtë raste të dhunës seksuale gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s, dhe numri real sigurisht është shumë më i madh.

Në përgjithësi përdhunimet e kryera në Kosovë mund të grupohen në tre kategori: përdhunime të kryera në shtëpitë e vetë grave, përdhunime të kryera gjatë largimit dhe përdhunime të kryera gjatë ndalimeve. Në kategorinë e parë, forcat e sigurimit hynin në shtëpitë private dhe përdhunonin gratë para anëtarëve të familjes, në oborr apo në dhomën ngjitur. Në kategorinë e dytë, njerëz të dëbuar që endeshin në këmbë apo me traktorë ndaloheshin, grabiteshin dhe kërcëno-

heshin nga Ushtria Jugosllave, policia serbe apo paramilitarët. Në qoftë se familjet nuk mund të jepnin para, atëherë forcat e sigurimit iu thonin që vajzat e tyre do të merreshin dhe përdhunoheshin. Në disa raste, edhe pse familjet kishin dhënë para, atyre iu ishin rrëmbyer vajzat. Në kategorinë e tretë, dhunimet u kryen në qendrat e përkohshme të ndalimeve në vende të tilla si në shtëpi, apo hambare të braktisura.

Shkatërrimi i pasurisë së popullsisë nga trupat qeveritare më 1999 shënoi rritje të madhe. Sipas një studimi të UNHCR-së, në nëntor të vitit 1999, pothuaj 40 për qind e të gjithë shtëpive të banimit në Kosovë ishin dëmtuar rëndë ose shkatërruar plotësisht. Po ashtu u dëmtuan shkollat dhe xhamitë. Sipas një vlerësimi të Kombeve të Bashkuara për dëmtimet në 649 shkollat e Kosovës, më shumë se një e pesta e shkollave të përfshira në këtë vëzhgim ishin të dëmtuara rëndë dhe më shumë se 60 për qind ishin të shkatërruara plotësisht. Në të gjithë Kosovën, forcat serbe dhe jugosllave qëllimisht nxorën ujë e puseve jashtë përdorimit duke hedhur në to kimikate, kafshë të ngordhura, apo kufoma njerëzish. Human Rights Watch ka dokumentuar në katër fshatra raste ku një numër i pafund dëshmitarësh dhe viktimash dëshmuar për Human Rights Watch se si forcat qeveritare iu grabitën atyre gjërat e çmuara, duke përfshirë dhe unazat e martesës e makinat, si në shtëpitë e tyre, ashtu dhe rrugës gjatë dëbimit të tyre. Policë, ushtarë dhe veçanërisht anëtarë të njësive paramilitare i kërcënonin njerëzit me jetën e tyre në rast se ata nuk jepnin një sasi të mirë parash, zakonisht marka gjermane. Disa vullnetarë treguan se ata ishin liruar nga burgjet në Serbi me kusht që ata të shërbenin në ushtri apo polici.

Në këtë periudhë, të ndaluarit detyroheshin të hapnin dhe të pastronin bunkere, si dhe praktikën e përdorimit të civilëve si mburoja njerëzore për të mbrojtur trupat nga sulmet e NATO-s apo UÇK-së.

Qeveria jugosllave gjithashtu vuri në tokë mina anti-tanke dhe anti-njerëz, veçanërisht përgjatë kufirit me Shqipërinë dhe Maqedoninë.



Pasojat e krimeve serbe në Kosovë!

Zinxhiri i Komandimit

Forcat qeveritare të përfshira në konflikt ishin një kombinim kompleks i policëve dhe forcave policore speciale të Ministrisë së Punëve të Brendshme serbe, ushtarëve dhe njërive ushtarake speciale të Ushtrisë Jugosllave, forcave paraushtarake, milicisë lokale, dhe i një morie forcash që vinin nga vendet e tjera. Të gjithë këta vepronin nën urdhrat e qeverisë në Beograd.

Ushtria Jugosllave kishte komandën e përgjithshme gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s. Sipas ligjit, ajo kishte nën varësinë e saj policinë dhe forcat paraushtarake, megjithëse zyrtarët e lartë në Ministrinë e Punëve të Brendshme serbe ushtruan dukshëm një influencë të rëndësishme gjatë fushatës. Ushtria kontrollonte rrugët kryesore dhe kufijtë duke koordinuar dhe lehtësuar kështu "spastrimin etnik". Policia dhe forcat paraushtarake u përfshinë në mënyrë më të drejtpërdrejtë në dëbimin e civilëve dhe

shkatërrimin e fshatrave, për të cilën kishin mbështetjen e artilerisë së ushtrisë. Gjatë këtyre operacioneve burrat veçoheshin nga gratë dhe fëmijët për t'u marrë në pyetje për UÇK-në dhe ekzekutoheshin në vend.

Sipas ligjit jugosllav, Ushtria Jugosllave është nën komandën e presidentit të Jugosllavisë në kohë lufte dhe në paqe. Deri në tetor të vitit 2000, president ishte Slllobodan Milloshevic. Ushtria Jugosllave është nën kontrollin e Këshillit të Lartë të Mbrojtjes, i përbërë nga presidentët e Serbisë, Malit të Zi dhe Jugosllavisë dhe kryesuar nga presidenti i Jugosllavisë. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë gjatë luftës ishte Gjeneral Dragoljub Ojdanic, i cili u emërua pas luftës si Ministër i Mbrojtjes së Jugosllavisë, post të cilin e mbajti deri në tetor 2000.

Ushtria Jugosllave ndahet në tre armata. Armata e Tretë, e komanduar gjatë luftës nga Kolonel Gjeneral Nebojsa Pavkovic, ishte përgjegjës për Kosovën dhe Serbinë e jugut. Në Gusht të 2001, Pavkovic ishte Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë

Jugosllave. Gjatë luftës nën Pavkovicin vinte Major Gjeneral Vladimir Lazarevic, i cili komandonte Korpusin e Prishtinës të Armatës së Tretë të vendosur në Kosovë. Në komandën e Lazarevic-it ishin pesë brigada, një njësi policore ushtarake dhe një regjiment aviacioni.

Struktura e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (MUP), drejtuar gjatë luftës nga Ministri Vlajko Stojiljkovic, është më e komplikuar sesa struktura e Ushtrisë Jugosllave. Brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë bënin pjesë policia e rregullt e Kosovës, e komanduar nga Stretën Lukic, forcat policore speciale të komanduara nga Lejtnant Gjeneral Obrad Stevanovic, dhe Forcat Antiterroriste të komanduara nga Kolonel Zivko Trajkovic. Kolonel Gjeneral Vlastimit Djordjevic ishte kreu i sektorit të sigurimit publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe asistent i ministrit të punëve të brendshme. Qeveria e re e Serbisë zëvendësoi Djordjevic-in dhe Stevanovic-in në Janar të vitit 2001, por ngriti në detyrë Lukic si shef të sigurimit publik dhe zëvendësministër të Punëve të Brendshme. Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë përmban gjithashtu dhe shërbimin e sigurimit, apo siç quhet ndryshe, policinë sekrete, e cila luajti një rol të madh në Kosovë. Përveç aktiviteteve të fshehta për monitorimin dhe sulmimin e aktivistëve politikë shqiptarë etnikë dhe të UÇK-së, sigurimi i shtetit dislokoji gjithashtu njësi operative speciale (JSO) dhe ndihmoi organizata të ndryshme paraushtarake. Të njohur gjithashtu si "Beretat e Kuqe" apo "Djemtë e Frenkit" (sipas Frenki Simatovic, një personalitet kyç në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i cili njihet si themeluesi i grupit), JSO-ja komandohej gjatë luftës nga Milorad Lukovic, një njeri i njohur si "Legjia". Deri në janar të vitit 2001, në krye të sigurimit të shtetit të Serbisë ishte Kolonel Gjeneral Radomir Markovic. Markovic u hoq nga detyra në fund të janarit dhe u arrestua një muaj më vonë nga policia serbe, pasi akuzohej për përfshirje në sulmin e vitit 1999 kundër politikanit serb

Vuk Draskovic. Kreu i sigurimit të shtetit në Kosovë gjatë luftës ishte David Gajic. Së fundi, forca të ndryshme paraushtarake si dhe forca të huaja ishin aktive në Kosovë, kryesisht nën kontrollin e qeverisë qendrore. Përveç faktit që ata ishin ndër forcat më të dhunshme në Kosovë, një nga aktivitetet primare të paraushtarakeve ishte vjedhja dhe grabitja.

Megjithëse linja e saktë e komandimit dhe kontrollit të forcave paraushtarake mbetet jo e qartë, ajo çfarë dihet është se ata kanë bashkëpunuar ngushtë me Ushtrinë Jugosllave dhe policinë serbe. Paraushtarakët, të cilët janë shprehur për shtypin ndërkombëtar pas luftës, kanë thënë se zyrtarë lokalë iu jepnin lista me emrat e shqiptarëve etnikë të vënë në listë për t'u vrarë. Disa prej paraushtarakeve ishin liruar nga burgjet e Serbisë, me kusht që të luftonin në Kosovë. Në disa raste individë të policisë apo ushtrisë u përpoqën të paralajmëronin apo të mbronin shqiptarët etnikë nga forcat paraushtarake, megjithëse këto ishin raste të rralla. Si rregull, milicët dhe policia bashkëpunonin ngushtë me njësitë paraushtarake, shpesh duke krijuar një kordon për lëvizjen e forcave paraushtarake rreth komuniteteve të vëna në shënjestër.

Grupet dhe njësitë e ndryshme brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme e bëjnë zinxhirin e komandimit më pak të dukshëm sesa në Ushtrinë Jugosllave, megjithëse është e qartë se autoriteti final për Ministrinë e Punëve të Brendshme i përkiste presidentit jugosllav Slllobodan Milloshevic. Sipas ligjit jugosllav, në gjendje lufte, Ushtria Jugosllave ka nën juridiksionin e saj policinë e Serbisë, duke e bërë kështu Slllobodan Milloshevic-in de jure dhe de facto komandant të policisë gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s. Zëvendëskryeministri i atëhershëm i Jugosllavisë Nikola Sainovic ka luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm. E drejta ndërkombëtare është e lidhur qartë me përgjegjësitë e udhëheqësve që organizojnë apo lejojnë kryerjen e krimeve të luftës. Si autorët e krimeve, ashtu edhe udhëheqësi ushtarak apo politik që urdhëron krimet, ose që nuk merr masa për parandalimin e tyre ose dënimin e fajtorëve, janë njëloj përgjegjës. Shtrirja dhe natyra sistematike e abuzimeve në Kosovë e bën të pamundur të besosh që udhëheqja serbe dhe jugosllave, me gjithë mohimet e tyre publike, nuk ishte në dijeni të atyre shkeljeve. Rastet e dënimeve të anëtarëve të forcave të sigurimit për kryerjen e krimeve të rënda, si për vrasje, janë të pakta. Përkundrazi, periudha e pasluftës shënoi qindra ngritje në detyrë dhe shpërblime për personelin e policisë dhe ushtrisë, duke përfshirë dhe disa prej udhëheqësve të lartë të tillë si Dragoljub Ojdanic, Nebojsa Pavkovic, Vladimir Lazarevic, Obrad Stevanovic, Stretën Lukic, Vlastimir Djordjevic, dhe Zivko Trajkovic, si dhe shumë komandantë brigade në Korpusin e Prishtinës.



► Ushtarët serb në aksion duke i djegur shtëpitë e shqiptarëve!

Investimet e huaja në Kosovë

TASH PËR TASH NUK KA INVESTIME

Diaspora në SHBA, njihet si një komunitet shumë i fuqishëm ekonomik, por edhe ajo heziton të investojë në Kosovë për shkak të mos definimit të statusit.



Lulzim AHMETI

Të gjitha ndërmarrjet shoqërore që janë privatizuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), janë blerë më shumë nga vendësit se sa investitorët e huaj.

Gjiganti "Ferronikeli", (para lufte kishte një numër të madh të punësuarish) një kompani me ndikim të madh në ekonominë kosovare në të kaluarën është blerë nga kompania ndërkombëtare "Alferon". "Trepça" nuk është privatizuar, kurse KEK-u dhe Minierat e Kosovës pritet që t'u jepen me koncesion ndonjë kompanie ndërkombëtare që do të ndikonte në përmirësimin e situatës energjetike në Kosovë. Ndonëse është shpresuar shumë në investimet e diasporës shqiptare, kjo nuk ka ndodhur edhe pse Qeveria ka shprehur një vullnet të mirë në këtë drejtim.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Jashtme të Austrisë dhe Agjencinë për Zhvillim të Austrisë, Qeveria e Kosovës ka hapur zyrën për promovimin e investimeve të huaja, dhe në veçanti për promovimin e prodhimeve gjermanofone në Kosovë.

Qëllimi i kësaj zyre është që t'ua prezantojë vendeve gjermanofone aktivitetin e investimeve të huaja në Kosovë.

Udhëheqësi i kësaj zyre Kujtim Dobruna thotë se "zyra në Vjenë ofron shërbime për të gjithë investitorët e interesuar për të investuar në Kosovë.

Sipas Dobrunës qëllimi kryesor i zyrës në Vjenë është nxitja e interesit për Kosovën te kompanitë e huaja, të cilat përveçse kanë më shumë mjete për të

investuar, sjellin edhe teknologji të reja të punës, dhe kanë mundësi më të mëdha dhe traditë më të gjatë investuese. Sipas zyrtarëve të MTI-së, në të ardhmen do të hapen zyra të ngjashme në Angli, SHBA, Turqi e Suedi.

Diaspora në SHBA, njihet si një komunitet shumë i fuqishëm ekonomik, por edhe ajo heziton të investojë në Kosovë, për shkak të mos definimit të statusit.

Mimoza Kusari, Drejtoreshë e Odës Amerikane në Kosovë, thotë se Kosova ka një infrastrukturë solide ligjore që ka nevojë për përmirësim.

Ajo e arsyeton hezitimin e diasporës shqiptaro-amerikane për të investuar me pengesa të natyrës burokratike të nivelit të vendim marrjes, si nga institucionet vendase, po ashtu edhe nga ato ndërkombëtare.

Safet Gërxhaliu, Drejtor për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Odën Ekonomike të Kosovës, ka thënë se termi investime në Kosovë përmendet shumë, por investimet mungojnë, këtë e them për arsye se në qoftë se bëjmë krahasimin e investimeve në vendin tonë me rajonin, atëherë jemi shumë larg. Sipas disa raporteve për vitin 2006, vetëm në Bullgari ka pasur më shumë se 9 miliardë investime, po ashtu edhe në Serbi dhe Maqedoni ka pasur investime të mëdha. Sa i përket investimeve, Kosova mbetet e fundit. Sipas Gërxhaliut, nëse i bëjmë një analizë procesit të privatizimit në Kosovë, vërejmë se përparësi ka pasur shpejtimi i procesit të tenderimit, por efektet ekonomike kanë munguar dhe mund të numërohen me

**ODA EKONOMIKE
E KOSOVËS**



**KOSOVA CHAMBER
OF COMMERCE**

Përveç vëllezërve Krasniqi dhe Hari Bajraktarit, nuk ka investime të tjera nga diaspora në SHBA. Vëllezërit Krasniqi kanë investuar në energjetikë dhe janë të parët që kanë shfrytëzuar burimet hidroenergjetike në sektorin privat, kurse Hari Bajraktari është një nga afaristët shqiptaro-amerikan që ka investuar më së shumti prej mërgatës shqiptare.

Mimoza Kusari-Lila thotë se ka të interesuar për të investuar në disa sektorë, por ata vetëm marrin informata.

"Jemi në kontakt të vazhdueshëm. Vetëm në vitin e kaluar kemi pasur tre udhëtime me delegacione tregtare në SHBA, por interesimi është më i madh se sa ka investime.

Oda Ekonomike e Kosovës mendon ndryshe dhe nuk janë të kënaqur me investimet që vijnë nga jashtë.

gishta. Kurse sa i përket diasporës shqiptare, sipas Drejtorit për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Odën Ekonomike të Kosovës(OEK), investime direkte pa partner kosovar ka pak.

Sipas ekspertëve të ekonomisë investimet direkte nga investitorë të huaj dhe nga diaspora shqiptare mungojnë edhe për shkak të statusit politik të pa definuar të Kosovës. Kjo mbase ka ndikuar edhe për shkak të qasjes jo të mirë të qeverisë kosovare ndaj investitorëve të huaj në ekonominë kosovare. Mbase qeveria duhet të bëjë më shumë publicitet në vendet me ekonomi të zhvilluar rreth mundësive për të investuar në vendin tonë.

Me zgjedhjen e statusit, ekspertët e ekonomisë thonë se investimet e huaja në Kosovë do të rriten.

Botohet nga O.J.Q. "Zëri Ynë"

Redaksia

Drejtor: **Muhamed Jusufi - KAJOLLI**; Redaktor përgjegjës: **Shkelzen NUZA**; Redaktor gjuhësor: **Mimoza SINANI**; Redaktor Teknik/Grafika: **Osman D. GASHI**; Anëtarët e redaksisë: **Arber ZEKA, Ilir DESKU, Nexhati SPAHIU, Mergim LUSHTAKU, Gëzim QERIMI**; e-mail: **revistapaqja@gmail.com, revistapaqja@hotmail.com, revistapaqja@yahoo.com**; Adresa: **Xhavit Mitrovica, nr. 14 përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë**; Fusnotat e referencat e teksteve i mban redaksia. Kontakti: **+377 44 418 935, +377 44 637 111, +377 44 633 281**

Njerëzit më aftësi të kufizuara

Dua të jam i njëjtë, edhe unë mundem!

Donatorët që ka Kosova në projekte të ndryshme po zvogëlohen dita ditës. Kështu po ndodh edhe me donatorët që ka HandiKOS-i. Ata po përfundojnë misionet e tyre dhe nëse gjërat nuk ndryshojnë përgjegjësia mund t'i mbetet qeverisë.



Arber ZEKA

hen të lënë anash nga institucionet. Kush është ai politikan që mund të flasë për demokracinë funksionale apo demokracinë e bazuar në të drejtat e njeriut, nëse përjashton 10 % të popullatës?!

hmuar HandiKOS-in në asnjë projekt nga projektet madhore të saj, përveç se në disa qendra të ndryshme komunale të Kosovës, si në Therandë, Drenas dhe Malishevë, HandiKOS-i është ndihmuar kryesisht me shër-

Statistikat tregojnë se në Kosovë ekzistojnë mbi 100 mijë persona me aftësi të kufizuara, ndërsa institucionet kosovare janë kritikuar vazhdimisht se nuk kanë bërë sa duhet për zgjidhjen e problemeve të kësaj kategorie të shoqërisë. Nga shifra e lartpërmendur mbi 16 mijë janë të regjistruar vetëm në shoqatën e HandiKOS-it.

Në njërin prej fjalimeve të tij kryetari i HandiKOS-i, z. Halit Ferizi, ka qenë më i ashpri nga gjithë të tjerët duke thënë se:

Njerëzit me aftësi të kufizuara ndi-

Kjo çështje është mjaft shqetësuese dhe të gjithë së bashku duhet të angazhohemi që ta ndryshojmë këtë situatë.

Qeveria deri më tani nuk e ka ndi-

bime operative.

Shoqata e njerëzve me aftësi të kufizuara, HandiKOS-i, deri më tani ka arritur njëfarë marrëveshje të vetme që 5% të shpenzimeve t'i marrë përsipër vetë Ministria e Punëve dhe Mirëqenies Sociale. Menaxheri i programit të HandiKOS-it, z. Afrim Maliqi, shpreh mllefin e tij duke thënë se:

“Ku mbetën edhe shpenzimet për 95% e shpenzimeve të tjera, që anëtarëve tanë iu duhen gjithsesi?”

Ndër të tjera ai thekson se:

“Pas luftës tek ne është krijuar përshtypja e gabuar se të gjitha shpenzimet duhet të vinë nga jashtë, por kjo është gabim. Ne duhet të jemi ata që duhet t'i ndihmojmë vetvetes dhe njëri-tjetrit, dhe ky obligim duhet të bjerë mbi ne.”

Donatorët që ka Kosova në projekte të ndryshme po zvogëlohen dita ditës. Kështu po ndodh edhe me donatorët që ka HandiKOS-i. Ata po përfundojnë misionet e tyre dhe nëse gjërat nuk ndryshojnë përgjegjësia mund t'i mbetet qeverisë.

Programi i HandiKOS-it nuk është



► Të hendikeparit meritojnë përkrahje institucionale!

pranuar akoma nga qeveria. Ky program njihet si program që funksionon vetëm si program i një shoqate jo qeveritare.

Pse duhet të financohet HandiKOS-i? Ligji për mjekësi e nje programin e bazuar në bashkësi, por e nje vetëm si program. Mungojnë aktet në ligjore dhe ligjet që duhet të bëhen në Ministrinë e Shëndetësisë por edhe në ministritë e tjera. Ky program është program multi sektorial, pasi s'ka të bëjë vetëm me shëndetësinë, por ka të bëjë edhe me arsimimin, parapërgatitjen për shkolla dhe gjithë përfshirjen në shoqëri.

Shpresojmë se do të rregullohet diçka konkrete, por edhe ne do të organizohemi më mirë që t'i blejmë këto shërbime, pasi blerja e këtyre shërbimeve bëhet edhe në vende të tjera - thotë menaxheri i programit z. Afrim Maliqi.

Një rol të veçantë për personat me aftësi të kufizuar duhet të luajë edhe shoqëria, duke i trajtuar këta persona si pjesë të saj.

Programet kryesore të HandiKOS-it deri më tani kanë qenë të fokusuara: Në fushën e arsimit:

Identifikimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe evokimi për përfshirjen në arsimimin e rregullt gjithë përfshirës, ngritja e vetëdijes, edukimi dhe motivimi i prindërve mbi rëndësinë e arsimimit të fëmijëve të tyre dhe organizimi i kurseve për shkrim dhe lexim për të rinjtë, të rriturit dhe sidomos për femrat me aftësi të kufizuara në pjesët rurale.

Në fushën e shëndetësisë:

Identifikimi i nevojave të personave me aftësi të kufizuara përmes vizitave të drejtpërdrejta në familje, seleksionimi sipas llojit të aftësisë të kufizuara në bazë të diagnozës, parandalimi i pasojave, shkaktar i të cilave është aftësia e kufizuar, informimi, edukimi i vetë personit me aftësi të kufizuar dhe familjarëve të tij mbi shërbimet ekzistuese shëndetësore si dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre, dhe ofrimin e aktiviteteve të rehabilitimit primar fizik dhe edukativo-zhvillimor.



Personat e hendikepuar duhet që të inkuadrohen në jetën sportive. ◀

Në fushën e sportit dhe të kulturës: Organizimi i sporteve të ndryshme: basketboll, pingpong, atletikë, maratona, shah etj, organizimi i lojërave mini-olimpike, organizimi i kampeve "aktive rehabilituese", organizimi i shfaqjeve teatrale, si dhe organizimi i ekspozitave si: pikturë, skulpturë etj.

E tërë veprimtaria e HandiKOS-it, është e bazuar në njëzet e pesë zyra lokale nëpër komuna të ndryshme të Kosovës, ku organizohen këshillime të bazuara në përvojë dhe aktivitete të tjera. Po ashtu HandiKOS-i ka edhe dhjetë qendra të quajtura qendra të bashkësisë, detyra kryesore e të cilave është rehabilitimi i bazuar në bashkësi. Të gjitha këto zyra punojnë të pavarura njëra nga tjetra, por rregullat e punës janë të njëjta për të gjitha qendrat.

Preokupimet e shoqatës janë: parandalimi i aftësisë së kufizuar, promovimi, ofrimi i shërbimeve, si dhe njohja dhe pjesëmarrja e plotë e personave me aftësi të kufizuar në të gjitha nivelet institucionale dhe shoqërore.

Preokupimi ynë është nevoja për përmbushjen e kushteve elementare si: karroca, kukëza për personat me aftësi të kufizuar.

Një ndër sfidat kryesore për HandiKOS-in ka qenë dhe mbetet njohja dhe përfshirja e çështjes së aftësisë së kufizuar në politikat zhvillimore të Qeverisë dhe Shërbimeve të Bazuara në Bashkësi, nga institucionet qeveritare qendrore dhe lokale, duke u bazuar në dokumentet dhe praktikatat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

Mbështetjen më të madhe deri më tani për HandiKOS-in e kanë dhënë: Government of Finland, UNICEF-i, Save the Children in Kosovo, Finnish Human Right Project, Caritas Austria, OSCE e shumë të tjera, por fatkeqësisht akoma nuk është arritur marrëveshja shumë e nevojshme për donatorin kryesor, që duhet të jetë Qeveria e Kosovës, e jo qeveritë e tjera, pasi dihet se në shumicën e vendeve, për njerëzit me aftësi të kufizuar përkujdeset shteti e jo fqinjët.



**MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINISTRY OF HEALTH
MINISTARSTVO ZDRAVSTVA**



Organizohet edicioni i shtatë i Universitetit Veror Ndërkombëtar të Prishtinës

UNIVERSITETI I PRISHTINËS PO NDJEK LINJËN E KARTËS SË BOLONJËS

Në verën e vitit 2007, Universiteti i Prishtinës (UP) do të ketë rolin kryesor në organizimin dhe menaxhimin e edicionit të shtatë të Universitetit Veror me asistencën e Academic Training Association (ATA), e cila e ka organizuar dhe menaxhuar këtë program me shumë sukses për katër vite me radhë. Ky është viti i tretë me radhë që organizohet UVP nga Universiteti i Prishtinës.



Gëzim QERIMI

Programi i UVP-së për vitin 2005-2007 është më i vogël me qëllim që të garantojë vazhdimësi të ardhshme financiare. Do të organizohen 15 kurse me gjithsej 400 studentë, 250 kosovar dhe 150 studentë ndërkombëtarë. Nga 150 studentët ndërkombëtarë, 75 do të jenë nga Ballkani Perëndimor, si nga: Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Maqedonia, Mali i zi dhe Serbia, 75 të tjerë do të jenë nga Evropa Perëndimore dhe jashtë saj. Bursat po ashtu do të ofrohen për studentët e Universitetit të Mitrovicës. Diskutimet publike, ligjëratat etj. do të organizohen për çështjet kryesore të shoqërisë së Kosovës dhe të Evropës Juglindore. UVP është bërë një traditë e mirënjohur për akademikët e rajonit, meqë ka një përcjellje të gjerë mediale. UVP do të vazhdojë që të kontribuojë për përmirësimin e marrëdhënieve akademike në Evropën Juglindore. Natyrshëm, UVP i adreson nevojat e arsimit të lartë në Kosovë. Qëllimet e tij specifike janë:

1. Të stimulojë kooperimin akademik në Evropën Juglindore dhe të zhvillojë rrjetin rajonal profesional;
2. Të integrojë arsimin e lartë të Kosovës në sistemin evropian duke implementuar

linjat e kartës ose të veprimit të Bolonjës (p.sh. ECTS);

3. Të nxisë kooperimin e qëndrueshëm me profesorët vizitues dhe me universitetet e tyre;

4. Të përmirësojë kualitetin e arsimit (me anë të reformës së plan-programeve).

Edicioni i parë është mbajtur në vitin 2001 dhe është treguar i suksesshëm. Ky vuri themelet bazë në termat e infrastrukturës, kontakteve lokale dhe ndërkombëtare. prej të cilave mund të përfitojnë universitetet e ardhshme verore dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë akademikë.

Edicionet e vitit 2001, 2002 dhe 2003 tanimë kanë rezultuar me projekte, kështu që disa profesorë të UVP-së do të ligjërojnë në UP gjatë vitit të rregullt akademik, do të dërgojnë libra për bibliotekat e UP-së, etj. Universitet verore të cilat do të zhvillohen njëra pas tjetrës do ta bëjnë këtë Universitet një ngjarje viti dhe një traditë të mirë. Me përfundimin e edicionit të katërt në verën e vitit 2004, organizimi i projektit është transferuar gradualisht te personeli i Universitetit të Prishtinës, i cili e organizoi me sukses të madh edicionin e pestë dhe të gjashtë të UVP-së 2005 - 2006.

UVP 2001-2004 është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës. Për secilin vit UVP shpenzon diku rreth 380.000 euro. UVP 2007 është financuar nga Universiteti i Prishtinës bashkërisht me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës, Ministrinë e Arsimit të Kosovës, dhe nga Pro Credit Bank .



Projekti i UVP përbëhet prej 4 komponentëve vjetorë kthyes. Për çdonjërin komponent gjërat më të rëndësishme janë të përmbledhura si më poshtë:

I. Programi i kurseve

15 kurse që zgjasin nga tri javë;
15 profesorë ndërkombëtarë dhe nga rajoni, të cilët ligjërojnë pa pagesë;
Rreth 15 bashkë-profesorë nga UP; 20 pjesëmarrës (rreth 5 prej të cilëve nga jashtë) për kurs;

Metoda mësimore moderne interaktive;
Pajisja me materiale për lexim dhe materiale mësimore;
Ekskursione - punime jashtë klase;
ECTS plus certifikata për pjesëmarrësit e suksesshëm;

Nuk kërkohet pagesë. Pjesëmarrja falas.

II. Programet e forumeve publike

6 forume publike (nga 2 çdo javë) për çështjet më rëndësi për Kosovën dhe rajonin e më gjerë;

3 apo 4 anëtarë të panelit për forum;
Pjesëmarrja e lirë - pa numër të kufizuar;


III. Programi argëtues

Hapja dhe mbyllja solemne;
Darka e hapjes dhe ajo e mbylljes për personelin e UVP-së të përfshirë në projekt, për personelin e ATA-së dhe profesorët vizitorë dhe vendorë;

Ndejat e hapjes dhe të mbylljes për të gjithë pjesëmarrësit;

Ekskursione në rrethinën e Prishtinës me qytetet dhe vendet e tjera të shtunave dhe të dielave. Darka për studentët pjesëmarrës dhe për profesorin vizitor për secilin





Selia e Universitetit të Prishtinës ◀

kurs ndaras;

Programi për studentë në mensën e studentëve.

IV. Para trajnimi (para ushtrimi) i UVP-së, programi për bashkë-profesorë, për punëtorët e logjistikës dhe për personelin tjetër.

Trajnimi dyditor, duke përfshirë transportin, ushqimin dhe fjetjen;

Instruksione nga instruktorët ndërkombëtarë apo të rajonit, ose nga personeli i ATA-së;

Module relevante për ndërkombëtarizim akademik, ECTS, metodologjia moderne interaktive e mësimi, pro-

jekti i mësimdhënies në ekip, shkrimi i propozimit, përdorja e kompjuterit, internetit, aftësitë për komunikim dhe organizim dhe menaxhimi i projektit - të gjitha në lidhshmëri me UVP-në.

Bordi Drejtues i Universitetit Veror Ndërkombëtar në Kosovë:

1. Jehona Lushaku- Drejtoreshë e Zyrës për Marrëdhënie me Jashtë
2. Gëzim Qerimi – Nënkyetar i Parlamentit Studentor të Kosovës
3. Prof. Dr. Luan Ahma – Prorektor i Universitetit të Prishtinës
4. Prof. Dr. Ferdiqe Zhushi-Etemi – Koordinatore e ECTS
5. Fidan Hamiti- Zyrtar i Programit të UVP-së
6. Carola Schimdt - Përfaqësues ndërkombëtar nga ATA- Amsterdam
7. Prof. Dr. Isa Elezaj – Dekan i Fakultetit të F.SH.M.N-së
8. Prof. Dr. Safet Merovci- Profesor në Fakultetin Ekonomik në UP
9. Guri Shkodra –Përfaqësues nga organizata ndërkombëtarë ATA



▶ **Studentë gjatë kohës së Universitetit Veror**

Metodika në shkollat tona

SI MUND TË ARRIHET KOMPLETIMI I DIJES

Ndarja e fesë nga mësimi i metodikës në shkollë ka lënë shumë pasoja në interpretimin e përmbajtjeve në mënyrë racionale e profesionale. Por, gjërat kanë filluar të ndryshojnë dhe ka vend për optimizëm, sepse elementi fetar po përqafohet nga gjeneratat e reja, pasi pa njohjen e kësaj fushe është e pamundur nxënia e dijeve më të plota.

Fitim VELIU

Kur flasim për metodikën, flasim për një disiplinë të veçantë që merret me studimin e edukimit, ligjësive dhe arsimimit në kuadër të një lënde mësimore. Pra, metodika ka për qëllim aftësimin e kuadrove të reja të cilat do të punojnë nëpër shkollat tona. Këto kuadro para se të fillojnë implementimin e punës së tyre nëpër shkollat fillore dhe të mesme, duhet të pajisen me një dije metodike që në esencë është shumë e dobishme, por që për fat të keq shumë pak kuadro arrijnë ta përvetësojnë në planin gjithëpërfshirës të saj. Natyrisht që kjo shkencë është shumë e gjerë dhe komplekse, prandaj edhe kërkon njohjen e asaj që quhet kulturë e përgjithshme. Kur themi kulturë e përgjithshme kemi për qëllim të themi se kjo shkencë në planin shoqëror ka lidhje të ngushtë edhe me shkencat e tjera si: historinë, psikologjinë, filozofinë, etikën, sociologjinë, etj. Metodika pra është teoria e aplikimit të një lënde mësimore në shkollë dhe si e tillë kërkon nga çdo kuadër profesionalizëm të lartë në njohjen e shkencave ndërliidhëse të përmendura më lart. Pra të gjitha shkencat që i cekëm më lart, kanë metodikën e tyre si teori të apli-

kimit në planin konkret. Por në këtë rast do të trajtoja problemin e metodikës së gjuhës dhe të letërsisë si rast më specifik.

Kuadrot që profesionalizohen në këtë fushë, pa fajin e tyre, nuk arrijnë të pajisen me njohuri nga shkencat fetare dhe si pasojë e mosnjohjes së kësaj fushe lindin shumë probleme brenda procesit shkollor në aspektin e trajtimit të temës që del shumë e paqartë nëse profesori nuk zotëron njohuri nga shkencat fetare, dhe gjërat rimerren në mënyrë mekanike nga nxënësit si receptues dhe riprodhues të informatave. Meqë metodika merret me teorinë e organizimit të lëndës mësimore në shkollë, krahas kësaj teorie janë zhvilluar sisteme të ndryshme metodike siç janë: pozitivizmi, strukturalizmi, psikanaliza, hermeneutika, ku secila nga këto drejtime merret me trajtimin e letërsisë, pra në kuadër të saj me autorin apo veprën e tij në një aspekt apo tjetër. Pra secila nga këto disiplina ka funksionin e saj të veçantë në shpjegimin e fenomeneve letrare. Por a thua se këto drejtime mjaftojnë për mësimdhënësit në sqarimin e të gjitha çështjeve në planin praktik? Natyrisht se jo. Nëse pozitivizmi merret me faktet biografike, me statistika, emra, data, vite, strukturalizmi me veprën letrare konkretisht, psikanaliza me

gjendjen psikike si shfaqjen e pasioneve që ndikojnë në probleme të ndryshme letrare, pra të gjitha mund të merren si copëza në interpretimin e veprës letrare, por kurrë si përfundim logjik pa anën fetare, sepse gati të gjitha literaturat që mësohet sot në shkollat tona, kanë parabolë teologjike. Të gjitha tekstet që japin informacion mbi metodologjinë e mësimdhënies sot nuk e kanë të njohur faktin se pa shkencën fetare nuk mund të arrijmë rezultate të dëshiruara në punën tonë arsimore. P.sh. si do t'i interpretonim dy shkollat letrare: atë filobiblike, ku teksti letrar është derivat i tekstit biblik, apo shkollën e vjershëtarëve (bejtexhinjve) që është një shkollë e mirëfilltë letrare, por të cilën nuk mund ta kuptojmë pa e njohur diskursin kur'anor. Prandaj shtrohet pyetja: si do të arrinte një mësimdhënës ta shpjegonte krijimtarinë e dijetarit më të madh shqiptar, Sami Frashërit, pa e njohur kulturën islame? Mund të themi me plot të drejtë se mbi 70% e kuadrove në shkollat tona nuk njohin asnjërin diskurs në totalitet, por ndoshta vetëm në mënyrë sipërfaqësore, dhe problemi mbetet përsëri evident. Por e keqja më e madhe është se kur nxënësit pyesin profesorin për diçka që nuk e dinë, profesori në pamundësi për t'u përgjigjur dhe duke mos e njohur çështjen, bie në konfuzion dhe jep një përgjigje të pasaktë, duke i deformuar gjërat në tërësi.

Rrjedhimisht, është e nevojshme që metodika të përgendrohet në seleksionimin e informacionit të saktë psikologjik, didaktik e fetar në mënyrë që të jemi sa më të saktë në atë që u ofrojmë gjeneratave të ardhshme. Ndarja e fesë nga mësimi i metodikës në shkollë ka lënë shumë pasoja në interpretimin e përmbajtjeve në mënyrë racionale e profesionale. Por, gjërat kanë filluar të ndryshojnë dhe ka vend për optimizëm, sepse elementi fetar po përqafohet nga gjeneratat e reja, pasi pa njohjen e kësaj fushe është e pamundur nxënia e dijeve më të plota.

Prandaj shpresojmë se vetëm bashkimi i këtyre dy fushave të ndara do të përbënin një trup unik si mënyrë e funksionimit normal të procesit mësimor. Dhe do shpresojmë se organet tona përgjegjëse për shkollim do ta konsiderojnë elementin fetar si disiplinë të pandarë nga fushat e tjera dhe vetëm atëherë kuadrot do të arrinin të formoheshin me atë që quhet kulturë e përgjithshme.



► Edukimi nëpër shkollat tona nuk është në nivelin e duhur!

Familja e zgjeruar dhe sfidat bashkëkohore

Titullar kryesor në familje ishte burri

Në arsenalin e mjeteve dhe alternativave për ta përmirësuar këtë gjendje dhe për t'i luftuar këto sfida, ne duhet t'i japim krah sistemit të zgjeruar të familjes si mënyrë e vetme për zgjidhjen e qëndrueshme të problemeve bashkëkohore.

Emine VEZAJ

Familja e zgjeruar përkufizohet si një grup prej tre ose me shumë brezash që jetojnë së bashku ose brenda së njëjtës banesë ose shumë pranë njeri tjetrit. (A. Giddens) Nuk është e thënë që familja e gjerë të jetojë nën një çati, por normalisht anëtarët jetojnë afër njëri-tjetrit dhe punojnë së bashku në grupe. Familja që jeton në një shtëpi quhet "e zgjeruar në kuptim të banimit", ndërsa ajo anëtarët e së cilës kanë role të njëjta dhe janë të varur e të lidhur ngushtë në mes vete, por janë pak a shumë të shpërndarë quhet "funksionalisht e zgjeruar".

Familja e zgjeruar mund të përfshijë tre ose katër gjenerata. Këta mund të jetojnë dhe punojnë së bashku në një ekonomi të përbashkët shtëpiake, ose si një bashkësi fisnore e gjerë, që lidhet nëpërmjet marrëdhënieve shoqërore. Format më të shpeshta të familjes së zgjeruar në shoqërinë shqiptare janë të modelit: tre breza (fëmijë, prindër dhe gjysh e gjyshe, me radhë edhe axhallarë e halla) nën një çati ose në një oborr ose pranë njëri tjetrit. Çdo shoqëri në vazhdimësinë e saj bën përpjekje për gjetjen e mënyrave më të përshtatshme që rregullimi i marrëdhënieve familjare të reflektojë vlerat e shoqërisë dhe njëherësh të jenë në përputhje me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Por gjithsesi krahas kësaj që thamë, që nga kohërat më të hershme të historisë njerëzore, siç ka shënuar S. R Reiber, "religjioni dhe familja kanë qenë të lidhura ngushtë. Të dyja kanë ndikim mbi njëra-tjetrën...As që mund të kuptohen tërësisht të ndara njëra nga tjetra." Për këtë qëllim, do të shqyrtojmë strukturën familjare në kontekst të sistemit tradicional patriarkal shqiptar dhe të fesë dhe shoqërisë klasike muslimane. Pra thënë në përgjithësi, meqë kohëve të fundit, institucioni shoqëror i quajtur familje ka bërë disa ndryshime nga ana përmba-

jtësore në aspektin familjar, është e udhës që të flitet për anën pozitive dhe negative që ka familja e zgjeruar.

Sistemi familjar patriarkal shqiptar:

Të merresh me dukuritë e reja në zhvillimin e shoqërisë e familjes shqiptare pas vitit 1990, të krijuet përshtypja se duhet të flasësh apo të shkruash për gjithçka, ngaqë ndryshimi është i njëmendtë. Në mënyrë të shpejtë, më shumë spontane dhe mjaft kontradiktore ka ndryshuar gjithçka. Shikuar sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, (KLD-së), në KLD dallohen dy lloje kryesore të familjes; familja e madhe, e mbështetur në pronësinë e përbashkët të pjesëtarëve të saj meshkuj, dhe familja e vogël, e bazuar në pronësinë private të të zotit të shtëpisë dhe në pushtetin e tij absolut kundrejt gruas dhe fëmijëve. Në përmbledhjen e Gjeçovit, ekziston këshilli i familjes së madhe dhe ai merr vendime mbi veprimet më të

rëndësishme që i referohen familjes dhe pasurisë së tij. Dhe thënë në përgjithësi, familja shqiptare ishte pjesë e një sistemi patriarkal, ku si titullar kryesor në familje ishte burri.

Kultura shqiptare më tepër e përkrah sistemin e zgjeruar të familjes se sa atë bërthamë. Shumë familje shqiptare edhe sot janë të zgjeruara në kuptim të banimit – d.m.th, anëtarët e atyre jetojnë bashkë me tre apo më shumë breza të të afërmeve në një shtëpi apo afër njëri-tjetrit. Edhe atëherë kur ky version banimi i familjes së zgjeruar nuk është i mundur apo nuk preferohet, atëherë lidhjet familjare tejkalojnë kufijtë e njësisë bërthamë dhe janë të dukshme në lidhjet e fuqishme psikologjike, sociale, ekonomike dhe bile edhe politike.

Meqë tashmë konsiderohet se struktura e familjes shqiptare tradicionale ka ndryshuar. Disa alternativa që janë pro dhe contra një ndryshimi të këtij sistemi.



Fëmija i shëndoshë, përkujdesje e ngrohtë! ◀

Familja tradicionale dhe alternativat

Familja "tradicionale"

- Jetesë e përbashkët
- Martesë ligjore
- Lidhje relativisht të qëndrueshme
- Ekskluziviteti seksual i individëve të lidhur në martesë
- Lidhje e një burri me një grua
- Marrëdhënie heteroseksuale
- Prania e dy prindërve në familje
- Lindje dhe rritje fëmijësh
- Burri si burim i parë i të ardhurave
- Burri si autoritet kryesor
- Kriteri moral dhe forca e opinionit

Familja "jotradicionale"

- Partner që jetojnë larg njëri-tjetrit
- Bashkëjetesë (qoftë edhe ligjore), por pa lidhje martesore ose individ të pamartuar
- Paqëndrueshmëri, divorci, rimartesa
- Seksi jashtëmartesor, martesa seksualisht të hapura
- Marrëdhëniet seksuale brenda të njëjtit seks
- (Homoseksualiteti lezbizmi)
- Familje me një prind, me prindër të divorcuar apo të ve; familje me njeri/njerkë, etj
- Parapëlqim për të mos lindur fëmijë, për të birësuar e marrë në kujdestari; fëmijë nga dy bërthama; nga martesa e mëparshme etj.
- Prirja për barazi e ndihmesa të përbashkëta (të paktën si një prirje apo realitet i pjesshëm)
- Prirja për martesë dhe familje "të hapur", me të drejta, detyrime e përgjegjësi të barabarta
- Prirja për largimin e jetës personale nga kriteri moral.

Familja e zgjeruar, formë tradicionale e familjes islame:

E gërshetuar me varësin e ndërsjellë, familja e zgjeruar është karakteristike themelore e shoqërisë kur'anore që shërben për të përmirësuar marrëdhëniet mashkull-femër. Përveç anëtarëve të ngushtë, që përbëjnë familjen: nëna, babai dhe fëmijët e tyre – familja islame përfshin gjithashtu gjyshërit, xhaxhallarët, tezet, hallat, dhe

pasardhësit e tyre. Solidariteti i familjes së zgjeruar, rekomandohet dhe fuqizohet prej Kur'anit të shenjtë, në të cilin gjejmë referenca të përsëritura për të drejtat e fafesisnisë dhe rëndësinë e trajtimit të tyre me dashamirësi.

Dhe megjithëse Kur'ani nuk rekomandon kurrfarë lloji të veçantë të organizimit familjar, nuk ka dyshim se struktura tradicionale e familjes muslimane aktualisht ka qenë më afër llojit të zgjeruar sesa atij bërthamor. Kjo me siguri është rezultat i vazhdimësisë, e jo rezultat i ndonjë risie nga muslimanët. Nëse ka ngjarë që organizimi familjar në shoqërinë muslimane e ka pranuar, apo më mirë e ka vazhduar këtë formë të zgjeruar, nuk ekziston kurrfarë klauzole që t'i japë atij një miratim apo mospëlqim universal. Mirëpo, pavarësisht se a ishte gjerësia e strukturës së familjes muslimane funksion i vazhdimësisë historike apo i kushteve të tjera shoqërore, Islami në dukje e pranoi këtë formë dhe nuk mori kurrfarë qëndrimi tjetër për të, për dallim nga qëndrimi i tij për aspekte të tjera të ndryshme të familjes.

Familja e zgjeruar është një institucion, që mund të ketë dobi të mrekullueshme për burrin dhe për gruan. Familja e zgjeruar veçohet për faktin se:

1. ajo mbron nga egoizmi apo ekscentrizmi i ndonjë grupi, sepse individit përballë jo vetëm me një bashkëshort të vetëm, por me një familje të tërë të barabartësh, të moshuarish dhe fëmijësh.
2. ajo u mundëson grave të ndjekin karrierën, pa dëmtuar vetveten, bashkëshortin, fëmijët apo të moshuarit, ngaqë ekzistojnë gjithmonë të rritur të tjerë në shtëpi, për të ndihmuar në punët e gruas apo të nënës...
3. familja e zgjeruar siguron një shoqërim të mjaftueshëm të fëmijëve. Këshilla e nënës apo babait, në një familje të ngushtë apo të vetme, vështirë se mund të ndiqet nga një i pabindur apo fëmijë kokëfortë, ndërsa ndikimi i kombinuar i anëtarëve të një familje të zgjeruar, është i efektshëm

kundër pabindshmërisë apo padëgjueshmërisë.

Këto dhe disa karakteristika të tjera që ka radhitur Lois Lamya Faruki, bëjnë që familja e zgjeruar të mbajë epitetin e një trangu të fortë që do t'i mbante anëtarët e shoqërisë të fortë dhe të pathyeshëm përballë sfidave të kohës.

Situata bashkëkohore e familjes është përcaktuar si një "gjendje e papëlqyer", një "dilemë", një "tragjedi"; dhe disa e përcaktojnë shqetësimin si një "prishje të furishme të një sistemi" (Carle C. Zimmerman, cituar prej Adams 1973, f. 353). Në problemet me të cilat janë duke u përballur shoqëritë në radhë të parë klasifikohet roli i grave. Një pjesë e madhe e popullsisë së gjinisë femërore është duke përmbushur rolin e mashkullit dhe të femrës në të njëjtën kohë. Në të shumtën e rasteve, këto gra kanë dështuar pa ia dalë mbanë në të dy rolet. Si pasojë e luftës së tyre, anëtarët meshkuj të shoqërisë janë, gjithashtu, duke u shtyrë drejt një roli të dyfishtë korrelativ – për të qenë mirëmbajtës dhe fitues së rrogës, në të njëjtën kohë që ata përkujdesen për fëmijët, gatuajnë ushqim, lajnë dhe hekurosën. Një përzjerje e tillë e përgjegjësisë, qoftë për femrat apo për meshkujt, priret për të përfunduar në një dështim. Problem tjetër në shoqëritë bashkëkohore, konsiderohet vetmia. Fati i të moshuarve është jeta në vetmi, pa kontaktin e brezave, vetmia dhe izolimi i tyre ndërpritet vetëm prej vizitave të rastësishme dhe të detyrueshme të fëmijëve, apo nipave dhe mbesave. Kur ata bëhen të paafte për të kryer nevojat fizike, ata dërgohen në azile, apo në shtëpitë që përkujdesen për pleqtë, ku presin vdekjen. Problem tjetër është edhe shthurja morale, pastaj problemi i prindërve dhe shumë probleme të tjera. Këto janë një sfidë dhe ne si shoqëri e një sistemi tradicional të familjes së zgjeruar, shoqëri e një sistemi patriarkal, dhe shoqëri e respektimit të urdhrave fetar, jemi duke shkuar dalëngadalë në humbjen e çdo respekti për këtë sistem familjar. Por çdo sëmundje ka shërimin, dhe çdo sfidë ka edhe mënyrën e përballimit dhe të evitimit të suksesshëm. Vështirësitë e tilla mund të lehtësohen me anën e një sistemi të zgjeruar familjar, në të cilin më të mëdhenjtë apo anëtarët e tjerë do të ndihmonin në vazhdimin e jetës në binarë normalë pa u dëmtuar asnjëra palë, ku fëmijët do të mund të përkrahen prej hallave, xhaxhallarëve apo prej gjyshërve, të cilët janë "në skenë" për të mbështetur çdo vendim të të rriturve dhe çdo problem do të mund të tejkalohet në mënyrë të drejtë pa u dëmtuar askush. Në arsenalin e mjeteve dhe alternativave për ta përmirësuar këtë gjendje dhe për t'i luftuar këto sfida, ne duhet t'i japim krah sistemit të zgjeruar të familjes si mënyrë e vetme për zgjidhjen e qëndrueshme të problemeve bashkëkohore.



► Edukimi i femrës, familja është më e fortë dhe më e shëndoshë!

Ndryshimet postmoderne në kulturën shqiptare

Këngëtarët shqiptarë shquhen për imitime në dukje

Sfilatat e modës dhe zgjedhjet e miseve janë evenimentet 'më kulturore' që i kanë zëvendësuar festivalët e dikurshme (siç ishte p.sh: 'Kosovarja këndon', 'Akordet e Kosovës'), mitingjet e poezisë, ekspozitat e pikturave, promovimet e librave.



Avni AVDIU

Muzika në tërësi po rrëshqet nga konturët e tradicionales dhe modernes. Ajo i është ekspozuar rrëkeve të ritmikes, mishmashit kulturor dhe shijeve ekstravagante.

Ajo është pjesë e reprodukimit serik të qiçit të fabrikuar për konsum masiv.

Vargjet e disa këngëve shqipe kohëve të fundit janë jo vetëm të pakuptimta, por edhe qesharake. Në to s'ka kurrfarë mesazhi, sepse çdo ide për thurjen e tyre është e zbrazët dhe pa takt. Në të shumtën e rasteve ato s'kanë edhe kurrfarë teksti pos pasthirmave dhe ulërimave të çuditshme. Pra thjesht teksti formulohet gjatë momentit të interpretimit, sepse nuk ka kurrfarë lidhje me ndonjë temë, nuk ka as fillim, as mes dhe as mbarim. Përmes piskamave hajde - hajde, kalle - kalle, urra - përr...etj, nuk mund të kuptohet se ajo muzikë është lëshuar për t'i ndërsyer kafshët, apo për t'i frikësuar ato për të mos hyrë arave.

Ludvig Gici fliste edhe për qiç njeriun, i cili është i predisponuar që të shikojë gjithçka nga prizmi qiçerik, qoftë edhe artistiken. Prandaj mund të thuhet se qiç njeriu ndien nevojë për qiç-veprën dhe përderisa kjo është kështu, nuk mund edhe aq lehtë të thuhet se qiçi është i imponuar. Ndoshta ai është edhe i dëshiruar.

Thjesht rokada veç më ka ndodhur. Në vend se artistët të përpigjen për t'u përshtatur ndaj vlerave artistike, publiku është ai që në masë të konsiderueshme i është përshtatur nivelit të rëndomtë që ka pushtuar tregun muzikor.

E dislokuar në spektakle të ndryshme, spote televizive dhe manifestime fes-

tive, muzika pothuajse e neutralizon karakterin e vet tonik, përmes imazheve ose thënë më ndryshe zëvendësohet mungesa e plotë e vokalit me imazhe. Në veçanti këtu vijnë në shprehje këngëtarët, të cilat më tepër bëjnë ekzibicione sesa këndojnë. Për aspektet tonike përkujdeset teknologjia, gjithçka këndohet 'playback', prandaj mjafton që këngëtarja vetëm t'i lëvizë buzët. Ajo më së shumti duhet të përkujdeset që të lëvizë pjesët e trupit, të dridhet e përdridhet kuptohet sa më tepër të jetë mundësia (dhe aq sa ia duron karakteri) të zhvishet dhe me gjestikulime provokative të joshë publikun.

Edhe garipat meshkuj, mund të shihen në videoklipe të rrethuara nga femrat, që u fërkojnë për trupi. Formula e të zhveshurit nëpër videoklipe, është një hap që edhe këngëtarët e patalentuara të ngjiten majave të suksesit. Pra 'logjika e re e artit' nënkupton që më shumë duhen vlerësuar videoklipet sesa kënga dhe interpretimi i saj. Qëllimi kryesor është të qenurit interesant, qoftë edhe përmes skandaleve.

Mu për këtë tashmë po thyejnë qafën

duke vrapuar në incizimin e videoklipeve, çdo muaj, javë...Radha e këngëtarëve që presin në studiot që realizojnë spote është njësoj si dikur në mulli. Dallimi qëndron vetëm se në mulli dikur respektohej radha dhe zbatohesh njëfarë rendi.

Këngëtarët shqiptarë shquhen edhe për imitime në dukje, pozime dhe gjestikulime.

Duke komentuar festivalin "Çelësi muzikor 2006", të transmetuar drejtpërdrejt edhe në RTK, një e përditshme në shkrimin me titull: "Më shumë reklamim brekësh sesa performim muzikor", hodhi në shesh karakterin kontrovers të manifestimeve të tilla. "Publiku ka pasur mundësinë që në skenë të shohin koleksione brekësh të llojllojshme të firmave dhe ngjyrave nga më të ndryshmet...", thuhej në mes tjerash në atë shkrim.

Për voajeristët nuk është vetëm ky moment i volitshëm. Nëse duan, ata mund t'i kapin me syrin e tyre vibrues edhe pamjet indirekte, ato që kamera nuk ia arrin dot. Bodrijar 'indirekte' e quajti atë që nuk mund të xhirohet.



Shturja moderne!

Për ta ka edhe çaste më sensacionale. Sfilatat e modës dhe zgjedhjet e misëve janë evenimentet 'më kulturore' që i kanë zëvendësuar festivalet e dikurshme (siç ishte p.sh: 'Kosovarja këndon', 'Akordet e Kosovës') mitingjet e poezisë, ekspozitat e pikturave, promovimet e librave.

Se këto konsiderohen ngjarje 'më kulturore' dëshmon fakti se ato në të shumtën e rasteve zhvillohen nën patronazhin e Ministrisë së Kulturës dhe ku me praninë e vet 'nderon' edhe ministri, i cili në fund ndan shpërblimin e fitueses. Gjithashtu spektaklet kryesore i transmetojnë drejtpërdrejt edhe mediat. Sfilatat e modës dhe zgjedhjet e miseve tashmë nuk ndodhin çdo vit, por pothuajse çdo tre muaj. Zgjedhja e misit të qyteteve, e Shqipërisë, e Kosovës, e shqiptares në Maqedoni, Mal të Zi, diasporës (e shqiptares në Amerikë, e shqiptares në Zvicër etj), e revistave e kështu me radhë. Te vajzat konkurrenente kompleksi i zhveshjes nuk ekziston më as si ide. E gjysmëzhveshur, vajza që pretendon mbretërinë e bukurisë, krijon përshtypjen e personit që mezi ka pritur të çlirojë trupin nga barrët e hipokrizisë morale. Femra shqiptare me një rebelizëm të paparë synon defilimet e saj drejt kërkimit të sukseseve. Secila demonstroi hapur të drejtën e saj për ta ekspozuar intimitetin e sovranitetit trupor, për ta nxjerrë në pah sensualitetin e saj dhe për ta këndellur shqisoren e të tjerëve. Me freski ironike, me arrogancë subtile dhe me revoltën e shprehur në buzëqeshje, ato vihen me sharmin e tyre përballë sfidimit të rendit rigjid vleror që u kundërvehet me një fjalë të vetme 'skandal'. Edhe prindërit e dikurshëm fanatikë jo vetëm se janë zbutur, por edhe krenohen. Ndoshta së shpejti ata do të arrijnë edhe atë nivel sa do të krenohen edhe me karakteristikat trupore të vajzave të tyre.

Qindra vajza synojnë kurorën e misit. Dhe gjasat e fitores nuk janë edhe të pakta, sepse ka shumë kurora: mis-buzëqeshja, mis-inteligenca, mis-eleganca, mis-bikini, mis-përcjellësja e parë, e dytë e kështu me radhë. Kurora e misit ka domethënie të madhe për fituesen. Ajo automatikisht bëhet personalitete e njohur, e kërkuar dhe e ftuar për intervistime të shumta. Popullariteti garanton qasje të reja edhe në botën e biznesit: në film, prezantim, art dhe në marketing. Zaten shumica e tyre menjëherë përfshihen edhe në sfilata mode dhe manikenizëm. Trupi i tyre zhvendoset në interesat e marketingut për t'u bërë pjesë e biznesit. Mu për këtë edhe zgjedhja e miseve ka aq kuptim të rëndësishëm për femrat, sepse bukuria me vete tërheq edhe paranë, famën,

prestigjin, lumturinë... Këtu projekttohet edhe dëshira e prindërve, për të cilët nuk ka më rëndësi se çfarë thonë të tjerët dhe se si e komentojnë ata këtë. 'Absolutisht - sikur duan të thonë ata - për këtë punë jemi marrë vesh të mos merremi vesh, ngase tekefundit qentë mund të lehin, por karvani s'ndalet'. Kjo do të ishte gjuha implicite që nënkupton thyerjen e paradigmave konservative tradicionale për të cilat ende 'nderi i njërit në familje e farefisni nënkupton nderin e të gjithëve'. S'ka më shabllone kanunore, s'ka më vlera apriorikisht të vendosura diku në pika të koordinatave që faktikisht s'ekzistojnë më.

Madje sfilatat e modës dhe zgjedhja e miseve s'ka përse të dramatizohet edhe aq nga 'moralistët', sepse në një mënyrë ose në një tjetër rrugët tona janë stërm-bushura me gjëra të tilla të përafërta. Ecjet e vajzave rrugëve nënkuptojnë edhe njëherë edhe tjetër. Nga njëra anë është defilim përpara syve të kalimtarëve me këmbë, gjoks e kërrthizë të zbuluara, kurse nga ana tjetër prezantim ose reklamim i modeleve të ndryshme të modës. Moda thjesht nuk është e tillë çfarë jemi mësuar ta kuptojmë, por më mirë shprehur ajo është një post-modë. Eleganca dhe pedantizmi është shndërruar në ekstravagancë të veshjes. Të jesh i veshur 'chic' nuk do të thotë që rrobat të jenë edhe aq të kushtueshme (sepse edhe ashtu xhepi është i rrudhur). Mirëpo edhe me rrobe të thjeshta bëhen kombinime që arrijnë efekte. Minifundet në kombinim me çizmet e gjata, farmerkat e grisura qëllimisht, ose diku-diku të theksuara me ngjyra ose të vëna mbi to pareo, lidhja e së cilës rreth

belit forcon nuancat e joshjes dhe fustanet e tejdukshme që bëjnë të mundur dukjen e të brendshmeve, janë disa nga mënyrat që thjesht e lirë të bëjnë 'chic' dhe të japin dukje lezhere. Ultramoderne janë edhe veshjet e ngjitura për trupi. Edhe pantallonat e shkurtra të kombinuara me xhepa e lidhëse. Fanelat e stolitura me arna po ashtu ofrojnë një seksi-luk. Shumica e këtyre vajzave gjatë të ecurit ndonëse heqin të zitë e ullirit, por megjithatë ia arrijnë që të ecin disi, duke i shtyrë vithet mbrapa që të duken 'më perfekte'. Edhe për këtë problem është përkujdesur teknologjia e re, çka në të ardhmen pritet t'ua ndalë vuajtjet femrave. Në gusht të vitit të kaluar anekënd u përcoll informacioni i 'Uashington Post'-it me titull: "Shpiket makina për ngritjen e vitheve", ku thuhet se bëhet fjalë për njëfarë mbajtëse të bërë nga llastikë, e cila pasi vihet në bel mund të ngrëjë vithet. Një 'push up' për gjokset veç më ekziston. Po ashtu kujtojmë edhe mënyrën e fryrjes së tyre përmes silikoneve.

Me gjasë për t'ia arritur kësaj ndihmë të nevojshme u ofrojnë taket e larta, zhurma e të cilave edhe po nuk deshte ta tërheq vëmendjen për të shikuar. Në disa raste këto veshje kanë edhe mbishkrime në gjoks ose mbrapa në vithe: "Just do it", "kiss me", "touch me" etj. Bartëset e këtyre veshjeve përcjellin qëllimisht mesazhe provokative për kalimtarët, të cilët siç thotë populli 'i çojnë te pusi, por nuk u japin ujë'. Vajzat e veshura 'cool' priten me buzëqeshje nga meshkujt dhe kanë privilegje kudo.

Kjo situatë krijon një gjendje tensionuese mentale, materiale dhe morale. Gjithçka lëviz, por asgjë nuk ndryshon, sepse të tërë janë të destinuar në reprodhimin e reales, të gjithë janë të dënuar me 'kthimin e përhershëm të së njëjtës'. Mendimi është dezorientuar në lëmshin e fragmentuar të ngjarjeve zigzage dhe diskrete. Fitohet përshypja siç do të shprehej Dejvid Kuper se "në të vërtetë shoqëria ka nevojë për çmendinë si mënyrë e dekonstruktimit të normalitetit me të gjitha implikimet represive, suprimuese, degraduese ndaj manifestimit të individualitetit". Aftësia për mohimin dhe për luftimin e një gjendjeje të këtyre është e rrezikuar dhe e dënuar të pështillet në vorbullën e mospërfilljes. Ngjarjet thjesht e tejkalojnë njëra-tjetër, duke krijuar mjegull e tym që turbullon vizionin e së ardhmes. Futuristët ndodhen në supozime shterpe. Ndërkaq larg në horizontin e fabrikimit të së mundshmes dielli i reales paralajmëron ardhjen e 'post historisë'.



Veshja "përparimtare"!

Ministri më punëtor i Qeverisë së Kosovës

HARAQIA NUK KA TË NDALUR

Ministri i ka rregulluar punët aq mirë në vendin e tij, sa që po ka mundësi të ndihmojë edhe organizimet në Tiranë. Normalisht se nuk është kështu. Dihet se në çfarë gjendje është në Kosovë teatri, filmi, libri, muzika etj. Dihet se krijuesit, aktorët, këngëtarët e muzikës serioze, për mungesë të mjeteve financiare, mbesin pa i realizuar projektet e tyre artistike me vlera të mirëfillta, pa vjedhje të këngëve, siç ngjet me shumë këngëtarë që i ka financuar ose preferon t'i financojë në të ardhmen Haraçija.

Adil OLLURI

Ministri i Kulturës në kabinetin Çeku, Astrit Haraçija, me veprimet e tij të deritanishme, na bën ta quajmë ministër të jo kulturës, të shuntit dhe kulturës komerciale. Këtë na e dëshmon vetë ai me veprimet e tij të pandalshme në dëm të vlerave të mirëfillta të kulturës dhe buxhetit të varfër të Kosovës. Ai me moton "I kam harxhit paret e babës, e lere më të Ministrisë", po bën kërdi në këtë buxhet, gjë për të cilën në vendet me zhvillim normal të demokracisë, do të duhej të jepte llogari para ligjit dhe eprorëve të tij. Por, në vendin tonë punët shkojnë ashtu siç shkojnë.

Ky ministër, padyshim një partizan partiak që nuk ka aspak haber për punën që bën, ditë më parë ka dhënë "një ndihmë" prej rreth 20 mijë eurosh për Video Festin, një festival komercial i muzikës argëtuese, i organizuar nga televizioni privat tiranas, Top Chanel. Pra, qysh në fillim ndeshemi me befasinë! Athua ky njeri, zyrtar i lartë i Qeverisë së Kosovës, i ka rregulluar punët aq mirë në vendin e tij, sa që po ka mundësi të ndihmojë edhe organizimet në Tiranë?! Normalisht se jo. Dihet se në çfarë gjendje është në Kosovë teatri, filmi, libri, muzika, etj. Dihet se krijuesit, aktorët, këngëtarët e muzikës serioze për mungesë të mjeteve financiare mbesin pa i realizuar projektet e tyre artistike, me vlera të mirëfillta, pa vjedhje të këngëve, siç ngjet me shumë këngëtar që i ka financuar ose preferon t'i financojë në të ardhmen Haraçija.

Kjo nuk është hera e parë që ky ministër e keqpërdor buxhetin kësisoj. Ai edhe më herët i ka ndarë 150 mijë euro për një festival privat të Ardit Gjebresë, si dhe rreth 15 mijë euro për një album të

këngëtares Arbërie Hadërgjonaj, me të vetmin arsyetim se i pëlqejnë këngët e saj. Dhe për asnjë nga këto shpenzime nuk ka dhënë llogari para askujt. Njëlloj po vepron edhe sot.

Lidhur me këtë shpenzim të panevojshëm kanë shprehur reagimin e tyre edhe njohësit e fushave të ndryshme të kulturës, edhe pse ky reagim ishte paksa i zbehtë. Ata shprehën kundërshtimin e tyre në lidhje me këtë veprim të Ministrit, duke i thënë atij se Video Festi është një organizim privat dhe komercial dhe nuk i takon Ministrisë kosovare të Kulturës ta financojë këtë veprimtari, kur dihet mirëfilli gjendja kulturore në Kosovë.

Si duket ministri e ka harruar se detyra e Ministrisë që ai drejton është promovimi dhe zhvillimi i aktiviteteve të pas-tra kulturore, zakonisht ato aktivitete publike, por edhe ato të natyrës private kur janë në pyetje vlerat kulturore, e jo t'i financojë organizimet komerciale, të cilët edhe mund të vetëfinancohen, dhe të mbahen shumë mirë edhe pa "ndihmën dhe shpirtgjerësinë" e ministrit. Dhe këtë veprim Haraçija "humanist" e bën në kohën kur në Kosovë nuk ka asnjë revistë letrare. Me ato njëzetë mijë euro do të botohej revista letrare "Fjala", së paku për tetë vite. Po kujt t'i flasim. Vetëm duhet të presim e të bëjmë sehir se çfarë sihariqi do të pjellë nesër.



Astrit Haraçija ◀

Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

Në fokus pavarësia e mbikëqyrur dhe “faktmbledhësit”

Demir RESHITI

Nocioni “pavarësi e mbikëqyrur” për Kosovën, të cilën e ka propozuar kryendërmjetësi Ahtisaari, ka filluar të përmendet shpesh nga personalitete kyçe të politikës ndërkombëtare. Ky propozim, ka qartësuar pozicionimin e



Martti Ahtisaari ◀

shteteve anëtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, pro dhe kundër “pavarësisë...”. Rusia si aleate tradicionale e Serbisë, ka vazhduar të këmbëngulë në qëndrimin e saj se nuk do të njohë ndonjë zgjidhje të imponuar për statusin. Madje me kërkesën e Rosisë, në Kosovë është dërguar një delegacioni faktmbledhës i Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Ky delegacion i përbërë nga ambasadorët e 15 vendeve anëtare të KS, nën udhëheqjen e ambasadorit belg Johan Verbeke, ka qëndruar në Kosovë në fund të muajit prill... Në vazhdim po e paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, në periudhën 11 prill - 10 maj 2007.

(11 prill) Cobel: Kosovës t'i jepet sa më parë pavarësi e mbikëqyrur

Beograd – Ambasadori gjerman në Serbi, Andreas Cobel, ka deklaruar në Beograd, se çështja e Kosovës duhet të zgjidhet sa më parë duke i dhënë asaj pavarësi të mbikëqyrur, “sepse në të kundërtën, mund të hapen probleme në Vojvodinë dhe Sanxhak”.

(12 prill) Ahtisaari merr mbështetjen e Ganës për planin e tij


Akra – I dërguari i posaçëm i OKB-së për statusin e Kosovës, Martti Ahtisaari, ka marrë mbështetjen për planin e tij, nga

Presidenti dhe ministri i Punëve të Jashtme të Ganës, që është anëtare e përkohshme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

(13 prill) Clinton: Nuk ka fitore tjetër përpos suksesit

Nju Jork – “Nuk ka fitore tjetër përpos suksesit dhe se fitorja e vetme është një vend i suksesshëm ekonomikisht dhe politikisht”, ka thënë ish-presidenti amerikan, Bill Clinton, në Nju Jork ku është diskutuar për sfidat që e presin Kosovën në 120 ditët e para pas statusit.

(15 prill) Rezolutë për Kosovën në Kongresin Amerikan



Bill Clinton ◀

Uashington – Në Dhomën e Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan, është dorëzuar rezoluta me të cilën kërkohet nga Shtëpia e Bardhë të mbështesë pavarësinë e Kosovës.

(16 prill) Rohan: Kosova e pavarur deri nga fundi i verës

Zagreb – Kosova do të duhet të jetë e pavarur deri nga fundi i verës, ka deklaruar zëvendësi i të dërguarit të posaçëm të OKB-së për Kosovën, Albert Rohan, për gazetën kroate “Jutarnji List”.

(17 prill) Burns: SHBA-ja do të mbështesë deklarinimin e popullit të Kosovës për pavarësi

Uashington – SHBA-ja do të mbështesë deklarinimin e popullit të Kosovës për pa-

varësi, nëse në Këshillin e Sigurimit të OKB-së nuk miratohet rezoluta e re, ka deklaruar nënkretari amerikan i shtetit Nicholas Burns gjatë një seance dëgjimore për Kosovën në Komitetin për Marrëdhënie me Jashtë të Dhomës Përfaqësuese në Kongres.

(18 prill) Churkin: Qëndrimi amerikan ndaj Kosovës është destruktiv

Moskë – Rusia nuk do ta mbështesë rezolutën amerikane për Kosovën në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, në qoftë se me këtë rezolutë nuk pajtohet pala serbe, ka deklaruar ambasadori rus në OKB, Vitaly Churkin.

Ndërkaq, shefi i diplomacisë ruse, Sergej Lavrov, të njëjtën ditë pas takimit me homologun e tij spanjoll, Miguel Angel Moratinos në Madrid, ka thënë se qëndrimi i Rosisë për Kosovën ndryshon nga ai i SHBA-ve.

(19 prill) Kosova hiqet nga agenda e BE-së

Bruksel – Kosova është hequr nga rendi i ditës i takimit të BE-së. Zyrtarët të BE-së heqjen e Kosovës nga rendi i ditës e kanë arsyetuar me faktin se tani diskutimi ka shkuar në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

(20 prill) Polt: SHBA-ja e vendosur që deri në verë të sjellë rezolutën për Kosovën

Beograd – Ambasadori amerikan në Beograd Michael Polt ka deklaruar të premtën se Shtetet e Bashkuara të Amer-



Albert Rohan ◀

ikës janë të vendosura që Këshilli i Sigurimit, para fundit të verës, të miratojë rezolutën me të cilën Kosova do të fitojë pavarësinë e mbikëqyrur.

(21 prill) “AP”: Rusia e ka këshilluar

Serbinë që ta "okupojë" një pjesë të Kosovës

Londër – Rusia e ka këshilluar Serbinë që të "okupojë" një pjesë të Kosovës me polici dhe ushtri, në rast se njihet pavarësia e Kosovës pa pëlqimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, kanë deklaruar për agjencinë e lajmeve "Associated Press" (AP), zyrtarë të Beogradit, që kanë preferuar të mbeten anonim.

(22 prill) Rehn: BE-ja do ta mbështesë Kosovën në procesin e asocim stabilizimit

Bruksel – Brukseli po planifikon të nisë procedurat ligjore për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian, sapo vendi ta marrë pavarësinë, ka deklaruar komisioneri për zgjerim Olli Rehn.

(23 prill) Di Carlo: SHBA-ja dëshiron ta mbyllë çështjen e Kosovës këtë pranverë Shkup – SHBA-ja dëshiron ta mbyllë çështjen e Kosovës këtë pranverë, sipas planit të Martti Ahtisaarit, ka deklaruar në Shkup, zëvendëssekretarja amerikane e shtetit, Rosemary Di Carlo.

(25 prill) Faktmbledhësit e OKB-së kanë qëndruar në Bruksel

Bruksel – Zyrtarë të NATO-s dhe të BE-së i kanë bërë thirrje OKB-së që ta mbështesë planin e Martti Ahtisaarit për pavarësinë e mbikëqyrtur për Kosovën. Kjo mbështetje për planin e Ahtisaarit është bërë nga kreu i NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer, dhe Komisioneri për Zgjerim i BE-së, Oli Rehn, të cilët janë takuar në Bruksel me misionin faktmbledhës të KS të OKB-së.

(26 prill) Ban Ki Moon: Çështja e Kosovës nuk varet më nga Serbia

Tiranë – Çështja e Kosovës nuk varet më nga Serbia, por ajo është në duart e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ka deklaruar Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki Moon, për një televizion të Tiranës.

(28 prill) DiCarlo: Pavarësia është zgjidhja e vetme e mundshme për Kosovën

Uashington – Zëvendës-ndihmës sekretarja e shtetit për Evropazinë, Rosemary DiCarlo ka deklaruar se plani i Ahtisaarit



Vitaly Churkin

është zgjidhja e vetme e mundshme për Kosovën.

(27 prill) NATO mbështet plotësisht planin e Ahtisaarit

Oslo – Sekretari i përgjithshëm i NATO-s,

Jaap de Hoop Scheffer në ditën e dytë të takimit joformal të Ministrave të Jashtëm të NATO-s në Oslo të Norvegjisë, ka tërhequr vërejtjen kundër shtyrjes së vendimit për statusin e Kosovës dhe fuqishëm e ka mbështetur planin e OKB-së për pavarësi të mbikëqyrtur për Kosovën.

(1 maj) SHBA-ja dhe BE-ja kërkojnë zgjidhje të menjëhershme për Kosovën

Uashington – Në samitin e përbashkët ndërmjet SHBA-së dhe BE-së Uashington, është diskutuar edhe për Kosovën. Në një deklaratë të nënshkruar nga presidenti Bush, kancelarja Merkel dhe kryetari i Komisionit Evropian, Barroso, theksohet se në këtë moment çështja më urgjente që duhet zgjidhur është statusi i Kosovës.

(2 maj) Fried: Rusia nuk do ta përdorë veton

Londër – Ndhmës-sekretari amerikan i Shtetit Daniel Fried, në një intervistë për programin në gjuhën ruse të radios "BBC" ka ritheksuar mbështetjen e SHBA-së për planin e Martti Ahtisaarit dhe ka shfaqur shpresën se Rusia nuk do të vërë veto.

(3 maj) Valotto: Serbia duhet të bindet se Kosova e meriton pavarësinë

Tiranë – Serbia tanimë duhet të bindet dhe të pranojë se Kosova e meriton të jetë një shteti i pavarur, ka deklaruar në një konferencë të organizuar nga Instituti për Studime Ndërkombëtare i Shqipërisë Tiranë, ish-komandanti i KFOR-



Ban Ki Moon

it, Giuseppe Valotto.

(6 maj) Rohan: Ahtisaari nuk ka "Plan B" për Kosovën

Vjenë – "Propozimi i Ahtisaarit paraqet kompromis të cilin e kanë punuar ekspertë të BE-së, Këshillit të Evropës, Bankës Botërore, NATO-s dhe shteteve tjera të interesuara, dhe ai ka mbështetje nga sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-Moon", ka shkruar në një tekst autorial të botuar në gazetën "Der Standard", zëvendësi i Ahtisaarit, Albert Rohan

(7 maj) Solana: Nevojitet rezolutë e re për Kosovën

Bruksel – Shefi i diplomacisë evropiane, Javier Solana dhe Komisioneri për Zgjerim Oli Rehn kanë paraqitur në Këshillin e Jashtëm të Parlamentit Evro-

pian qëndrimet e tyre lidhur me procesin e përcaktimit të statusit të Kosovës. Krye-diplomati evropian ka thënë se nevojitet rezolutë e re për Kosovën.

(8 maj) SHBA-ja dhe BE-ja kanë skicuar rezolutën e re për Kosovën

Nju Jork – Anëtarët e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kanë diskutuar në Nju Jork për draftin e parë të rezolutës për statusin e Kosovës. Një diplomat i OKB-së në Nju Jork, i ka konfirmuar agjencisë së lajmeve "Reuters", se SHBA-ja dhe BE-ja, kanë përpiluar elementet për rezolutën e



Olli Rehn

OKB-së.

(9 maj) Burns: SHBA-ja shpreson se rezoluta e re do të votohet gjatë këtij muaji

Berlin – "Ne mendojmë se është koha që Kosova të bëhet e pavarur, dhe duam ta shtyjmë fuqishëm përpara procesin në javët që vijnë...", ka thënë ndihmës-sekretari amerikan i shtetit Nicholas Burns, para takimit me homologët e tij të grupit G-8 në Berlin.

(10 maj) KS i OKB-së ka debatuar në Nju Jork për Kosovën

Nju Jork – Ambasadori belg në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, Johan Verbeke, ka paraqitur në Nju Jork raportin e misionit faktmbledhës që ka qëndruar në Kosovë dhe Serbi nga fundi i muajit prill. Anëtarët e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kanë ndarë të njëjtin mendim se status quo-ja nuk mund të vazhdojë. Raporti 11 faqesh i hartuar nga 15 ambasadorët e delegacionit të KS, i cili mbështet në planin e Ahtisaarit, është përkrahur fuqishëm nga përfaqësuesit e SHBA-së, Britanisë, Francës, Italisë dhe të Perusë në Këshillin e Sigurimit, ndërsa Rusia dhe Kina janë shprehur për vazhdimin e negociatave. Panamaja ka propozuar vazhdimin e negociatave edhe për 6 muaj.

Fotoreportazhi

Përshkrim që do t'u mbetet në mendje për një kohë të gjatë

ENDE KA HUMANIZËM NË KOSOVË!

Gjatë vizitës sonë që bëmë në regjionin e Opojës, në komunën e Dragashi, në fshatin Kuklibeg, mbetëm pagojë nga pamjet që pamë atje. E vizituam këtë vend për shkak se disa njerëz zemërmirë kanë dhënë një sasi të hollash për t'u ndërtuar shtëpi të reja tri familjeve të këtij fshati, pasi shtëpitë e tyre të vjetra as që i plotësonin kushtet për banim.



Osman D. GASHI

Xhemati i xhamisë së Jeni Mahallës së qytetit të Prizrenit ka mbledhur disa të holla, që mund të quhet një shumë simbolike, pasi aq ka qenë mundësia, për të ndihmuar në nisjen e ndërtimit të tri shtëpive për tri familje që ndodhen në një varfëri të skajshme në fshatin Kuklibeg, në komunën e Dragashit.

Kur e pyetëm hoxhën e kësaj xhamie, i cili ishte nismëtar i këtij aksioni humanitar se: a ka mundësi që me fondet që janë mbledhur deri tani të përfundohet ndërtimi i këtyre tri shtëpive? - ai u përgjigj se jo që nuk ka mundësi të përfundohen, por punimet mund të mbesin përgjysmë, nëse nuk ka njerëz vullnet mirë që të japin edhe më tutje



Shtëpia e Reshat Hajdarit

për këtë shtresë të njerëzve që vërtet kanë nevojë për ndihmën e popullatës, pasi qeveria ka “punë më të


mëdha për të bërë” kështu që ne nuk mund të kërkojmë ndihmë prej tyre pasi duhet t'i lëmë “të qetë”.

Familja e parë e Reshat Hajdarit e cila numëron 6 anëtarë jeton me një shtëpi që ka një dhomë dhe një korridor, për banjë as që flitet, pasi që të gjithë anëtarët e kësaj familje pastrohen në koritë plastike. Siç edhe shihet në fotografi shtëpia jo vetëm që është e vjetër e me qerpic, por përmban edhe lagështi, e cila mund të sjellë sëmundje madje edhe vdekjeprurëse. Kushtet ekonomike i kanë të vështira. Reshati ndonjëherë kur gjen ndonjë punë punon sa për t'i siguruar kafshatën e gojës familjes së tij 6 anëtarësh.

Familja e dytë, ajo e Idriz Hashimit, është në kushte edhe më të vështira se familja e parë. Ajo numëron 4 anëtarë, por më e keqja është se Idrizi nuk punon askund. Ai shumë herë është orvatur të gjeje punë por më kot. Jeton vetëm me shpresën se do të vijë ditë më të mira për të dhe familjen e tij. Ai jeton në shtëpinë e tij me tre vëllezër të tjerë. Djali i Idrizit, Samiri



Shtëpia e Idriz Hashimit



Shtëpia e Mesut Gafurrit ◀

së tij.
Këto janë tri përshkrime shumë të shkurtra për këto tri familje që ishin në këtë fshat. E këso raste në Kosovë ka sa të duash.

Pyetëm disa banorë të këtij fshati se a e ka ndihmuar komuna e Dragashit këtë fshat vitet e pasluftës? E përgjigjja si në shumicën e rasteve ishte negative. U kishte premtuar që do t'u asfaltonte rrugën, por punimet as që kanë filluar. Kjo të lë të kuptosh se kur të vijë koha e zgjedhjeve, asfaltimi i rrugës mund të shfrytëzohet përsëri për fushatë elektorale e në këtë mënyrë të merren votat e popullit.

Ata, që prej vullnetit të mirë shprehin dëshirën për t'iu ndihmuar këtyre familje, mund të lajmërohen te nismëtari i këtij aksioni, hoxha i xhamisë së Jeni Mahallës në Prizren, Mazllam Mazllami ose ta thërresin në numrin e telefonit 044/217-747

i cili është 14 vjeçar dhe është në klasë të shtatë, nuk ka libra e fletore të mjaftueshme për të vijuar rregullisht shkollën si shokët dhe shoqet e tij. Atij i kishte falur nja dy a tri libra një shok i një fshati tjetër fqinj, që t'ia plotësonte sado pak mungesën e librave.

Familja e tretë, ajo e Mesut Gafurrit, e cila numëron 5 anëtarë gjithashtu jeton në kushte të mjerueshme, në një shtëpi që të bën të habitesh se si i ka rezistuar dy a tre dimrave të fundit, e nuk është rrëzuar nga bora e madhe që bie në regjionin e Opojës, pasi është në një lartësi të madhe bregdetare. Mesuti kur gjen punë, punon dhe i siguron ushqim dhe veshje familjes



Shtëpia e cila sa ka filluar së ndërtuari ◀



Fillimi i ndërtimit të njëres prej këtyre shtëpive



Pamje e toaletit! ◀

Mediat dhe qeverisja

MEDIAT E KONTROLLOJNË POLITIKËN APO POLITIKA MEDIAT?

Është krijuar një përmbajtje në media, e cila po iu shërben interesave të kapitalizmit botëror, ku mjetet e informimit çdo herë e më tepër janë duke pasuar politikën e jashtme të vendeve të tyre, të cilat janë në shërbim të interesave të korporatave trans-nacionale, të cilat kontrollojnë mediat. Si rezultat i kësaj në treg kanë mbetur vetëm mediat që mbështeten nga këto biznese.

Mehmet KALISI

Edhe në sistemet demokratike hiç më pak sesa në ato autoritare, synim i politikës dhe i politikëve është të kontrollojnë mediat dhe ato të jenë në shërbim të synimeve dhe interesave të tyre. Një qëndrim apo botëkuptim i tillë buron dhe postulon nga teoricienë mjaft eminentë, ndër ta edhe teoricienia amerikane, Doris Graber, e cila në lidhje me këtë problematikë thotë: “Një ndër problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet njerëzimi në këtë kohë është se mjetet e informimit pasojnë agjendën të cilën e vendosin politikanët e politikës së jashtme. Janë ata të cilët përcaktojnë rëndësinë e ngjarjeve apo vendeve në botë, sipas prioriteteve të politikës dhe elitës politike amerikane”. Dhe nëse ndalemi pak në ngjarjet e fundit në skenën botërore dhe i shikojmë nga këndi i një observatori të thjeshtë dhe e shikojmë pak më thellë gjendjen aktuale të lidhjeve ndërmjet politikës dhe mediave, e kam fjalën këtu për top mediat botërore, do të vërejmë se ato janë “marrëdhënie gati incestuale”. Ndërsa Walter Lippman, që konsiderohet epror i gazetarisë amerikane dhe njëri ndër teoricienët më të njohur të demokracisë liberale konstaton se: “revolucionin në artin e demokracisë” mund të shërbejë për “fabrikimin e pëlqimit” (manufacturing consent), me fjalë të tjera, mund të shërbejë për arritjen e pëlqimit nëpërmjet teknikave moderne të propagandës tek një pjesë e opinionit, e cila nuk është pajtuar me ide te caktuara. Ndërsa Noam Chomsky vë në dukje vazhdimisht një ide të tijën shumë të thjeshtë kur thotë se “nuk ka nevojë për të ditur shumë që të analizosh devijimet e medias në vendet perëndimore. Një numër mjaft

i vogël njerëzish dhe korporatash që sot kanë në pronësi pjesën dërmuese të mediave, arritën deri te ato duke mbështetur hapur elitat politike në vendet ku vepronë mediat e tyre”. Disa vite më parë, kur Chomsky u pyet se si i kontrollojnë mediat elitat e korporatave, ai u përgjigj: “Kjo është njësoj si të pyesësh se si elitat e korporatave kontrollojnë General Motors. Ata nuk kanë nevojë ta kontrollojnë atë. Ajo është pronë e tyre”. Dhe në asnjë moment politikanët nuk hezitojnë që në mënyrat më perverse të keqpërdorin median, por në anën tjetër edhe do të ishte e pamundur të rrije në pushtet. Një analizë tejet interesante për rolin dhe funksionet e mediave në demokracinë liberale, e japin dy mendimtarët ndër më të njohurit në mesin e elitës intelektuale dhe akademike në SHBA, njëri ndër ta është, Naom Chomsky dhe kolegu i tij Edward Herman, të cilët në studimin e tyre për “Modelin e Propagandës” potencojnë

se: mediat amerikane janë shndërruar në mjete të propagandës së elitës politike. Analiza e tyre më lart, mohon thënie tashmë të njohur se, propaganda nuk ka vend në demokracinë liberale. Modeli i tyre bazohet në faktin se procesi i kontrollit të lajmeve, mendimeve, ideve dhe informatave është shndërruar në një proces ku nëpërmjet tij bëhet klasifikimi i lajmeve nga pesë filtra, para arritjes së tyre tek audienca (lexuesi). Këta filtra siç i quajnë ata, sigurojnë kalimin vetëm të atyre informatave të pasqyrojnë pikëpamjet dhe interesat e elitës politike. Sipas Chomsky-t dhe Herman-it këta pesë filtra janë:

1. Monopoli i mediave nga ata që posedojnë pasurinë dhe pushtetin; ky pohim i tyre bëhet edhe më i fuqishëm kur marrim parasysh faktin se dominimi i korporatave trans-nacionale mbi mediat ka çuar deri te një afrim ideologjik ndërmjet mediave dhe gazetarëve në njërin anë, dhe ndërmjet korporatave kapitaliste dhe qeverive perëndimore në anën tjetër. Si rezultat i këtij afrimi ideologjik është krijuar një përmbajtje në media, e cila po iu shërben interesave të kapitalizmit botëror, ku mjetet e informimit çdo herë e më tepër janë duke pasuar politikën e jashtme të vendeve të tyre, të cilat janë në shërbim të interesave të korporatave trans-nacionale, të cilat kontrollojnë mediat. Si rezultat i kësaj në treg kanë mbetur vetëm mediat që mbështeten nga këto biznese.

2. Reklama; përbën një element mjaft të rëndësishëm në modelin e tyre të propagandës dhe konsiderohet si burim kryesor i mediave, ndërsa Chomsky dhe Herman konstatojnë se kjo ka shkaktuar një kontroll apo lidhje të tepruar me korporatat kapitaliste.

Është e vërtetë se reklamat luajnë një rol



tejet të madh në formimin e përmbajtjes së prezantuar nga mjetet e informimit. Korporatat shpesh dinë të bojkotojnë media të caktuara, nëse ato tentojnë për ndonjë ndryshim të gjendjes aktuale, në anën tjetër ndihmojnë media të cilat silen në orbitën e konformizmit mediatic. Mediat që nuk arrijnë të sigurojnë sponsor zhduken nga tregu mediatic. Mediat nganjëherë quhen edhe si “miq të korporatave” në situatat kur bashkëpunojnë me to duke mbrojtur interesat e tyre në mënyrë transparente, apo më pak transparente.

3. Vartësia e mediave nga informatat që vijnë nga qeveritë, korporatat dhe ekspertët, apo siç quhen burime të “fuqishme të informatave”, vërejmë se gjithnjë e më tepër sa vjen e shtohet, gjë që ka rezultuar në një kontroll të qeverisë mbi informatat.

Kjo mbështetje e mediave në burime qeveritare ka ndikuar dukshëm në mungesën e pluralizmit dhe mozaikut ideor për shumë çështje të rëndësishme publike, duke i pamundësuar publikut të marrë më shumë informata, se informatat që transmetohen nga resorët e administratës qeveritare. Andaj mund të themi se mediat janë duke u shndërruar në një hapësirë sociale, në të cilën kanë mundësi manovrimi informativ vetëm përfaqësuesit e zgjedhur të atyre që kanë fuqinë,

si dhe të atyre të cilëve iu lejohej qasja nga po këta të fuqishëm.

4. Mbrojtja e interesave nacionale ose disiplinimi i mediave; shumë studiues të tjerë e përkrahin këtë pohim dhe vërtetojnë se mediat mbrojnë qeverinë dhe interesat nacionale dhe e shohin se një ndër funksionet kryesore që janë duke kryer mediat është pajtimi dhe uniteti kombëtar. Kjo nuk do të ishte ndonjë problem, por ata e bëjnë këtë nëpërmjet falsifikimit dhe shtrembërimit të informatave me qëllim të arsytimit të politikës zyrtare. Format e presionit që ju bëhen mediave janë shumë të njohura edhe tek ne, thirrjet telefonike të drejtpërdrejta, denoncimet, peticionet, protestat, telegramet, presionet nga funksionarë të ndryshëm e kështu me radhë.

5. Armiqësia ndaj komunizmit (pas rënies së komunizmit ai zëvendësohet me islamit dhe muslimanët) si fe kombëtare dhe mekanizëm dominimi; mediat lejojnë qarkullimin e informatave që shtrembërojnë imazhin e armikut. Si rezultat kryesor i kësaj politike mediatike është bërë ndarja e botes në “miq” dhe “armi”. Edhe pas rënies së Bashkimit Sovjetik mediat vazhdojnë të praktikojnë të njëjtën politikë, me shtete dhe personalitete të tjera që nuk pajtohen me politikën e jashtme të vendeve perëndimore. Modeli propagandistik i këtyre dy studi-

uesve amerikanë është bërë duke u bazuar në analizën e tregut të lirë. Megjithatë, për të gjitha përfundimet e tyre në lidhje me këtë problematikë, është debatuar mjaft në SHBA por edhe më gjerë, por ka hapësirë të diskutohet edhe më shumë. Në shikim të parë modeli i tyre do të dukej si një qasje mjaft deterministe, por ata vetëm e analizojnë dhe e përshkruajnë logjikën e funksionimit të mediave në shoqëritë e tregut të lirë. Por sido që të jetë, nga kjo që thashë më lart, unë mund të konstatoj se mediat, në esencë, kanë si funksion kryesor rolin e mediatorit ndërmjet politikës dhe publikut, e assesi rolin e pushtetit të katërt siç kanë qejf ta quajnë disa. Rrjedhimisht, mediat moderne, si organizma kolektive, të njohura në opinion si bashkësi konceptimesh dhe idesh, për të ndjekur lajmin e vërtetë dhe njëkohësisht për ta kumtuar atë përmes mekanizmave të shkruar dhe elektronikë, nëse shihet ana tjetër e medaljes, ato janë thjesht instrumentalizime të koniukturave politike, qofshin të improvizuara madje, duke na dhënë një tablo irrituese dhe të margjinalizuar nga mediokriteti, për pashmangshmërinë e evitimit të profanizimit, diletantizmit dhe unilateralizmave të politikomanive globale apo lokale.

(Autori është në përfundim të studimeve pasuniversitare në universitetin e Shkupit, Dega e Komunikimit.)



Kapitalizmi është një skemë piramidale.

Toleranca ndër fetare në Kosovë

**EDHE PAS SHTIMIT TË KONFESIONEVE FETARE,
TOLERANCA NDËR FETARE NUK ËSHTË PRISHUR**

Toleranca ndër fetare në Kosovë ka qenë dhe vazhdon të jetë prezent tek shqiptarët, ndërsa faktorët kryesorë që kanë ndikuar në prezencën e tolerancës fetare, sipas predikuesve të dy besimeve fetare, janë librat e shenjtë fetarë të cilët thërrasin në tolerancë.

Shpend FAZLIU

Predikuesit e besimit islam, por edhe ata të krishterë, thonë se fetë të cilave ata u përkasin, përkatësisht librat fetarë të tyre, ofrojnë argumente të qarta që thërrasin për tolerancë dhe që e mbështesin atë. Dy besimet në fjalë sipas tyre janë të hapur edhe në martesë të përziera ndërmjet besimeve, por për dallim nga Krishterizmi i cili është i hapur ndaj të gjitha martesave, Islami, martesën e vajzave që i përkasin këtij besimi e ndalon me besimet e tjera.

Toleranca ndër fetare në Kosovë ka qenë dhe vazhdon të jetë prezent tek shqiptarët, ndërsa faktorët kryesorë që kanë ndikuar në prezencën e tolerancës fetare, sipas predikuesve të dy besimeve fetare, janë librat e shenjtë fetarë të cilët thërrasin në tolerancë. Predikuesit fetarë të feve të ndryshme thonë se kanë takime ndërmjet vete dhe se diskutojnë së bashku, pasi që të dy besimet fetare kanë një bazë. Osman Abazi, imam në Xhaminë Sudi Efendi, në Prishtinë, shpreh se toleranca fetare në Kosovë, por edhe ndër shqiptarët në përgjithësi, historikisht ka qenë e shprehur. Kjo sipas tij ka ndodhur pasi që në Kosovë ka pasur tre konfesionë, muslimanët si shumicë, dhe të krishterët katolikë, përkatësisht ortodoksë. "Toleranca islame vërtetohet me ajete kur'anore, sepse All-llahu nuk e ka lejuar dhunën. Po përmendi ajetin 256 të Kuranit, në Suren El-Bekare, ku thuhet se "në fe nuk ka dhunë", nënvizon Abazi. Ai theksoi se gjatë historisë muslimanët nuk ia kanë imponuar askujt fenë, duke shtuar se po të ndodhte kjo populli serb nuk do të ekzistonte, pasi që Turqia ka sunduar mbi 500 vite në Ballkan. Abazi, potencon se edhe pas shtimit të konfesionëve fetare, përkatësisht me shfaqjen e Budizmit dhe Evangjelizmit, toleranca ndër fetare nuk është prishur. Si faktorë të rëndësishëm që kanë ndikuar në rritjen e tolerancës fetare ai përmend përthimin e shumë librave fetarë, në mesin e tyre edhe të Kur'anit, në të cilin thuhet se të tjerët duhen respektuar, pa marrë parasysh se cili besim i takojnë, sepse imponimi në fe nuk lejohet. Për Abazin, Kosova është ndër vendet e rralla në botë ku toleranca ndër fetare ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë e pranishme. Ai duke shpjeguar anën fetare të tolerancës, thotë se All-llahu e ka lënë të lirë të udhëzohet në rrugë të drejtë secilin njeri, duke mos ia imponuar fenë. Po përmend një ajet kur'anor që thotë: "All-llahu nuk u ndalon të jeni bamirës ndaj atyre që nuk ju luftojnë dhe nuk ju largojnë nga shtëpitë e tyre, por ju ndalon t'i merrni për miq ata që luftojnë kundër jush" – sqaron Abazi. Ndërkohë Don Lush Gjergji, nga Ipeshkvia e Kosovës, pohoi se toleranca fetare duhet

të jetë shembull si paradigëm krishteromuslimane apo e kundërta. Sipas tij mbi të gjitha duhet të jetë vëllazëria e përbashkët gjithë shqiptarë, sepse populli i takon një kulture, një historie dhe një traditë me shekuj, dhe se dikur të gjithë kanë pasur një besim, mirëpo rrethanat kanë diktuar që pjesa më e madhe t'i takojë besimit islam, përderisa të tjerët Krishterizmit. "Jo vetëm që jemi tolerantë, por jemi vëllazër dhe si të tillë bashkëpunojmë dhe bashkëjetojmë për shumë çështje të përbashkëta që kanë karakter njerëzor, kombëtar dhe fetar", shpjegon Gjergji. Ai duke folur për Shkrimin e shenjtë para Krishtit, që njihet si Besëlidhja e re, deklaroi se ajo si bazë të saj ka pasur dashurinë, sepse Zoti është i dashur dhe i fton njerëzit për dashuri, e cila shprehet duke i përkrahur të tjerët. Sociologja Edona Dula është e mendimit se toleranca fetare dhe diskursi mbi këtë fenomen në shoqërinë kosovare është pak a shumë i njohur si diskurs tradicional, në kuptimin që shpjegimet mbi këtë problematikë më shumë i adresohen shpjegimit detyruar. Për mendimin e saj toleranca fetare tek shqiptarët më tepër është pasojë e një "marëveshjeje", që nuk është thënë ndonjëherë, e që ka bërë që komunitete e ndryshme fetare të jetojnë së bashku. Dula nënvizoi se është e vështirë t'u adresohet faktorëve që e ushqyen këtë tip, apo këtë model të "tolerancës" ndër ne, sepse nevojitet një analizë më e gjerë sociologjike, e që deri më tani ka munguar. Për ta argumentuar edhe më tolerancën fetare, predikuesit e Islamit, por edhe ata të Krishterizmit, japin shembuj përkatësisht nga jeta e Pejgamberit Muhammed dhe nga jeta e Jezu Krishtit. Don Gjergji, e ilustron këtë me shembullin kur Jezusi ishte lutur duke iu drejtuar Zotit: "O Zot fali, se nuk kanë dinë se çfarë bëjnë". Ai po ashtu citon fjalët e Krishtit, që kishte thënë se "Çka do që i keni bërë njerit prej më të vegjëlve, ma keni bërë mua". Si simbol të tolerancës ndër fetare tek shqiptarët ai e vlerëson edhe Gonxhe Bojaxhiun, apo që njihet ndryshe si Nëna Tereza, e cila sipas tij, donte t'i shërbente Zotit dhe shprehu dashuri ndaj njerëzve, pa marrë parasysh dallimet fetare, kombëtare, apo racore. "Çdo lloj paragjykimi apo refuzimi ndaj tjetrit është mbyllje ndaj tjetrit dhe është një tundim që duhet larguar. Me etiketime, me sulme, me njollasje, apo mbyllje, nuk arrihet asgjë" – ka vlerësuar Gjergji. Ndërkohë imam Abazi, vë në pah se jeta e Pejgamberit Muhammed, ka qenë shembull për tolerancë. Ai citon një transmetim nga jeta e Pejgamberit në të cilën thuhet se njerëzit janë të barabartë. "Nuk është më e madhe vlera e arabit ndaj jo arabit, as e të bardhit ndaj të ziut, dhe as e të verdhit ndaj të kuqit". Sipas tij Pejgamberi Muhammed, asnjëherë nuk i ka sulmuar të tjerët, por është sulmuar nga të tjerët, sepse Islami e ndalon vrasjen e njerëzve. Si Abazi, ashtu edhe Gjergji, thanë se takimet me besimeve

fetare ekzistojnë dhe se në to diskutohet së bashku pasi fetë kanë një bazë: besimin, dhe se e ndalojnë krimin, dhunën, padrejtësinë. Përderisa edhe sociologja Dula, mendon se drejtuesit e bashkësive fetare mund të bëjnë shumë në ri mobilizimin e një qasje të re për tolerancën ndër fetare në Kosovë. Ajo vlerëson se kjo nuk duhet bëhet në mënyrën se si e kanë bërë gjerë tani, duke u mbështetur në faktorët e jashtëm kërcënues që vinin nga push-teti serb, por në ofertën e cilësisë për jetën, raportet ndërmjet njerëzve dhe shoqërinë në tërësi. "Mendimi im është se mënyra se si e thonë ata këtë lloj tolerancë nuk është në përputhje me kohën dhe vendin në të cilën gjendemi", ka sqaruar ajo. Sipas saj, prijësit fetarë në Kosovë, tani pas gjitha ndryshimeve të ndodhura në mentalitetin kosovar, do të duhej ta shtonin promovimin e tolerancës së mirëkuptimit dhe të ndërtimit të një shoqërie demokratike, ku individit mund ta identifikojë vetë veten edhe me premisa fetare, përveç atyre qytetare. Ndërkohë toleranca fetare në martesat e përziera ndërmjet besimeve ndryshon. Krishterizmi i lejon martesat ndërmjet besimeve të ndryshme fetare tek të dy gjinitë, ndërsa Islami lejon që meshkujt të marrin një femër të besimit tjetër, ndërsa femrave kjo u ndalohej. Abazi, shpjegon se në ajete e Kur'anit, All-llahu ka lejuar që muslimani të martohet me jomuslimanen, por ajo duhet të jetë prej idhtareve të librit. Sipas tij, është e ndaluar rreptësisht që muslimania të martohet përveçse me muslimanin. "Nëse një muslimane martohet me një jomusliman ajo do të jetë e detyruar ta ndërrojë besimin fetar (sepse jomuslimanët nuk e pranojnë pejgamberin e Muhammedit a.s.) dhe fëmija e saj do të ndjekë fenë e të atit, ndërsa nëse muslimani martohet me një besimtare të feve të tjera, ai është i obliguar t'i pranojë të drejtat e saj dhe ai nuk ka të drejtë t'ia imponojë apo t'ia ndërrojë fenë asaj. Nuk mund të besohet se nëse një muslimane martohet me një jomusliman, asaj nuk do t'i imponohet ndërrimi i fesë së saj" – ka sqaruar ai. Ndërkohë Don Lush Gjergji, duke e shprehur qëndrimin e Krishterizmit, pohon se në Krishterizëm i lejohej secilit që të martohet me pjesëtarë të besimeve të tjera në të dyja gjinitë, me kusht që çifti që martohet të jetë dakord. Ndërkohë për sociologun Dula, çështja e martesave ndërmjet komuniteteve fetare, në kohën në të cilën po jetojmë, e edhe në të kaluarën, nuk ka qenë ndonjë problematikë që ka zgjuar kureshtje shkencore. "Institucion i shenjtë ka qenë i ngritur mbi do vlera të pakontestueshme. Asnjëherë nuk ka arritur të paragjykohej në kuptimin e ndonjë jo gatishmërie për t'u lidhur dhe afruar ndërmjet vete këto dy komunitete" – sqaron ajo. Ndërkohë ajo që mund të rezikojë tolerancën fetare, sipas predikuesve të fesë, është ekstremizmi fetar nga i cili duhet të ruhen besimtarët, në mënyrë që të ruhen të mirat e kësaj bote.

Histori Islame

Hixhre-ti

Fjala 'hixhre' rrjedh prej fjalës rrënjore HXHR, hexhre – jehxhuru, që përkthehet: ka ndërprerë me të (çdo marrëdhënie, çdo lidhje të ngushtë ekonomike, shoqërore ose dashurie); ai ndërpreu përfundimisht shoqërimin me ta, ai u shkëput.



Muhamed Jusufi
- KAJOLLI

“Muhammedi u largua nga Mekka dhe kaloi në Medinë më 16 qershor të vitit 622 të e.s., përkatësisht në ditën e parë të muajit të parë të vitit lunar, të quajtur Muharrem. Në vitin 638 halifi i dytë Umeri (634-644) vendosi që viti i kalimit të Muhammedit nga Mekka në Medinë, pra viti 622, të konsiderohet si viti i parë i kalendarit të ri islam”. Ndërsa disa historianë të tjerë mendojnë se dita e parë e hixhre-s ishte 12 shtatori.

Pas ngjarjes së madhe – udhëtimit të tij në Kuds dhe në Miraxh, Muhammedi s.a.v.s. u qetësua plotësisht. Ai, që atëherë e tutje nuk do të vuante për vdekjen e axhës dhe të shoqes së tij si më parë. Ai e pati shumë të qartë se mundësitë e All-llahut janë absolute dhe se po të shprehte Ai vullnetin e Tij për ta ndryshuar njerëzimin, do ta bënte këtë sa hap e mbyll sytë. Ai, gjithashtu, pas kësaj ngjarje e kuptoi rolin e tij. Atij i duhej që me qetësi dhe me përkushtim të plotë ta implementonte programin e All-llahut xh.sh. Ai e pati të qartë se nuk ishte as sunduesi e as mbikëqyrësi i mekasve dhe i askujt tjetër prej qenieve njerëzore, dhe se mbi supet e tij nuk rëndonin barrët e të tjerëve. Para se të hyjmë në shkaqet e detyrimit për emigrim, do të mundohemi të sjellim një pasqyrë të shkurtër të Jethrib-it të asaj kohe.

Jethrib-i

Jethrib-i ishte një qytet i ri, i krijuar disa vite para lindjes së Muhammedit s.a.v.s. Më herët në këtë vend-oazë, me një diametër të vogël prej disa kilometra katrorë, jetonin dy fise (Evs dhe Hazrexh), që ishin vendosur aty nga vendet jugore të Gadishullit Arabik. Kjo oazë filloi ta marrë pamjen e një qyteti vetëm atëherë kur në të filluan të vendoseshin në masë të madhe disa prej

fiseve çifute, gjegjësisht fisi Beni Kurejdha, Beni Nadir dhe fisi Kajnuka. Dikush thotë se çifutët e ndjekur nga romakët, ishin vendosur në këtë vend pas rebelimit të tyre në vitin 135 e.s. Kjo nuk është e dokumentuar. Si duket këta janë shpërngulur vonë në këtë vend të thellë shkretinor, dhe sigurisht që kanë pasur arsytet e tyre. Në kushtet normale askush nuk do të vendosej në këtë vend. Natyrisht që secili do të habitej për shpërnguljen e tyre pa ndonjë shkak të fuqishëm. Ne, dhe askush tjetër, nuk do ta kishim mësuar të vërtetën e shpërnguljeve të tyre, sikur ata vetë të mos na e tregonin atë. Këta të shpërngulur ishin në pritje të dërguarit të fundit nga qielli. Ata ishin paralajmëruar nga pejgamberët e tyre të më hershëm, se All-llahu do të dërgojë një pejgamber në këtë oazë. Mësojmë se në këtë vend kishin migruar familjet e devotshme të çifutëve, që i ishin përkushtuar vetëm Krijuesit të botëve. Ata duke u bazuar në praktikën e mëhershme të të zgjedhurve të All-llahut nga radhët e çifutëve, ishin të sigurt që edhe pejgamberi i fundit i tyre do të ishte nga radhët e këtij populli.

Pejgamberët e mëhershëm çifutë jo vetëm që ua kishin përshkruar vendin, por ata madje e dinin edhe emrin e tij. Ata nuk e dinin se si quhej ai vend, por të bazuar në përshkrimet që posedonin, në pamjen natyrore të atij vendi dhe përafërsisht në

regjionin e caktuar, ata u vendosën në vendin të cilin e quajtën Jethrib. Si duket emri Jethrib është fjalë arameike që do të thotë qytet. Me shpërnguljen e Muhammedit s.a.v.s., ky vend u emërua gjithashtu qytet, por në gjuhën arabe (Medinetu el Munewwere – Qyteti i ndritur).

Jethribi, pra, banohej nga dy fise arabe që ishin në konflikt të vazhdueshëm dhe nga një komunitet i madh çifut që kishte ardhur nga veriu i Gadishullit, dhe ishte jo arab. Që të tre subjektet jetonin në ankth. Konflikti i arabëve shpeshherë zgjerohej dhe pasojat i vuanin të tre këto subjekte. Ky ankth dhe konflikt ishte i papërmirësueshëm. Ia vlen të përmendim edhe një element shumë interesant që është regjistruar nga historianët e vjetër. Çifutët sa herë që kishin nevojë të mbroheshin, i kërcënonin fiset arabe duke ju kujtuar atyre se së shpejti do të paraqitej pejgamberi i tyre, që do t'i shkatërronte ata, ashtu siç kishte ndodhur me zhdukjen e fiseve arabe si: Ad-i dhe Irem-i.

Si duket çifutëve iu është ngulitur në mendje se janë populli i zgjedhur i All-llahut dhe se All-llahu do t'i shpëtojë ata në momentet e duhura, ashtu si i shpëtoi nga Egjipti me anë të Musait a.s.

Përderisa në këtë qytet jetonin çifutët, nuk mund të merret me mend se evsasit dhe hazrexhasit të mos kishin pasur njohuri



Medina e ndritur

mbi ekzistimin e një Zoti – nuk dyshohet se ata dinin, ose të paktën kishin dëgjuar, për besimin monoteist. Ka pasur mundësi që ato dy fise të mos i ishin bindur besimit monoteist për shkaqe të ndryshme ose nacionale, por kjo njohuri do t'u shërbente këtyre dy fiseve në kohën kur ata do të takoheshin për herë të parë me Muhammedin s.a.v.s. në Mekë.

Shkaqet e shpërnguljes

Nuk ka dyshim se shkaqet e shpërnguljes fillimisht i dedikohen keq-prijtjes të popullit mekkas – farefisit të tij. Ata asnjëherë nuk u pajtuan me ftesat e Muhammedit s.a.v.s. dhe për arsye tash më të theksuara, edhe jeta e Muhammedit s.a.v.s. u vu në rrezik. Pas vdekjes së axhës dhe gruas së tij, dëgjoheshin pëshpëritje se si ta përmbyllnin këtë kapitull 'të hidhur' me këtë njeri. Me rrezikimin e drejtpërdrejtë të Muhammedit s.a.v.s rrezikoheshin edhe më shumë ithtarët e tij, prandaj ata filluan të mendojnë seriozisht për një shpërngulje kolektive. Po ku?

Po afrohej haxhi i vitit të njëmbëdhjetë të pejgamberisë së tij. Në Mekë nga shumë jethribas erdhën edhe disa të rinj, më saktë gjashtë prej tyre. Tani mësojmë se këta të rinj i përkisnin fisit të Hazrexh-it. Në takimin e parë me të Dërguarin e All-lahut, ata u mahnitën kur dëgjuan citate të Kur'anit. Atyre nuk ua vrau veshin thënia 'La ilahe il-lallah'. Ata besuan menjëherë për vërtetësinë e citateve. Për dallim nga arabët e tjerë, këta besuan si duket për shkak se kishin njohuri për ekzistimin një Zoti të vetëm. Mbase ka ndikuar edhe fakti se kërkesa vinte prej një njeriu që ishte i llojit të tyre, duke mos dashur të japë ngjyrimet nacionale. Ose kanë vërejtur se vetëm ky (s.a.v.s.) do të ishte personi që do t'i afronte fiset dhe komunitetet e tjera në Jethrib. Sido që të jetë, nga analiza e gjatë që bënë këta të rinj menjëherë pasi u largua prej tyre i dërguari All-lahut s.a.v.s, kuptojmë se ata kanë qenë largpamës. Këta sigurisht kanë menduar se ai (s.a.v.s.) do t'u shërbente për të ndaluar luftën civile, së cilës nuk i shihej fundi. Këtë vizion të tyre na e argumenton deklarimi i tyre kur ata gjatë momentit të pranimit të Islamit i thanë pejgamberit: "Ne i kemi lënë njerëzit tanë, sepse asnjë fis nuk është i përçarë nga urrejtja dhe mëria si ata. Ndoshta Zoti do t'i bashkojë ata nëpërmjet jush. Kështu le të shkojmë dhe t'i ftojme ata në këtë fe tuajën; dhe në qoftë se Zoti i bashkon rreth saj, nuk do të ketë njeri më të fuqishëm se ju". Pasi u kthyen në Jethrib ata informuan banorët e vendit. Flitet se të gjithë jethribasit mësuan për Islam in e tyre dhe për pejgamberinë e Muhammedit s.a.v.s..

Takimi i parë në Akabe

Vitin tjetër, në kohën e haxhit, në vitin e dymbëdhjetë të predikimit të tij, sërish u nisën nga Jethribi këta gjashtë persona, dhe me vete kishin marrë edhe gjashtë shokë të tjerë dhe një femër, pra gjithsej trembëdhjetë. Kësaj radhë në mesin e tyre kishte

edhe nga fisi Evs. Këta do të takoheshin sërish me Muhammedin s.a.v.s. në Akabe, një përrua në Mine, tashmë i njohur për secilin haxhi. "Kujton Ibadete ibn el Samit: isha njëra prej atyre që iu betuam Muhammedit s.a.v.s. se nuk do të adhuronim hyjni tjetër përveç All-lahut, nuk do të vidhnim, nuk do të merreshim me prostitucion, nuk do t'i mbysnim fëmijët tanë, nuk do të shpifnim intriga që shkaktonin përçarje midis nesh, dhe nuk do ta pengonim të mirën."

Meqenëse ata ishin shumë të përpiktë dhe të sigurt në betimin e tyre, Muhammedi s.a.v.s. i dha atij grupi një mësuës nga Mekka që do t'ua mësonte atyre Islam in, si dhe do të konsiderohej përfaqësues i tij. E ky ishte Mus'ab ibn Umejr-i. Në gjuhën tonë të tanishme, ndryshe, ky i deleguar ka luajtur rolin e ambasadorit dhe mund të thuhet se është ambasadori i parë në Islam. Të shpërngulurit e tjerë të mëhershëm nuk mund të quhen ambasadorë, sepse ata kishin migruar me dëshirën e tyre dhe nuk ishin të deleguar ose të përfaqësuar nga Muhammedi s.a.v.s. Ky njeri edhe pse ishte i ri, tregoi një pjekuri të pashembullt, gjë që e dëshmon biografia e tij e ndritur për rezultate e arritura në Jethrib.

Takimi i dytë në Akabe

Një vit më pas, pra në haxhin e vitit të trembëdhjetë të pejgamberisë së tij, si edhe në vitet tjera nga Jethribi ishin nisur shumë hanxhinj, por prej tyre shtatëdhjetë e tre ishin besimtarë të rinj që kishin përqaftuar fenë islame. Ky grup i vogël këtë vit kishte qëllim që t'i ofronte Muhammedit s.a.v.s. që të shpërngulej përfundimisht në Jethrib. Takimi i dytë, edhe këtë vit, u bë në po të njëjtin vend që quhej Akabe. Takimi u mbajt në mbrëmje, pasi ishte errësuar mirë. Për dallim nga takimi i vitit të kaluar, në këtë takim ishte prezent edhe Abasi, xhaxhai i pejgamberit s.a.v.s., i cili akoma nuk kishte kaluar në Islam. Me të filluar mbledhja, i pari foli Abasi i cili ju tha: "O ju hazrexhas, ju e dini se Muhammedi është i yni, është i mbrojtur prej popullit tonë. Me autoritetin që ka ky njeri gëzon mbrojtje në qytetin tonë. Ky po shpreh dëshirë dhe po anon nga ju që t'ju shoqërojë, e ju nëse e shihni se pajtoheni me të dhe jeni në gjendje ta mbroini kundër atyre që nuk e përkrahin në vendin tuaj, atëherë barra bie mbi ju po e pranuat. Por nëse vërtet i jeni dorëzuar këtij dhe nuk e tradhtoni, që tani ju them, ftojuni".

Kryesuesi i delegacionit të jethribasve tha: Të dëgjuam me vëmendje o Abas, na fol ti o i Dërguari All-lahut. Ndërsa Muhammedi s.a.v.s. citoi disa ajete nga Kur'an Kerim, pastaj tha: Kërkoj betimin tuaj se do të më mbroini ashtu siç i mbroini gratë dhe fëmijët tuaj. Pasi ata e siguruan për këtë, ata kërkuan prej të Dërguarit të All-lahut që edhe ai të mos i braktiste në kohën kur do të përmirësohej gjendja.

Historianët na sjellin detaje të hollësishme rreth kësaj marrëveshje. "Pasi përfunduan të gjitha paragrafët, i Dërguari i All-lahut kërkoi që garantues të këtij betimi të ishin dymbëdhjetë persona që do të ishin zgjedhur prej tyre. Nëntë të zgjedhurit ishin nga fisi Hazrexh, ndërsa tre të tjerët nga fisi Evs. Të gjithë, një nga një ia shtrinë dorën dhe

betoheshin për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre, dhe njëkohësisht e pranonin Muhammedin si liderin dhe pejgamberin e tyre. Por për një kohë relativisht të shkurtër, në rrethana të panjohura ky takim nuk mbeti sekret. Besimtarët muslimanë, besojnë në thënien e Muhammedit s.a.v.s., se ky informacion kishte dalë nga shejtani mallkuar, e jo nga dikush tjetër që ishte prezent në atë takim. Sido që të ketë ndodhur, kurejshitet e dinin fare mirë se çdo të thoshte kjo marrëveshje. Ata menjëherë morën hapat e parë për t'u siguruar rreth vërtetësisë dhe seriozitetit të kësaj marrëveshje. Pasi ata u siguruan se marrëveshja ishte e vërtetë, ata shkuan dhe u takuan me prijësin e jethribasve, Abdullah ibn Selulin, i cili nuk ishte musliman. Ai i siguroi ata se nuk kishte kurrfarë informacioni për këtë takim. Mekkasit e morën takimin si një takim të rëndomtë e pa nivel, por ata prapë se prapë, pas haxhit e ndërmoren me shumë seriozitet çështjen e Muhammedit s.a.v.s..

Përgatitja për shpërngulje

Ndërkohë që Muhammedi iu thoshte shokëve të tij të shpërnguleshin në Jethrib, mekkasit vështronin me vëmendje çdo lëvizje të muslimanëve. Më në fund analizuan se shkuarja e tyre do t'i dëmtonte në të ardhmen, dhe ata vendosën t'i ndalonin me çdo kusht. Pas dy muaj e gjysmë nga takimi i dytë i Akabe-s, kurejshitet vendosën ta mbysnin Muhammedin s.a.v.s.

Vërtet, nëse i hedhim një vështrim hartës gjeografike do të shohim se këto dy qytete gjenden në mes të magjistrale që fillon nga jugu i Gadishullit deri në veri, përgjatë bregdetit të Detit të Kuq. Jethribi është më në veri dhe është larg Mekës për katërqind e pesëdhjetë kilometra. Në atë kohë, me Bizantin bëhej një tregti e madhe dhe mekkasit detyrimisht do të kalonin nëpër Jethrib. Shkuarja e kurejshiteve muslimanë 'si armiq' nga Mekka do t'ju rrezikonte mallrat në një të ardhme të afër, prandaj ata vendosën që përfundimisht ta mbyllin kapitullin e tyre me Muhammedin.

Nëse Muhammedi s.a.v.s. i kishte mësuar ata se si ta vendosin Gurin e Zi në Ka'be pa u përçarë, ata tani do të vepronin një-lloj, por për fat të keq ata vendosën që çdo familje e kurjeshiteve të merrte pjesë në momentin e therjes të trupit të Muhammedit s.a.v.s., me thika ose shpata.

Ndërsa ata i kishte lajmëruar shejtani i mallkuar për marrëveshjen midis muslimanëve jethribas dhe Muhammedit s.a.v.s., All-lahu e informoi Muhammedin s.a.v.s. për komplotin e tyre dhe e urdhëroi atë, që të shpërngulet për në Jethrib – Medinen e ndritur.

Meqenëse komploti i tyre dështoi, mekkasit nuk hoqën dorë për mbytjen e tij, por e shpallën Muhammedin njeri shumë të rrezikshëm dhe ofruan shpërblim të madh për atë që e sjell të gjallë ose të vdekur. Edhe ky shpërblim nuk iu ndihmoi Muhammedit me shokun e tij Ebu Bekrin ishin më të shkathët dhe arritën që për dy javë të mbërrinin në Jethrib.

Imitimi...

Për një imitim të zgjedhur

Imitimi, si sjellje e si veprim i individit a i shoqërisë, nuk është njëngjyrësh. Prandaj nuk duhet marrë si një urdhër që të mos shikosh askënd se çka bën dhe ti të sillesh vetëm ashtu si ta dikton ty instikti personal. Duhet të shikosh përreth dhe duhet të zgjedhësh cilin do ta imitosh. Do të imitosh një femër-nënë e cila rrit një fëmijë për ta lënë pas vetes që të vazhdojë rrugën e gjallërimit njerëzorë, apo do të imitosh një femër-vetëm si femër e cila tërë kujdesin e vet ia kushton një klyshi a një maceje, duke e trajtuar atë si anëtarë të familjes.



Feti MEHDII

Pejgamberi Muhammed a.s. thotë: **Men teshebhe bi kavmin fehuve minhum.** Ai i cili imiton një popull është sikur ata.

Hadithi që u tërheq vërejtjen myslimanëve për dëmet që mund të ketë imitimi nuk e ka humbur aktualitetin. Madje për rrethanat shqiptare mund të thuhet se kohëve të fundit për dit e më tepër bëhet edhe më aktual.

Në gjuhën shqipe nuk kemi fjalë tjetër, përveç asaj me prejardhje latine: imitatio, immitiere... e cila fjalë ka kuptime edhe për teatër por edhe për jetën e përditshme. Këtu po i qasemi për funksionin që e ka në jetën e përditshme. Në jetën e përditshme fjala imitim, e cila në hadithin e Pejgamberit a.s. është "teshebhe" – me u bë si dikush tjetër, të sillesh, të vishesh, të veprosh, të flasësh... si dikush tjetër. Këto veprime ndodhin me një përpjekje individuale, fillimisht, e më vonë edhe shoqërore, që ta imitosh dikënd. Hadithi nuk do të thotë t i përngjash dikujt, sepse Pejgamberi a.s. nuk ka thënë **men shebbeh** ai që i përngjan dikujt – siç është interpretuar disa herë në kohë jo fort të largëta, por ka thënë **men teshebbeh** ai që e imiton.

Pak gjëra ka në jetë që mund të jenë origjinale, unikat. Të tjerat i përngjajnë dikujt tjetër, ose individit me angazhim personal e imiton tjetrin me dëshirën që të identifikohet me të dhe duke e imituar tjetrin natyrisht ky tjetërsohet. Në sy të njerëzve, në rrethin ku jeton fillojnë ta shohin jo ashtu siç ishte deri dje, por ashtu siç prezantohet sot. Me kalimin e kohës e humb të djeshmen dhe merr pamje të re dhe normalisht do të fillojnë

ta trajtojnë ashtu si është aktualisht.

Dilni deri në varreza të qytetit, sidomos në Prishtinë, dhe shikoni çfarë drejtimi kanë marrë dhe çfarë pamje kanë vorret tona! Kujtojeni traditën islame: krahu i djathtë në anën e kibles, te kryet dhe te këmbët një gurë i bardhë – simbol i bardhësisë që ndjell mirë, pafajësi, me një shkrim të shkurtër, pamje modeste ashtu siç duhet të jetojë dhe të vdes myslimani. Kjo mjafton për histori.

Shikojini sot: drejtimi i varrit sipas tekeve të varrmihësit, njëri vorr me krye kah veriu, tjetri kah perëndimi; te kryet fotografa në mermer të zi, te këmbët a te kryet një minare xhamie, një shpend, një libër, një veturë... e skalitur në mermer apo...njëlloj sikur te vorret pagane kur i varrosnin me gjithë topuz të gjuetisë apo almise tjera të punës!

Këto nuk janë rastësi! I bëjnë me investime të veçanta familjarët. Me vetëdije a pavetëdije, vorri flet vetëm me pamje. I vdekuri që është aty e ka mbyllë fletën e vet të historisë, të gjallët çka mendoj-

në?!

Pse e ka thënë Muhammedi a.s. këtë?

Sigurisht për të ruajt identitetin fetar dhe traditën kombëtare.

Imitimi, si sjellje e si veprim i individit a i shoqërisë, nuk është njëngjyrësh. Prandaj nuk duhet marrë si një urdhër që të mos shikosh askënd se çka bën dhe ti të sillesh vetëm ashtu si ta dikton ty instikti personal. Duhet të shikosh përreth dhe duhet të zgjedhësh cilin do ta imitosh. Do të imitosh një femër-nënë e cila rrit një fëmijë për ta lënë pas vetes që të vazhdojë rrugën e gjallërimit njerëzorë, apo do të imitosh një femër-vetëm si femër e cila tërë kujdesin e vet ia kushton një klyshi a një maceje, duke e trajtuar atë si anëtarë të familjes.

Në Kur'an lexojmë se All-llahu i ka krijuar të gjitha për njeriun, por aty i thuhet njeriut, ty të kemi dalluar e të kemi ngritur mbi të gjitha krijesat tjera. Andaj familjarizimi me kafshët, ashtu siç na prezantohen disa herë qentë dhe macet në programet televizive nuk është normale. Ata që i përkasin fesë islame



Pasqyra, një lloj imitimi!

le të përfillin fjalën e Muhammedit a.s. i cili thotë në atë shtëpi ku hyn qeni nuk hyjnë melekët, ngase qeni mbahet vetëm për roje dhe për të livruar. (Sahihu-l-Buhariu shqip, Libri i 6.)

Ky ves të cilin e përmenda nuk është i vetmi që ka filluar të lëshojë rrënjë në ambientet shqiptare dhe që është në kundërshtim me identitetin fetarë islam dhe identitetin kombëtarë shqiptarë. Ka edhe të tjera vese, ndoshta edhe më të këqija se ky. Do ta përmendi edhe një, për të cilin mendoj se është thjesht një imitim i ndonjë jete të kush e di se prej cilit rreth, por ama shqiptarë kurrsesi.

Ky është vesi i bastardimit të institucionit të familjes dhe të kurorës. I thonë bashkëjetesë, që me sa duket troket në dyer të institucioneve të drejtësisë dhe kërkon përligje në mesin tonë. Dikur në Kosovë bashkëjetesa kishte kuptimin të jetuarit në Kosovë, shqiptarët, serbët, turqit dhe të tjerët në harmoni njerëzore, por secili në shtëpi të vet, dhe kjo është gjithkund në botë. Jetojnë popuj të ndryshëm në një shtet dhe nuk i bie ndesh asnjë norme fetare e as kombëtare. Ndërsa sot bashkëjetesa ka marrë kuptimin dhe funksionin e shthurjes familjare. Sipas këtij modeli, gjithsesi imitim joselektiv, jetojnë bashkë një mashkull dhe një femër që i plotësojnë kushtet për kurorë (niqah), por nuk vejnë kurorë! Dëshirojnë të jenë të lirë. Nuk duah obligime! U mjafton të kënaqin instiktin që e kanë tëra gjallesat!! Lindin edhe fëmijë, por këta fëmijë janë të askujt, sepse ligji nuk i ka në evidencë, janë jashtë kurorës. Sipas ligjeve të natyrës këta fëmijë kanë edhe babë edhe nënë, dhe Kur ani na thotë, atyre dyve, nënës dhe babës, ruani se ua ktheni fjalën! Por ç e do që sistemi aktual nuk ua gjen asnjërin prind.

Të paktën është e sigurt nëna, por edhe ajo mbahet sekret! Thuhet, thjesht nuk ka prind. Edhe atëherë kur foshnja është e lindur në spital, identiteti i nënës mbetet sekret! Kjo është diçka jashtë gjitha normave njerëzore. E këta fëmijë, pastaj, për shkaqe humanitare i adoptojnë të tjerët, madje duket se edhe jashtë Kosovës.

Humaniteti i thëncin! Ia fsheh nënën natyrore e i gjen prind jonatror!

Kjo në traditën kombëtare shqiptare dhe në atë islame e ka emrin amoralitet, të cilin çdo shoqëri normale e lufton me mjetet dhe me mënyrën e vet. Kur ani e lufton me aktin e kurorës-niqahin. Aktet pa kurorë mund të paguhen edhe me jetë. Por ama fëmijut i garantohet e drejta ta dijë prindin e vet. Ku mund të shpie një shoqëri që nuk i siguron një krijese krejt të pafajshme të drejtën elementare?! Të di kujt do t i thotë nënë!

Thonë se kështu kanë parë në vende të kulturuar, në Perëndim.

Në perëndim, pra, kur janë në punë nuk shkojnë të pinë kafe a të bëjnë punë tjera private; nuk i hudhin mbeturinat rrugëve, as ujin nga ballkonet. Atje ka edhe shumë sjellje e veprime për lakmi që duhet imituar, por pak kush imiton të mirat Sa nga qytetarët tanë e imituan Zvicrën a Gjermanin për punë e për pastërti të ambientit?!

Imitimi joselektiv, tek ne, shtrihet edhe në fusha tjera të jetës dhe nuk është vetëm nga njëra anë e horizontit – Perëndimi. Vjen edhe nga Lindja.

Me anë të imitimit plasohen modele të sjelljeve, kryesisht nën petkun e fesë, por ato ngjyra fetare, nuk i përballojnë të tëra hapësira shqiptare.

Edhe nga ky këndvështrim imitimi vazhdon të jetë kuturu, gjithë çka e han pazari në Lindje nuk mund të futet edhe në mesin tonë. Duhet bërë një zgjedhje në bazë të kriterit: kohë-hapsirë dhe duke përfillur me përpikshmëri normën: konstrukt bazë-fasadë. Është fakt fatlum se imitimet e manireve fetare nga Lindja, kryesisht kanë të bëjnë me imitime që i referohen fasadës, por edhe këto imitime nuk janë të parëndësishme, kur kemi parasysh faktin se populli shqiptarë ka qenë në pozitë edhe gjeografike edhe kulturore të imitojë edhe Lindjen edhe Perëndimin.

Nëpër trojet shqiptare drejt Evropës kanë kaluar edhe Krishtërimi edhe Islami, të paktën për një pjesë të Evropës. (Në Bosnjë, dikur, kurse tash edhe në Zvicër, Gjermani e vende tjera...) Këtu janë gërshetuar fe, kultura e ideologji të ndryshme. Të tëra kanë gjetë, në një far dore, përkrahje për imitim. Imitimet që i kanë të freskëta opinioni shqiptar mund të fillojnë nga mjekra e Marksit, Çe Gevarës, shapka e Lenjinit, e deri të ndonjë mjekër e ndonjë djaloshi të

ditëve tona, të papara as përsëgjalli as në fotografi.

Një tjetër çështje është sot angazhimi e tendenca për të imituar edhe Mauzolejtë e Dimitrovit, Lenjinit, Titos e të tjerëve, pa e lodhur trurin fare se çfarë dobie praktike i sollën popullit konkret apo njerëzimit në përgjithësi. Nuk lodhen fare të dinë se çfarë përfundimi patën ata memoriale. Çfarë roli mund të luaj xhamadani i grisur i Gevarës, kaçketa e Lenjinit, mallotat e gjata a të shkurtëra të ndonjë autoriteti që i përket një kohe shumë të hershme, vendi, klime dhe rrethanave krejtësisht të ndryshme nga vendi jonë. Njerëzit janë të lirë, le të vishen si të duan dhe të sillen si u pëlqen, por gjithashtu janë të obliguar që të tjerëve mos ua imponojnë bindjen e vet, qoftë edhe përmes ndonjë maske fetare a ideologjike për të cilën ai vetë është i bindur se e ka drejt. Në fasada secili ka të drejtë të zgjedh çka i përshtatet atij dhe çka e pranon vendi dhe koha e tij. Me të vetmin kusht që fasada të mos praktikohet në shtëpi prej gardhi por në shtëpi me mure...


Imitimet që bëhen në emër të fesë apo në emër të patriotizmit kinse për të shprehur dashurinë ndaj fesë dhe ndaj figurave fetare, historike a kombëtare, vetëm sa i zbehin vlerat reale të tyre. Pas imitimeve të këtij lloji fshihet tendenca për ta vënë në rend të parë fasadën dhe për ta kamufluar thelbin e fesë apo vlerat themelore të kombit.

Imitimi është veprim i rëndësishëm, sepse me imitim fëmijë mëson fjalët e para e sjelljet e para, por imitimi i të rriturve pa asnjë far kriteri sipas kalendarit të përkatësisë fetare dhe kombëtare, jo që nuk ka dobi, por mund të jetë edhe shumë i dëmshëm për një kohë dhe rreth të caktuar, sepse teposhtë rrokulliset më shpejt e më lehtë.

Me norma fetare, buka dhe uji duhet respektuar deri në shejtani. Kujtoni prindërit tanë, të cilët kur e gjenin një kafshatë buke në rrugë e merrnin, e puthnin dhe e venin në ndonjë vend të veçantë ku nuk e shkel këmba e njeriut, që ta hanë shpeztë e egra; e kur pinin ujë, për respekt, uleshin qoftë në arë a në rrugë. Kurse sot, me shishe të ujit në duar vrap rrugëve.... A nuk është kjo një mospërfillje e nëpërkëmbje e dhuntisë më të madhe, pa të cilën nuk ka jetë. Buka është direkt i insanit, thotë populli. Por, pa ujë as buka nuk bëhet! Çdo send, të cilit nuk i çmohet vlera, humbet.

Çdo gjë që është e re nuk është, me çdo kusht, edhe më e mira.

Kujdes nga imitimi pa kriter! Sjellja në mes është e artë në jetë. Nëse dëshironi ardhmëri të qëndrueshme për breznitë që vijnë, çmoheni traditën, pasurojeni me vlera të reja në mënyrë selektive. Në të kundërtën do ta përjetojmë fundin e brezit pas nesh para përfundimit tonë! Ai që imiton Popullin e Lutit sikur populli i Lutit do ta gjejë!



Bashkjetesa, martesë antiligjore

Efektet negative të internetit dhe televizionit tek adoleshentët

HUMBJA E PËRGJEGJËSISË PËR SHKAK TË PËRDORIMIT TË TEPËRT TË TIJ

Rezultati i përdorimit të tepërt të internetit është largimi i të riut nga komunikimet e drejtpërdrejta me njerëz, duke u izoluar vetëm në komunikimet jo të drejtpërdrejta, qoftë me telefon, mesinxher, etj.

Parim OLLURI

Interneti dhe televizioni për shkak të efektit vizual kanë ndikuar më shumë tek adoleshentët. Këto dy medime përveç ndikimit pozitiv që mund të kenë, kanë edhe efekt negativ të padyshimtë që nuk mund të konsiderohet anësor.

Humbja e shkathtësive në të folur dhe humbja e përgjegjësisë janë pasojat e përdorimit të tepërt të internetit.

Psikologu , Riza Arënliu, ligjërues në Universitetin e Prishtinës, thotë se përdorimi i internetit më shumë se katër orë në ditë nga një adoleshent, shkakton humbjen e shkathtësive në të folur-in e drejtpërdrejtë, për shkak të praktikimit të komunikimit me shkrim. Nga kjo mund të konkludojmë se rezultati i përdorimit të tepërt të internetit është largimi i të riut nga komunikimet e drejtpërdrejta me njerëz, duke u izoluar vetëm në komunikimet jo të drejtpërdrejta, qoftë me telefon, mesinxher, etj. Psikologu Riza Arënliu thotë së efekt tjetër negativ është humbja e përgjegjësisë për shkak të përdorimit të tepërt të internetit. Mbi katër orë të kaluara çdo ditë para kompjuterit, një adoleshenti i marrin kohën për kryerjen e detyrave shkollore, po ashtu edhe të obligimeve tjera.

Televizioni, ashtu si edhe interneti, ka efektet negative, siç janë: humbja e përgjegjësisë, krijimi i iluzionit, vetizolimi i adoleshentit pranë televizionit.

Ekspertët e mediave dhe shkencave të komunikimit shpeshherë japin skemën këshilluese për kohën që duhet të kalojnë para ekraneve televizive fëmijët nën moshën 18 vjeçare. Deri në moshën 3 vjeçare nuk ka shikim televiziv fare, ndërsa prej moshës 3- 6 vjeçare 30 minuta në ditë, por jo rregullisht. Prej moshës 6 - 9 vjeçare një orë në ditë, por jo rregullisht, 9 - 12 vjeç një orë e gjysmë jo rregullisht, ndërsa prej moshës 15 - 18 nga tri orë jo rregullisht.

Por sa respektohet kjo? Fare pak ose hiç, bile shpeshherë mund të dëgjosh që disa prindër me qëllim e lënë televizorin ndezur në mënyrë që fëmija i tyre një vjeçar t'i kuptojë tingujt dhe fjalët.

Adoleshentët në masë të madhe janë



para ekraneve televizive, mbi katër ose pesë orë në ditë. Ata krijojnë ndjenja iluzionare duke u larguar nga realiteti dhe moseset e tyre i fshehin pas suksesëve të yjeve të preferuara. Mjaf-ton që aktori i preferuar të jetë i suksesshëm dhe u rregullua gjithçka.

Për t'iu shmangur këtyre efekteve nega-

tive të medimeve duhet që familja të dijë të kujdesët për fëmijën, të dijë për vendet ku e kalon kohën, të jetë selektive në përzgjedhjen e emisioneve televizive. Familja duhet të dijë të vërejtë shenjat e para të ndikimit negativ tek fëmija i tyre, e jo të presë diagnozën e psikologut.



Keqpërdorimi i Internetit sjell këto pasoja!

Leximi i tekstit

METAFORA E TEKSTIT

Kujtim Shala, "Vjeshta e shpirtit", poezi

Bashkërendimi i vjeshtës me gjendjen shpirtërore bëhet karakteristikë e tërë tekstit poetik si figurë përjetimi e një dashurie të humbur.**Flamur MALOKU**

Libri me poezi "Vjeshta e shpirtit" i Kujtim M. Shalës, që nga titulli shënon metaforën e njeriut të prekur shpirtërisht. Pra, titulli është metaforë e brendësisë subjektive, një gjakim individual-personal. Prandaj kemi një tekst që ndërthur në vete: zjarminë, mallin, gjakimin njohës e vetë-njohës subjektiv. Gjakimi njohës nënkuptohet haptazi në shtresën e poezive, i thurur me një shtresë përjetimi trishtues-dëshpërues. E gjithë kjo kuptohet përmes metaforës poetike që bëhet figurë e dëshpërimit dhe shprehje e përjetimit e përkujtimit. Më saktësisht subjekti gjatë përjetimit – përkujtimit gjakohet për një dashuri që është bërë lëndim shpirtëror. Prandaj, në përgjithësi, poezitë e këtij libri janë shqiptim i thellë i kësaj dashurie, së cilës i përshtatet edhe figura e vjeshtës. Kështu niveli shqiptimor i tërë përvuajtjes paraqitet përmes vjeshtës, e cila edhe zbret në shqiptimin e përmallim-

it-përkujtimit, pra vjeshtës i shton edhe mbështetjen shpirtërore, gjë që e forcon edhe kuptimin e idesë personale. Bashkërendimi i vjeshtës me gjendjen shpirtërore bëhet karakteristikë e tërë tekstit poetik si figurë përjetimi i një dashurie të humbur.

Duke filluar me poezinë "Nën shi" shohim se subjekti lirik ashtu përmallshëm kujton ndarjen, për çka figura e shiut i përshtatet tekstit. Shiu bëhet lot-kujtesë, njëkohësisht shqiptim përmallimi. Figura e shiut barazohet me emocionalitetin, për t'u bërë edhe kujtesë, po edhe identifikim gjakimi nëpërmjet pritjes së përfllakur:

*Në ditën e nisjes sate
Ra shi
Hija s'të mbeti prapa*

Ftohtësia shpirtërore së bashku me shiun sjellin emocionalitetin e shënjuar. Shiu bëhet pikë e përkujtimit-dhembjes-mallit e dashurisë së humbur, ku metafora bëhet figurë lidhëse e përkujtimit karshi dashurisë që mbitheksohet përbrenda tekstit.

Mirëpo pavarësisht nga ndarja që gjakon ashtu në heshtje, subjekti gjatë përkujtimit-përjetimit ruan dashurinë, edhe pse nuk ka kthim, pra ruan kujtimin për dashurinë. Shpallësja e dhembjes së shkaktuar nga ndarja, që tani ka mbetur kujtim e gjakim jetësor, del edhe tek poezia "Vjeshta e dashurisë".

*S'jam takuar asnjëherë me ty
Një ditë rrugëtimi larg ke qenë
Pa i këputur letrat
Asgjë s'kam menduar.*

Vargjet e theksojnë gjendjen e shqetësuar të subjektit, dhe këtu shqetësimi do t'i përshtatet edhe vetë stina e vjeshtës. Figura e vjeshtës, gjatë strukturës së tekstit sintetizon para së gjithash të ndodhurën e gjakimit brendor e jashtësor. Gjakimin brendor e sjell kujtesa për dashurinë, kurse atë jashtësor e sjell vetë vjeshta, që si e tillë shenjon gjithnjë e më shumë një dhembshuri të përjetuar. Metafora e vjeshtës bëhet: dhembshuri, emocionalitet, mall, etj. Mirëpo emocionaliteti nganjëherë thyen konventën, duke shkuar deri në konceptin e papajtueshmërisë.

Kur themi papajtueshmërisë kuptohet se kjo vjen si shkas i mosnjohjes së dashurisë nga personi tjetër (ajo).

*Kohë tjetër merr në mua
Vjeshtën ty s'ta njoh*


Në këtë rast prishet trajta: Subjekt-përkujtim-përmallim.

E gjithë kjo ndodh sepse subjekti dëshiron harrimin e kësaj dashurie, pavarësisht nga malli dhe dhembja. Vetënjohja e dashurisë që përshkruhet nga një trishtim i dukshëm subjektiv theksohet edhe në poezinë "Vjeshta e shpirtit" ku hëna, muzgjet, era hapin brendinë e trishtuar autoriale. Bashkërendimi i këtyre figurave në tekst thuren, po edhe konceptohen si përkufizim i dashurisë së lënë dhe të harruar nga (ajo):

*Ndoshta s'ke për të parë më shumë
se një hënë*



► Bukuria vjeshtore!



► **Përshpëritja**

*Tash po bëhesh një me kohën
Me erën.*

Vërehet se si subjekti e krahason dashurinë e harruar nga (ajo) me figuracionin, dhe në esencë konceptimi i figurës përmbysset në preokupim dhe në gjakim. Mirëpo preokupimi subjektiv do të shprehet qartë tek poezia “Pritja e shpirtit” ku rrjedha e fatit të dashurisë jepet në vargje me një paraqitje përvëluese e shqetësuese, pra mbitheksohet pritja që e rrit gjakimin autorial.

Pritja ngrihet si e vetmja pikë në tekst: Subjekti-Dashuria-Pritja-Malli. Malli është i pashoq në tekst, që domosdoshmërisht pranohet në tekst krejt haptazi, por nëpërmes vuajtjes:

*Të prita në prag të shpirtit
Grua
Psherëtimat lehtësim*

*Stinët i herrëm
Me sy e vesë
Të prita
Në zi të shpirtit*

Pritja bëhet shqetësim, zi shpirtërore, e shprehur me filozofinë e heshtjes-vetmisë. Ndjenja e pritjes gjen shprehje të fuqishme tek vargu i fundit “Të prita në zi të shpirtit”. Pritja rrit besnikërinë subjektive, edhe pse përcillet me një përjetim të zisë shpirtërore, pra varësisht gjakimit subjekti qëndron besnikërisht në pritje. Vetmia subjektive njëherësh shprehet nëpërmjet gjuhës metaforike më së miri në poezinë “Grabitësi i lulëve”. Vetmia e jetës karshi dashurisë funksionalizohet gjatë përshkrimit dhe përjetimit me zbërthimin e brendësisë shpirtërore. Edhe këtu pritja bëhet gjakim shpirtëror:

*Njëqind vjet pa ty rrugëtoj
Kujtimeve të moshës kthehem*

Perceptimi i mallit dhe rikthimi i mallit të moshës shkallëzon dramatikën e shpirtit, ndërsa largësia krijon ankthin e jetës-vetminë, e cila fuqishëm shkakton plagë tek subjekti:

*Pëshpëris emrin tënd
Drithërohet një yll
(plagë në dritë të syrit)*

Kështu theksimi i kësaj dashurie dhe pëshpëritja e emrit në heshtje përcillet me vuajtje të mbitheksuar përmes përfytyrimit të gjakosur subjektiv. Prandaj kujtimin e kësaj dashurie të gjakosur shpirtërore, Kujtim M. Shala e skicon në strukturën e tekstit. Dashuria tani është ngulitur në trupin-shpirtin-gjakun subjektiv, por gjatë këndimit-përkujtimit shoqërohet me metaforën e dhembjes. Prandaj i tërë teksti vijëzon këtë dashuri që në shpirtin e autorit është bërë vjeshtë.



*Kujtimet më vijnë
mu si këto valë deti*

Kujtimet, si deti ◀

Poezi

Mora veten për dore

Kozeta BOÇI

Të kuptoj

Munda të kuptoj
se nëse nuk e vlerësoj çastin,
kam humbur kohën.
Nëse kohën nuk e piketoj,
kam humbur jetën.
Nëse jetën time s'e dhuroj,
kam humbur veten.
Nëse veten time nuk e dua,
kam humbur të gjitha kuptimet.

Munda të kuptoj
se kam shumë për të kuptuar.

Kërkim

Kjo botë e zhurmshme
me buçitjen e këlthitjen e saj
m'i rëndoi veshët.
Përherë në lëvizje,
në një makth të pasosur
më marramendi.
Më vërtiti, vërviti,
më shkuli prej vetes
dhe prapë më lëshoi.
Më hodhi vetmuar në shkretëtirën e fjalëve,
të zhurmës, të hamendjes.

E hapur arena ku fekste dhe shuhej
shkëlqimi.

Rrëmbyer nga shkulma e erës
kërkova për fillin
që të më mbante ngërthyer
mbi truall të ngjeshur,
se nuk isha asgjëja,
rreshqitur ditëve e netëve.
Koha ta mbrunte në qenien time kuptimin.

Nuk isha e vetme
në shkretëtirën e zhurmës e fjalëve.
Nuk isha e fshehur
në përumbjen e thellë të natës.
Nuk ishte i humbur
kuptimi i qenies sime,
por tretur në hapësirën e dritës e të gjakut.

Me të vërtetën mbjellë në zemër
largova vetminë.
E kapa për fillin, e sigurt,
ta lidh pas vetes.
Hamendjet fashita prej ngushticës së
gjoksit,
lashë shpirtin të lirë.
E vërteta ime,
e vërteta e botës
në fjalën e Zotit.

Lutje

Zoti im!
Jepmë të mira në këtë botë,
të mira në botën tjetër!
Amin! Amin! Amin!

Ruamë prej vetvetes sime
përgjatë sprovave të jetës!
Amin! Amin! Amin!

Falmë durimin dhe urtinë
që të të njoh ty në veten time!
Më mirë, më thellë, më drejt!

Të shmang sherrin e shejtanit
edhe zjarrin e xhehenemit!
Më shumë, më larg, më shpejt!

Fali prindërit e mi
dhe të gjithë besimtarët!
Mëshirë, falje, shpëtim!

Ditën kur t'i fryhet surit
dhe të ngrihem prej varresh!
Amin! Amin! Amin!

Mora veten për dore

Mora veten për dore
dhe desha t'ia rrëfej disa gjëra,
të vogla a të mëdha.
Më shihte dhe i thashë:
"Që më sheh të duket pak?"
Më fliste dhe i thashë:
"Që më flet të duket pak?"

Ia mbështeta të dy duart mbi gjunjë
dhe si një mike e singertë
i përkujtova shumë nga gjërat
e vogla a të mëdha,
mbyllur në sepetin e harresës
bashkë me mirënjohjen
për gjërat e vërteta që Zoti na dha.

... e bëra të qante.

Lutje në agim

Drita depërton nëpër hijet e qytetit tim
e bardhë, e bardhë...
Rrezja ia çel sytë lules së mekur.
Mëshirshëm shpërndan gulçin dhe
zhurmat e mugëta
nën strehën e saj.
Largohet errësira nëpër fashën e fundit
të mbetur.

Kaploi hareja e fshehur kushedi se ku.
Burimi hyjnor e derdhi në arën e jetës.
Jeta e mori, e thithi, e tejçoi përfund
damarëve dhe guvave të fshehta të
rrjedhës.

Mëshira zbriti prej Teje, o Zot,
mbi çdo krijesë.
Ajo gëlon me aromë shprese.
Unë në prehrin e saj ulem lehtë,
ngre duart e bindur ndaj Teje me dritë pendese.

Mëshiomë, o Zot,
si zogun e fundit të vjeshtës
që era e marrë e përfundi nën afshin e ftohtë!
Ia mbrun jetën midis krahëve të
mpakur dhe zemrës.
Jeta i bulëzon në fluturim e ngrohtë.

Mëshiomë, o Zot,
si zogun e fundit të vjeshtës
që drita e tërheq në rrugën praruar prej saj!
Vrullshëm palon krahët e mpikura prej erës.
Zhdërvillet midis ankthit dhe mekjes
fitimtar.

Mëshiomë, o Zot,
se malin mbi supet e mia
s'mund ta ngre!
Veç lutja ime rreshqet
dhe kërkon dyer mes qiejve.
Zemra më përkundet
me frikë dhe me shpresë.
Kërkoj mbrojtjen Tënde prej vetvetes
së dobët,
deri në vdekje!



Vitrina e librit

BOTIME ME VLERA FUNDAMENTALE

Berat DAKAJ

Cështjet teoriko-kritike për sonetin në poezinë shqipe prej disa vitesh kanë qenë në mungesë të literaturës në kritikën tonë. Milazim Krasniqi në vazhden e krijimeve të tij artistike (poezi-dramë) ka botuar edhe libra publicistikë, si: "Horret në krye të detyrës", 1998, dhe në vitin 2000 ka nxjerrë edhe librin tjetër publicistik "Kosova pas 22 janarit 1998".

Në vitin 2005 ka botuar edhe librin teoriko-kritik "Soneti në poezinë shqipe". Në këtë libër kritiku projektin idenë rreth sonetit të parë (sonetistit) në poezinë shqipe e deri te sonetistët e sotëm, d.m.th. në këtë tekst studimor shtrihet një kontekst historik sipërfaqësor për sonetin, duke filluar që nga lindja e tij 1777, kur shkruhet soneti i parë "Për vetëhenë" nga Nikollë Keta, duke vazhduar pastaj ecjen në periudhën e romantizmit të gjerë, pastaj duke kaluar në disa nga poetët e periudhës moderne; të realizmit socialist e deri në shtrirjen e formacioneve të reja estetike në letërsinë bashkëkohore.

Në të gjitha këto periudha Krasniqi vëren ndryshimet tematike, stilistike, retorike, estetike të sonetit. Ky libër është kontroll analitik që shfaq shumë tendenca të shpeshta krahasuese edhe me ndërlidhjen e njërit sonet (sonetist) në ndikimin e tjetrit.

Librin e botoi PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2005, fq 314.

"50 të pashmangshmit – Filozofët më të mëdhenj të kohërave" është libri i autorit Edmund Jacoby. Ky libër jep një panoramë të gjerë për jetën dhe veprat e filozofëve me më zë, nga filozofia antike e deri në periudhën e filozofisë bashkëkohore, pra bën edhe radhitjen e rrymave filozofike, jetëgjatësinë e tyre, dilemat, kthesat filozofike, biografinë e 50 mendimtarëve të thellë.

Nëpër të kalojnë figurat e Talesit, Parmenidit, Sokratit, Platonit e Aristotelit, pikëpamjet e tyre për botën/natyren, Zotin dhe njeriun, për idetë – teoria e gjerë për artin, pastaj estetët e mëdhenj Hegeli e Kanti, Dekarti, Spinoza, Niçëja, Loku, Shopenhaueri, Makialveli, etj. Në jetën dhe veprën e tyre Jacoby portretizon edhe figurat e tyre (portretet). Ndryshimet e rrymave filozofike janë dhënë si kronologji e rrjedhave të men-




dimit të këtyre filozofëve që hapin një kod filozofik të pashtershëm, një përpjekje e veçantë për ta kuptuar botën dhe gjerat përreth saj. Në këtë libër vihen në diskutim shumë teori filozofike që kanë bërë

kthesë të madhe në përpjekjet për përcaktimin e materies dhe spirituales. Tërësia mbi pikëpamjet e ngushta filozofike e bën këtë libër një abetare që duhet lexuar.

Librin e botoi Shtëpia Botuese "Max", Tiranë, 2006, fq. 310.

Poeti i letërsisë për fëmijë, Agim Deva, lexuesve të vegjël ua solli edhe një be-fasi. Para një jave ky autor ka nxjerr në treg librin "Mungon një zemër". Prej 65 librave me vëllime poetike sa ka botuar gjerë tani ky autor, libri i fundit i tij dalton shumë nga të tjerët, si për nga figurat stilistike, po ashtu edhe me tematikën e poezive. Në shumë nga poezitë e tij pasqyrohet në mënyrë të kapshme bota e fëmijëve, dëshirat, shkollimi i tyre, enigmat për botën dhe jetën. Ligjërimi i poezive humoristike të këtij libri është ndërtuar me një gjuhë figurative që provokon logjikën e fëmijëve. Libri nuk ka ndarje në cikle. Përbërja tematike e tyre e bën një shkrim asociativ që mund të lexohet me një frymë.

Fëmija, shoqërimi me njëri-tjetrin, pastaj në anën tjetër bota zoologjike që e rrethon qenien antropomorfe i japin një atmosferë të jashtëzakonshme këtyre poezive.



Në disa raste Deva lëshohet dalëngadalë në imagjinatën e fëmijëve, duke bërë që të bashkëjetojnë imagjinata e tyre në mes botës reale dhe asaj fantazmagorike. Shumë nga

poezitë e këtij libri janë të shkruara në strofë katërshë, me vargje tetërokësh, por vende-vende haset edhe strofa pesëshë, treshe, me vargje të lira. Rimat më të shpeshta janë abab.



Libri ka 71 poezi. Botoi Shtëpia Botuese "Zef Serembe", Prishtinë, 2007, fq. 143.

Libri më i ri i publicistit dhe analistit politik Ibrahim Berishës "Media agjensët e komunikimeve" jep një program të gjerë mbi median-komunikologjinë, e cila vështrohet nga shumë aspekte; në radhë të parë si një art që bashkon talentin dhe vullnetin e njeriut për t'u bërë gazetar dhe njëkohësisht mundësinë e këtij kërkuesi për të vërtetën e informacioneve që jep.

Libri është i ndarë në nëntë pjesë. Te pjesa e parë qasja e studimit shtegton rreth nocioneve teoriko-kritike të mediave (gazetës, televizionit, radios etj.), të cilat përbëjnë edhe boshtin e rrjetës së gjerë të marrjes së mendimeve nga opinioni. Bën edhe dallimin nga media, media masive, ku në interpretimin e tyre radhit edhe llojet e moduseve të teorive të komunikimit, që ndikojnë në kulturën masive të perceptuesit dhe ndërmjetësit e tjerë ndërkombëtarë. Pjesa e dytë ndërlidhet me kontekstin sociologjik, duke parë në këtë rast marrësin e mesazhit të mediave si njeri që kërkon të vërtetën nga qendra e hapur e informimit. Përballimi i shoqërisë në industrinë e mediave, dallon edhe masën dhe publikun, opinionin spontan, global dhe ai atë të qeverisurve. Librin e botoi PEN Qendra e Kosovës, UAAB, Prishtinë, 2006, fq. 323.



Qyteti-vlerë, midis të kaluarës dhe vrulleve moderne

KONSERVIMI DHE RESTAURIMI I HAMAMIT TË MADH NË PRISHTINË

Hamamet, banjat publike të ruajtura deri më sot, edhe pse të transformuara, edhe pse me elemente të humbura nga gjendja fillestare, prapëseprapë zënë vend meritor në trashëgiminë dhe thesarin e kulturës. Hamami i Prishtinës për shkak të vlerave arkitekturore është shpallur në vitin 1967 monument i trashëgimisë kulturore dhe historike. Ka funksionuar si hamam deri në vitet 70-ta të shekullit XX-të. Për shkak të vjetërsisë objekti ishte dëmtuar dhe i kanosej rreziku që të rrënohej.



Nexhati SPAHIU

Prishtina si kryeqytet i Kosovës është qendër e zhvillimeve kulturore dhe artistike e të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Kosovë.

Drejtoria për Kulturë e Komunes së Prishtinës është vetëm një segment që kujdeset për ngjarjet e rëndësishme kulturore që e radhisin sot Prishtinën ndër qytetet që ka një traditë të theksuar kulturore e artistike.

Trashëgimia kulturore është kapitull në vete që pasqyron lashtësinë e Prishtinës si qendër administrative dhe kulturore, që nga Dardania e vjetër para 3500 vjetësh, e deri sot.

Hamami i Prishtinës është një ndër objektet më të rëndësishme të qytetit të Prishtinës. Siç dihet, gjendja në atë kohë ka qenë shumë e vështirë.

Nëpër shtëpi nuk ka pasur kushte. Ky hamam është përdorur për pastrim dhe kjo ka qenë arsyeja e ndërtimit të tij. Ky është përdorur për të dy gjinitë, por me hyrje të veçanta. Hamamet, banjat publike të ruajtura deri më sot, edhe pse të transformuara, edhe pse me elemente të humbura nga gjendja fillestare, prapëseprapë zënë vend meritor në trashëgiminë dhe thesarin e kulturës, përkatësisht në ekzemplarët e vlerave të trashëgimisë etno-kulturore, në vlerat e kulturës materiale shqiptare.

Me ardhjen e komunistëve në pushtet këto lloj Hamamesh janë përdorur si depo, pastaj janë shndërruar në objekte të ndryshme, si: banja publike. Hamami i madh gjendet në

qendër të bërthamës së vjetër të qytetit të Prishtinës, në mes të xhamisë së Sulltan Mehmet Fatihut dhe hamamit të vogël. Është ndërtuar me gurë mesatarë e të vegjël, të lidhur me llaç. Nga ana e brendshme muret janë të suvatuara.

Koha e saktë e ndërtimit të këtij objekti nuk dihet, por mendohet të jetë ndërtuar menjëherë pas xhamisë së përmendur, pra diku pas vitit 1461.

Objekti ka formë katërkëndëshe. I takon objekteve me karakter utilitar dhe përfshin një sipërfaqe rreth 800 m². Përbëhet nga dy pjesë të barabarta "Çift Hamam", njëra e rezervuar për meshkuj, kurse tjetra për femra. Objekti është përdhës, me hyrje nga ana jugore. Ky objekt mbulohej nga 15 kupola dhe një çati katër ujore.

Ndriçi-



Pamje e Hamamit të Prishtinës nga jashtë!

mi vinte nga hapjet qe ndodheshin në kupola. Për shkak të vlerave arkitekture, në vitin 1967, është shpallur monument i trashëgimisë kulturore dhe historike. Ka funksionuar si hamam deri në vitet 70-ta të shekullit XX-të. Për shkak të vjetërsisë objekti ishte dëmtuar dhe i kanosej rreziku që të rrënohej.

Duke parë rrezikun e shkatërrimit, Instituti i Monumenteve dhe Muzeut Komunal të Prishtinës, me ndihmën e Drejtorisë për Kulturë të Komunës së Prishtinës dhe “Trashëgimisë Kulturore pa Kufij” (CHWB) ka ndërmarrë nismën e hartimit të projektit të rehabilitimit të Hamamit të Madh të Prishtinës.

Më 25 prill të këtij viti kanë filluar punimet për restaurimin e banjës së qytetit të Prishtinës, projekt ky të cilit i është bashkangjitur edhe OJQ “Trashëgimia pa kufij” nga Suedia, e cila ka ndarë 60.000 euro, që kryesisht do të përdoren për fazën e parë.

Drejtoria për Kulturë dhe Gjini e Komunës së Prishtinës, për këtë vit prioritet i ka dhënë

infrastrukturës kulturore në përgjithësi, kurse trashëgimia kulturore do të jetë me rëndësi të

veçantë.

Në kuadër të këtyre projekteve është edhe banja (hamami) i madh i Prishtinës që i takon periudhës së shekullit XV-të. Ky objekt me dekada është dëmtuar nga shfrytëzuesit e ndryshëm dhe gati është bërë i papërdorshëm.

Drejtoria për Kulturë këtë vit ka ndarë një fond prej 140.000 eurosh për fillimin e restaurimit dhe konservimit të këtij objekti me vlerë të veçantë të trashëgimisë sonë kulturore.

Hamami i madh do të restaurohet në tri faza: pastrimi, demolimi i pjesëve shtesë që janë bërë nëpër kohë, analizat statike dhe konstruktive të ndërtesës dhe masat konsoliduese për strukturën ndërtimore që nënkupton përmirësimin e themeleve, të çarjeve të ndryshme

dhe rregullimin e kulmit - njofton Zyra për marrëdhënie me publikun e KK të Prishtinës.

Edhe pas restaurimit të këtij hamami, ky hamam do të jetë nën mbrojtjen e Institutit të Monumenteve Historike dhe nuk do të përdoret si banjë publike, sepse nuk mund t'i rikthen vlerat e lashta historike siç kanë qenë – kështu u shpreh Drejtori i Institutit të Monumenteve dhe Muzeut rajonal të Prishtinës, z. Haxhi Mehmetaj.

PUNËKRYËRSI

MEGI
Bau GmbH

KRYEJM TË GJITHA PUNËT NDERTIMORE:
PRISHTINË, KOSOVË

Wien, AUSTRIA

Tel & Fax: +381 (0) 38 542 692
Tel. 01/60 00 693

Mob: +377 (0) 44 174 235
Fax. 01/60 00 860

E-mail megigmbh@hotmail.com : megibau@hotmail.com



Pamje tjetër e Hamamit

Sporti në Kosovë

NDËRKOMBËTARIZIMI I SPORTIT KOSOVAR

Kohëve të fundit është rritur intensiteti i përpjekjeve të drejtuesve të federatave sportive të vendit tonë për anëtarësim në asociacionet ndërkombëtare

Sead UJKANI

Sikundër edhe në sfera të tjera, sporti i Kosovës ka shënuar ngritje, zhvillim dhe funksionalitet të dukshëm. Në përgjithësi në krahasim me gjendjen paraprake të paraluftës janë bërë hapa të mirë në drejtim të:

- * Konstituimit dhe zhvillimit të strukturave organizative institucionale;
- * Rehabilitimit dhe reformimit të federatave, shoqatave dhe klubeve të sportit;
- * Hartimit, përpunimit dhe miratimit të ligjit të sportit;
- * Përpilimit të politikave programore, përkatësisht planifikimeve zhvillimore të sportit për periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Ndër synimet kryesore të Departamentit të Sportit dhe federatave përkatëse sportive si organe udhëheqëse të sportit ka qenë dhe mbetet ndërkombëtarizimi i sportit kosovar.

Organizimi i ngjarjeve me karakter ndërkombëtar (rasti i gjysmë-maratonës në Prishtinë), pranimi i federatës së pingpongut në federatën ndërkombëtare të pingpongut, anëtarësimi i federatës së hendbollit në federatën evropiane të hendbollit EHF (dhjetor 2004) dhe tash së fundi edhe në federatën ndërkombëtare të hendbollit IHF (shkurt 2007) si anëtare me të drejta të kufizuara, organizimi i vizitave dhe takimeve të rëndësishme brenda dhe jashtë vendit, janë disa nga aktivitetet që kanë karakterizuar

ndërkombëtarizimin e sportit kosovar.

Pengesë për avancimin ndërkombëtar të sportit ka qenë moszgjidhja e statusit të Kosovës. Mirëpo, propozimi i fundit i të dërguarit special të OKB-së për statusin final të Kosovës ka hapur rrugë për anëtarësimin e federatave sportive në institucionet përkatëse ndërkombëtare. Në përmbajtjen e dokumentit të propozuar theksohet se Kosova do të ketë të drejtë të anëtarësohet në të gjitha organet ndërkombëtare (OKB, institucione financiare, sportive etj.). Duke u nisur nga kjo, kohëve të fundit është rritur intensiteti i përpjekjeve të drejtuesve të federatave sportive në vendin tonë për anëtarësim në asociacionet ndërkombëtare.

Kjo vërehet edhe nga takimet dhe vizitat e fundit të zyrtarëve të futbollit dhe basketbollit në veçanti për afirmimin e këtyre sporteve, ndër të cilat theksojmë: vizitat e zyrtarëve të FFK-së bërë Federatës Gjermane përkatësisht asaj suedeze të futbollit, vizita e kreut të FBK-së në

Sloveni dhe takimet me zyrtarët e basketbollit sloven, takimi i zyrtarëve të FBK me presidentin e FIBA Evropës Georgis Vassilokopoulos në selinë e Federatës greke, etj.

Natyrisht përshpejtimi i pranimi të federatave sportive në shtëpitë kryesore të sportit botëror nuk varet vetëm nga udhëheqësit e asociacioneve ndërkombëtare, por edhe nga vet angazhimi i të gjithë strukturave sportive në vendin tonë. Sportit kosovar i nevojiten kadro që në punën e tyre sakrifikojnë diçka nga vetja, përkatësisht i nevojitet udhëheqje serioze dhe strategji zhvillimore në mënyrë që procesi i pranimi të mos ngeçë për shkak të dobësive organizative.



Me gjithë progresin e arritur në drejtim të avancimit ndërkombëtar të sportit kosovar mbetet ende punë për t'u bërë. Prandaj është më se i duhur një mobilizim i të gjithëve në drejtim të shkollimit të kadrove profesionale dhe hapjes së akademive sportive, si dhe zhvillimit dhe përmirësimit të infrastrukturës së sportit si elemente të rëndësishme

që do të ndikojnë në masë të madhe në rrugën e ndërkombëtarizimit të sportit në vendin tonë.

Në Prishtinë u mbajt gjysmë-maratona "Prishtina 2007"

Për herë të shtatë me radhë të dielën më 6 Maj, në Prishtinë, është mbajtur gjysmë-maratona tradicionale "Prishtina 2007" me moton "Për paqe dhe tolerancë". Organizatorë të gjysmë-maratonës ishin Federata Atletike e Kosovës në bashkëpunim me departamentin e Sporteve të Kosovës, ndërsa sponsor kryesor i këtij organizimi ishte Pro Credit Bank.

Është për t'u theksuar se gjysmë-maratona e sivjetshme, për dallim nga vitet e kaluara, u karakterizua nga një pjesëmarrje më e vogël e garuesve.

Fitues i sivjetmë i gjysmë-maratonës 21 km në konkurrencën e meshkujve ishte Jerosllav Mushinski nga Moldavia, ndërsa në konkurrencën e femrave Milka Mihajlova nga Bullgaria.

Në kategorinë e veteranëve, fitues doli Trpe Martinovski në konkurrencën e meshkujve, dhe Rumihana Panovska në atë të femrave.

Meriton Hasanaj dhe Liria Tozlovanu ishin fitues në kategorinë deri në 5 km, ndërsa në garën e personave më aftësi të kufizuar fitues dolën Avdyl Ibishi në konkurrencën e meshkujve, përkatësisht Kumrie Ukshini në atë të femrave.

Organizimi i radhës i gjysmë-maratonës ishte një hap i rëndësishëm në drejtim të avancimit ndërkombëtar të sportit të atletikës në veçanti, dhe të sportit kosovar në përgjithësi.



GJYKATA URDHËRON PESHKATARIN T'I KËRKOJË FALJE SHQIPONJËS

Joshua Williams duke i kërkuar falje, i urdhëruar nga gjykata, një shqiponje pasi që ishte dënua për rrezikimin e specieve.

Bujar SEJDIU

Sioux Falls, Dakota e Jugut, SHBA) Një e diel e bukur dhe paqësore papritur u shndërrua në një ditë të hidhët për Josh Williams. Problemi filloi kur z. Williams kishte gjuajtur një peshk që ishte vërejtur nga një shqiponjë. Në momentin kur shqiponja u hodh, duke tentuar ta fuste peshkun në kthetrat e saja, z. Williams ishte vërejtur nga një oficer i Shërbimit të Peshqve dhe Botës së Egër, që po mendohej ta frikësonte shqiponjën duke e gjuajtur me gurë. Oficeri i Shërbimit të Peshqve dhe Botës së Egër dëshmoi në Gjykatën e Dakotës së Jugut në SHBA se z. Williams kishte shkelur haptas një nga Dekretet për Speciet e Rrezikuara që në mënyrë specifike e bën ilegale të "...ngacmohet...një specie e rrezikuar apo e kërcënuar pa pasur leje speciale nga Sekretari i Departamentit për Çështje të Brendshme." Gjykata u pajtua, duke shpallur z. Williams-in fajtor për veprim të ndaluar ndaj

Dekretit. Gjyqtari u tregua i butë në dënim, sidoqoftë, duke kërkuar që së paku i



ishite rrezuar për shkak të lodhjes nga nxehtësia, edhe pse kishte dalë që të gjuante arinj.

pan-dehuri t'i kërkojë falje shqiponjës. Z. Williams shprehur pen-dim dhe keqardhje, dhe deklaroi se shqiponja do të ishte e mirëseardhur për t'indihmuar atij në peshkim kurdoherë që do të dëshironte. Shqiponjanuk kishte ndonjë koment.

Gjuetari Jeremiah Johnsons përkujdeset për një ari polar që

(Cold Bay, Alaska) "Nxehtësia e temperaturës në regjionet polare është duke shkaktuar një numër në rritje të arinjve që rrëzohen për shkak të lodhjes nga nxehtësia" - raportojnë gjuetarët lokalë.

Jeremiah Johnson, një gjuetar lokal që iu vë kurthe dhe gjuan arinjtë polarë "pasi që janë aty", ka parë tre të tilla duke u rrëzuar pranë tij vetëm gjatë një muaji.

"Thjesht nuk është sportive të gjuash ndonjë nga këto krijesa atëherë kur ato janë duke vuajtur në këtë mënyrë", tha Johnson duke treguar tentimin e tij që ta rigjallëronte një ari që kishte qenë gati për ta gjuajtur.

Metereologët e TV lokal Sky McCloud sqarojnë: "Mesatarja e temperaturës në zonë është ngritur nga 20 gradë nën zero në 15 gradë nën zero në 30 vitet e fundit, dhe këto krijesa gjigante thjesht nuk mund ta durojnë këtë nxehtësi."

Hulumtuesit e arinjve pajtohen me McCloud. Dr. Philip Slander, nga Kujdesi për Botën e Egër dhe Departamenti për Komoditetin e Universitetit të Alaskës:



Dyoksid karboni i tepërt i shkaktuar nga djegia e karburanteve të njerëzimit, ka shkaktuar një problem të ri – bimësinë që është duke absorbuar se tepërmi “ushqim bimor” dhe në disa raste paraqitet me shpejtësi edhe në disa vende ku nuk janë të dëshiruara

“Njerëzit nuk e kuptojnë se sa shumë i streson temperatura arinjtë polarë. Arinjtë në mënyrë të vazhdueshme janë duke u hedhur në oqean duke tentuar që të freskohen.”

Hulumtuesit besojnë se është vetëm çështje kohe para se arinjtë polarë të zhduken. “Dhjetë gradë nën zero duket të jetë një pikë pajtimi lidhur me këtë”, tha McCloud. “Kur temperatura mesatare të ketë arritur këtë shkallë, për disa ditë arinjtë do të fillojnë të rrëzohen sikur mizat.”

Dr. Slander, rikujtoi një incident që kishte ndodhur së fundi, kur një ari polar kishte sulmuar një njeri të

bonit rreth 50% - një fakt për të cilin të gjithë shkencëtarët me reputacion thonë se do të shkaktojë shkatërrimin eventual të jetës, siç e dimë nga ngrohja globale.

Por, përderisa ne jemi duke pritur që të arrijë kjo ditë, fenomeni i CO2 është duke i shkruar për shtati dikujt: bimët janë dashuruar në të. Ky ekstra “ushqim” i bimëve ka shkaktuar gjelbërimin e tokës atëherë kur nuk është koha për një gjë të tillë.

Ky gjelbërim botëror ka çuar deri te një problem i papritur për motoristët në shumë vende. Njerëzit papritur

të madhe te Hammer-ave dhe Corvete-ave, makina këto të cilat lirojnë sasi të madhe të CO2. Flitet që disa makina kanë pasur probleme nga disa lloje “agresive” të hardhive Kudzu që janë rritur afër rrugëve.

“Thjesht isha duke pritur që të ndizet drita e gjelbër, dhe dëgjova një zë gërvishtës në dritaren e prapme. Kur u ktheva pashë një hardhi që “tentonte” të hynte në makinën time...vërtet isha i rrëqethur” - tregon tekniku i kompjuterëve Josh Fester.



pas - trehë dhe i kishte dëmtuar vetëm një pjesë të trupit të njeriut para se të rrëzohej nga lodhja. “Për shkak të ngrohjes globale, jeta normale e arinjve është duke ndryshuar me të madhe... kjo është tragjike.”

(Chicago, Illinois) Dekadat e djegies të karburanteve, qysh nga fillimi i Revolucionit Industrial, e kanë ngritur koncentrimin atmosferik të dyoksid kar-

duke i gjetur makinat e tyre të mbuluara nga bimët që janë rritur brenda natës në atë masë sa që i kanë ngulfatur makinat e tyre.

“Kisha vetëm 10 min për të shkuar në punë me kohë, dhe e gjeta makinën time pothuajse të tërën të mbuluar nga gjethet”, rrëfen inxhinieri Rachael Filler.

Zakonisht kjo është duke ndodhur nëpër vendet urbane ku ka vozitje më

Kohëve të fundit janë shpeshuar ankesat e qytetarëve për këtë problem. Policia lokale thotë se nuk ekziston ndonjë juridiksion për këtë problem. “Nuk ka ndonjë dekret, apo qëndrim, apo ligj federal që është duke u shkelur nga këto sulme të bimëve, sqaron oficeri Joe Friday. “Kam frikë se e tëra që mund të bëjmë është të ulemi dhe të shikojmë bimët duke bërë punën e tyre. Por nëse e tejkalojnë limitin e shpejtësisë, apo fillojnë të bëjnë rrëmujë me gjethet e tyre, ne do t'i shfarosim fare.”

Ilir DESKU

Vërtet është bërë monoton...

Oj Kosovë sa vend i bukur
Ty gjithnjë të patën thanë
Ku nuk kishin nga t'ia mbanin
Ty të gjithë të thirrshin nanë

Tash ke shumë të mira, shumë begati
Anë ë kënd ti ke lulëzu
Tash ke ministra në qeveri
që të gjithë janë korruptu

Kanë marrë poste me rëndësi
që as vete ata se dijnë
nuk dijnë mirë me i shkru dy fjalë
na e prishën krejt shoqërinë

Me korrupsion e me rryshfete
qeveria jonë asht mësu
i harxhojnë parat n'tendere
e për popull s'kanë kohë me mendu

Se një zanat shumë t'keq e kanë
me vjedh shumë nuk thonë kurr gjë
e me bërë me vjedh pak
mjerë për ty thonë çka je tuj bërë

Ah populli i Kosovës, popull i shkretë
ti gjithnjë ke qenë i ngratë
me pasë punë më ksi ministrash
jo nuk paska ma taksirat

Shpresojmë që një ditë
Të zhduket gjithë ky korrupsion
Se një jetë e tillë tek ne
Vërtet është bërë shumë monoton

PROVERBA TË NDRYSHME

\$ Për ta dënuar atë që të ka bërë një të keqe, bëje të turpërohet kur t'ia kthesh me një të mirë

\$ Ata që dëshirojmë ti shkatërrojmë, duhet t'i ngritim lart. Nga lartësia - më lehtë rrëzohen

\$ Njeriu i shëndoshë ka me qindra dëshira, ndërsa i sëmuri vetëm një - të jetë i shëndoshë

\$ Ne më me dëshirë do te vdisnim ne këmbë, sesa te jetojmë te gjunjëzuar

\$ Krenaria shpërblehet me mëngjes te pasur, me dreke te varfër ndërsa me darkë të mjerë


\$ Diplomati është njeri që mendon dy herë para se të mos thotë asgjë


\$ Është shumë më mire të dish ngapak për çdo gjë, sesa ti dish te gjitha për një gjë

\$ I drejtë është ai njeri që nuk dëshiron të jetë i padrejtë, edhe pse ka mundësi të jetë i tillë

\$ Aty ku mbretëron drejtësia, armët janë te panevojshme

\$ Besimtarë më të mirë janë ata qe durojnë në fatkeqësi, ndërsa falin kur janë të fuqishëm





HORIZONTALISHT

1. Gazetar yni, Zeka – Që ka të bëjë me avullin, 2. Dhënia e mësimit në shkollë, në një kurs – Dhe (gjer.), 3. Ismail Shehu – Lloj fruti – Shufër e metaltë si hell i vogël që e përdorin argjendarët – Spanja, 4. Ibrahim Rugova – Që nuk ia mban anën askujt – Oksigjen e Radius, 5. E moshës rinore – lëng i pangjyrë me erë të mprehtë, që avullohet shpejt – Korporata Energjetike e Kosovës – Italia, 6. Rri ose qëndroj më vete – M, 7. Molibden – Ministria e Energjisë dhe Minerave, 8. Deputetja në Kuvendin e Kosovës, Ahmeti – Toka, 9. Statujë a figurë që figurë që adhurohet si hyjni – Që ka të bëjë me italian, 10. Azot – Karbon – Lumturi, 11. Fjalë e përdorur në mbarim të lutjeve me kuptimin “ashtu qoftë” – Ior, 12. Zanorja e tretë dhe e pestë – Varg gjërash të njëjta, 13. Hysni (popull) – Edhe (lat.) – Amerika, 14. Milaim Osmani – Kalium – K – Zanorja e katërt, 15. Numri i parë – Karbon – Ngacmimi, 16. Ujë – Kryeqyteti i Kosovës (foto) – Kyç, 17. Ton – Përzjerje e çimentos me zhavor e me ujë – Bujk, 18. Ndryshoj trajtën e diçkaje – Kafshë shtëpiake (ang.), 19. Pashirmë – Kilometër – Mineral hekuri ose çelik, që ka vetinë të tërheqë sendet prej hekuri ose çeliku, 20. Të qenët vetëm – Gjermania – Emër mashkulli shqiptar – t.

VERTIKALISHT

1. Notë muzikore – Ermira Mushkolaj – Dijetar musliman, Ibn – Idriz Mehmeti – Uran – Molibden e Volt, 2. Që ka mëshirë të madhe për të tjerët, fet. Zoti – Shkolla – Ismet Sadrija – Kthesë rrënjësore në jetën e shoqërisë – Zanorja e tretë – Hapësirë shumë e madhe me ujë të kripur, që zakonisht është e rrethuar me tokë, 4. Sipërfaqe e rrafshët, rrafsh – E – Ahmed Jusufi – Azot – Shkoj – Program By Institute – M, 5. Një gjë që ia lëmë dikujt për ta ruajtur e për tu kujdesur për të – Emër mashkulli shqiptar, 6. I tetë, i nëntë, ... – Përdorimi i fjalëve të dikujt tjetër për ndonjë mendim apo ngjarje, 7. Ai që jep mësim në një shkollë të vetë – Emër mashkulli shqiptar, 8. Nitro – Që ka të bëjë me botën e brendshme të një njeriu, 9. Përemër vektor – Radius – Hidrogjen – I moshës së re – Burrë (ang.), 10. I formës vezore – Pompa e benzines – Galium, 11. Uran – Di (ar.) – bis – Që është karakteristik për një grup të ngushtë brenda një organizate – Nikel, 12. Lluca që sjellin ujërat e lumenjëve ose të përrenjëve kur vërshojnë jashtë shtetit të tyre – Kalium – Hotel në buzë të rrugëve me qarkullim të madh (sh.) – Irid – Prapë (popull), 13. Kyçur (ang.) – Oksigjen – Përdorimi i një fjale a i një shprehjeje me kuptim të figurshëm – Kuzhina e xhamisë, 14. Tërësia e vetive a e tipareve morale të njeriut – Sëmundje rëndë – Lumë në Austri – Filozofi, Lukreci.